



01 Nr. 10/22
Rahovec, 19.10.2022

Flohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen dhjetë (10) e cila do të mbahet më **28 tetor 2022 (e premte)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pëlgimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private për interes publik;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Statutit të QKMF-së;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për Ridestinimin e mjeteve financiare nga buxheti i vitit 2022;
6. Shqyrtimi dhe miratim i vendimit për miratimin e Projekt Planit për Trashëgimi Kulturore 2022-2025;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2027;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Progaarmit komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2025
10. Shqyrtimi i Raportit financiare për periudhën janar – shtator 2022
11. Informatë për përgatitjen e vitit shkollor nga DKA-ja 2022/2023;
12. Shqyrtimi i Raportit të performances komunale për vitin 2021;
13. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditimit të brendshëm për vitin 2021 dhe diskutimi i planit të veprimit.





PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur më 23.09.2022. me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i kuvendit z. **Defrim Kafexhiu**. Konstatoj se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimi shqiptar më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës z. **Smajl Latifi**, nën kryetar i komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtore të drejtorive komunale, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, kjo është seanca e nëntë për këtë vit kalendarik. Komiteti për politikë dhe financa ka përgatitur gjithsej 8 pika;

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e këtij;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Informatë nga DKRS-ja për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrik deri më 15 gusht 2022;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për planin komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022 – 2026;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratin e buxhetit për vitin 2023;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për programin komunal tre vjeçar për banim 2022 – 2024;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm P- 71510033-01041-1 në zonën kadastrale Xerxë;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Pikë shtesë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për lirimin nga taksa komunale për personat fizik dhe juridik për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga komisioni përkatës

Kryesuesi – Ky është rendi i ditës për sol, ndonjë propozim ose koment tjeter?...

Kryetari – I nderuar kryesues i kuvendit të komunës z. Defrim Kafexhiu, anëtarë të kuvendit, nënkyetar, drejtore të drejtive, përfaqësues të shoqërisë civile. Meqenëse me datë 17-18 shtator jemi ballasaquar me vërvshime dhe përmbytje, ky kuvend i komunës në vitin 2020 ka miratuar një rregullore për taksa, tarifa, gjoba, dhe ngarkesa, tani jemi në një situatë ku ministria e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural e obligon sccilin fermer ose bujk të dëmtuar të paraqes kërkesë për vlerësimin e dëmeve, kjo kërkesë ka një kosto financiare prej 10 eurove. Sot, i propozoj kuvendi të komunës që të gjithë të dëmtuarit t'i lirojmë nga kjo taksë, mos t'i paguajnë 10 euro, pavarësisht që ne kemi nevoj për të hyra por tani në këtë fazë kjo nuk na nderon. Kërkohet nga ju miratim të propozim vendimit për lirim nga taksat komunale për personat fizik dhe juridik për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga komisioni prej datës 19 shtator 2022 deri më 14 tetor 2022. Jemi në pozitë të papërshtatshme tani meqë janë të dëmtuar tua marrim edhe 10 euro. Fatkeqësisht kjo vlenë vetëm për dëmet në bujqësi sepse rregullorja nuk parashek për dëme në ekonomi familjare dhe amvisri.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Atëherë po e vendosim në votim meqenëse është një vendim që iu lehtëson punën dhe kërkesat bujqëve që në këto ditë kanë hasur në vështirësi natyrore. Si pikë të dytë të rendit të ditës, menjëherë pas procesverbalit. Kush është për?... Me shumicë unanime si pikë e dytë e rendit të ditës vendoset;

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për lirimin nga taksa komunale për persona fizik dhe juridik për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga komisioni përkatës.

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe rendi ti ditës me gjithsej 9 pika për sot. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Dikush prej anëtarëve rrëth procesverbalit?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime miratohet edhe procesverbal i mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për lirimin nga taksa komunale për personat fizik dhe juridik për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga komisioni komunal;

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues. I nderuar kryetar, drejtore të drejtive, zyrtarë monitores. Meqenëse rregullorja nuk e parashek që të lirohen edhe ekonomitë familjare, propozimi ynë është që edhe kjo kategorji të përfshihet, është e paraparë me rregullorë që jo dhe një gjë e tillë nuk mund të ndodh. Përndryshe në emër të grupit të asambleistëve e përkrahim këtë vendim.

Kryetari – Me të drejtë Lirigzoni e parashtoj pyetjen, por ministria e bujqësisë neve na imponon këtë rrëthanë, për amvisri, ekonomi familjarc, biznese dhe infrastrukturë nuk ka ngarkesë, komisionet e kryejnë punën dhe të dëmtuarit nuk kanë nevoj të paguajnë asgjë.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, dikush tjeter?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e këtij vendimi, kundër?... abstenim?... Me shumicë votash aprovohet vendimi për lirimin nga taksat komunale për personat fizik dhe juridik për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga komisioni komunal.

3. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Arber Zenuni – I nderuar kryetar i komunës së Rahovecit Smajl Latifi, nënkyetar Fatmir Iska, i nderuar kryesues i kuvendit z. Kafexhiu, të nderuar drejtore të drejtive dhe ju anëtarë të kuvendit. Më lejoni së pari të shpreh shqetësimin tim lidhur me situatën e fundit në komunën e Rahovecit, atë të përmbytjeve nga reshjet e shiut, ku me çast kemi të prekura shumë familje të cilat me mobilizimin e kryetarit dhe stafit të tij presin përkrahje dhe ndihmën duke evidentuar dëmet. Lidhur me këtë gjendje, kërkesa ime është që në Krushë të Madhe tani e disa vite kemi probleme nga reshjet e shiut, duke e ditur këtë gjë duhet të bëhen intervenimi në kolektorin e ujërave të zeza i cili nga pjesa e drinit e deri në hyrje të fshatit e deri në qendër është F-400, këtu duhet të bëhet një intervenim për shkak të mospërballimit të reshjeve atmosferike dhe pasojat bartën ndërvite. Me një rregullim të gypit primar të segmentit kryesor të kanalizimit do të evidentohen shumë probleme dhe dëmet gjatë përmbytjeve të mundshme do të ishin shumë më të vogla. Kërkesa e dytë ka të bëjë me objektet e qerdheve të cilat janë në fazë të përfundimit në lokacionet në Krushë të Madhe, Xërxe dhe Ratkoc, pyetja i drejtoshët drejtorisë së arsimit, a do të hapen këtë vit, apo kur do të bëhet hapja e tyre?...

Burim Krasniqi – I nderuar kryesues i kuvendit, kryetar komune, nënkyretar, drejtore, kolegë dhe gjithë ju prezent monitorues të seancës. Arbri e ngriti një shqetësim por për shkak që partia e tij është në pushtet ishte më i kursyer në deklarimet e tij. Është fakt që fatkeqësitet natyrorc janë fenomene që ndodhin në gjithë botën, nuk mund të ndalen as prej një kryetari të komunës, as prej ekzekutivit e as prej një qeverie. Fakt i dytë është që kemi situata të përsëritura në disa lokalitete, nëse nuk jam gabim është hera e 12-të që Fortesën e merr uji, është e 4-ta herë që shkollën e Sopniqit e merr uji bashkë me shtëpitë përrreth. Rregullimi i një pjese të kanaleve në Celinë ka bërë që t'i ndihmojë më shumë që t'i merr uji ato fusha para rrugës Prizren-Gjakovë. Mendoj që nuk është zgjidhje që këto fenomene të përsëriten pas çdo reshje të shiut dhe krytari i komunës të del me çizme, të thonë ja kryetari sa burr i mirë po del me çizme t'i shoh dëmet që i ka bërë uji. Kryetar, i ke disa kontrata të rregullimit të shtretërve, në fund të fundit ndërpreni punimet dhe ktheji aty ku ka nevojë, trajtoji drejtë, zgjidhe problemin. Shkolla e Sopniqit është kërkesë ndërvite me shtëpitë përrreth, sa herë që ka të reshura është fenomen që ka vërshim. Nuk është problemi i rregullimit të përtrockës prej Fortesës në drejtim të Rahovecit, problemin është te ura te hekurudha në Xërxe e në vazhdim te poshtë, kush të ka këshilluar nuk e di, por të ka këshilluar gabim (mrapshë). Nuk rregullohet përrockat prej burimit kah derdhja, por prej derdhjes te burimi, jo burimit t'ia rrissim shpejtësin e prurjes së ujit sepse nuk mund t'a përballoj pjesa tjeter dhe të ketë vërshime non-stop. E di që nuk mund t'a ndalosh shiun, e di që këto të reshurat e fundit kanë qenë specifike, por është fakt që dihet bolërisht që problemi i vërshimeve në Fortesë, Krushë, Sopniq dhe në fushat e Celinës është problem i përvitshëm, bile vitin e parë qe e keni rregulluar përrockën në Celinë, në vërshimin e parë komplet betoni është dëmtuar dhe pjesa dërrmuesc e asaj përrocke. Të sugjeroj si asambleist, si Burim, si njeri që njihemi; orientoi drejtë investimet në raport me rregullimin e përrockave sepse sa herë do të ketë të reshura do të përsëritet e njëjtë situatë. Po, ndoshta është një fushatë e mirë për të dalur me çizme duke thënë; po më vie keq që ju ka marr uji. Faleminderit shumë.

Fahrije Lushi – I nderuar kryesues, kryetar, këshilltarë dhe të gjithë të pranishmit. Meqë u përmendën disa lokalitete që janë vërshuar nga reshjet e fundit. Unë do të flas në emr të banorëve të fshatit Ratkoc, ku edhe në Ratkoc ka pasur vërshime jashtëzakonisht të mëdha. Kësaj here qytetarët nuk kërkojnë nga ju e as nga qeveria mbështetje të njëjtë si herave të kaluara, kësaj here kërkohet rregullimi i kanaleve të kullimit të ujërave. Këtu një pjesë të përgjegjësisë e ka edhe drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike sepse gjithmonë i kemi pasur kërkesa e njëjtë dhe përgjigjet e njëjtë. Kësaj here le të jetë si shenjë vetëdijesimi edhe nga ana juaj që intervenimet ose investimet tëjenë me kualitet të lartë dhe që nuk duhet të përsëriten brenda vitiit ose çdo vit rreshi.

Kryetari - Faleminderit shumë, unë e kam një raport të regjistrimit të dëmeve në bujqësi, në amvisri, ekonomi familjare, biznese si dhe një raport preleminar të regjistrimit dhe vlerësimit të dëmeve në infrastrukturë publike. Unë nuk jam prej atyre që bëjnë reklama, por nëse ka investuar ndokush në këtë komunë në kanale të kullimit dhe shtretër të përrenjëve, kam filluar me mandatin e parë, me të dytin dhe po vazhdoj me të tretin. Besoj që kuvendi i komunës është në dijeni për vlerat e kontratave dhe prioritizimin e këtyre projekteve që kanë të bëjnë me përballimin sa më të lehtë të këtyre situatave. Një shembull; shkolla filllore "Liria" në Fortesë, nuk e ka marrur uji gjatë vërshimeve, ndërsa qendrën e mjekësisë familjare po. Pra është një dryshim radikal të kujdesit se si duhet investohet dhe meqenëse qendra e mjekësisë familjare është ndërtuar paslustës dhe meqenëse është në pikën më të ulët dhe vazhdimisht është përfshir nga vërshimet, kur e kemi bërë objektin e ri e kemi ngritur për evitimin e kësaj dukurie. Me qëllim të mirë dëshiroj t'a bëj një kahasim; në çoftëse në Ratkoc shtrati i përroit nga ura te poshtë e deri përtëj hekurudhës është përfshirë nga uji të gjithë aty me familje, të gjithë i kam miqë e shokë, të gjithë janë uzupatorë. I bie që edhe Ratkoci që e ka shtratin e rregulluar nën hekurudh e deri te shpijat e fundit, përsëri janë përblytur nga uji. Fytat e ngushtë nën hekurudhën janë një nga problemet që e ngadalësojnë procesin e rrjedhjes së ujërave të rrëmbyeshme. Po e marr shembull Ratkocin, Fahrije; Biçeci që zakonisht ka bërë probleme, kësaj radhe jo, ndërsa 300metra më larg ka pasur vërshime edhe mbi urën e hekurudhës. Unë jam i gatshëm bashkë me juve të menaxhojmë dhe t'a shikojmë mundësinë se çka mundemi të bëjmë në këto situata. Për intervenim ka edhe pronarë privat që nuk lejojnë hapjen e kanalit, në Malësi të vogël te Lutajt. A janë ndërtuar projektet sipas standardeve?... Ne mund të kemi vërejtjet tona në arkicët, në inxhinier, këshilltar joadekuat, por qëllimi jonë ka qenë të minimizohet deri në skajshmëri me kapacitetet tona buxhetore. Mbi

5million euro mund të jetë kostoja e trajtimit të shtretërve; Sopniq-Fortesë, Celinë, shtratin brenda Krushës së Madhe, këtu kemi ngecje në kontratë dhe besoj e dini pse kemi ngecje. Fatbardhësish prej shtratit të Hoçës së Madhe nuk ka patur goditje si herave tjera. Te Sopniqi; mos të kishte ndodhur pastrimi që e kemi bërë në vitin 2021, sot komplet fshati do të ishte në ujë sepse e di çka ka ndodhur përpara aty dhe e di kësaj here cila pjesë është përfshirë nga vërvshimet. Tujte; unë nuk shkoj në terren për reklam, për herë të parë nuk kam marrë email zyrtar, ia kam thënë ministrit Sfeçla, ministrit të mbrojtjes, ministrit të pushtetit lokal, vazhdimisht kemi marrë emala zyrtar kur ka përmbytje prej institutit. Kur unë kam dalur në terren, njerëzit kanë qenë në gjumë, jemi aktivizuar pas gjysmës së natës sepse ka qenë besasi edhe për neve. Ne ngadalë po e pënnirësojmë infrastrukturën për mbrojtje nga vërvshimet dhe përmbytjet, kemi prioritet për këtë vit dhe për vitet në vazhdim sepse janë kontrata të mëdha. Dikush thotë; pse nuk po vazhdojnë kontratat?... Sepse ende 20%-shi i famshëm nuk është zbatuar. Menxi që kam arritur në vërvshime t'i bindi operatorët. E dini që këto kontrata për të cilat po flas janë lidhur në vitin e kaluar dhe çfarë ndryshimi radikal të çmimeve ka ndodhur ka bërë që operatorët nuk vazhdojnë punën përderisa të ketë ndonjë ndihmë nga qeveria, ligji 20% kundër inflacionit, por ende nuk ka hyrë në suçi, shpresojmë në këtë muaj. Kësaj radhe në qytet sa i përket përmbytjes kemi shpëtuar, është interesat edhe pse hapja e kanalit nga shtavica për Fortesë e ka ndihmuar qytetin në njëren anë dhe e ka rënduar gjendjen në Fortesë sepse uji është lëshuar më lehtë. Supozojmë që Ratkoci i ka shtretërit më mirë të rregulluar, në këtë rast kur uji e merr Ratkocin, nuk di çka të them... Ne nuk kemi kapacitet Burim Krasniqi, për financim të projekteve që janë në plan të ministrisë së bujqësisë për drenazhimin e tokave bujqësore sidomos te fytat e ngushtë në ura hekurudhore dhe përtej hekurudhës ose janë prona private, ose lidhen me komunën e Gjakovës ose dikush duhet të merret me trajtimin e shtratit të drinit të bardhë. Pra, në çoftëse është investuar ndonjëherë në Kosovë për trajimin e këtyre situatave problematike, është investuar në komunën e Rahovecit nga komuna e Rahovecit. Në komunat tjera këto punë shkojnë "llugë", shtretë ka vetëm brenda vendbanimeve. Në çoftëse ne bëjmë zgjidhje dhe i hapim vijat përtej hekurudhës, nën hekurudhë e deri në dri, do të zvogëlohet deri në skajshmëri potenciali i vërvshimeve dhe përmbytjeve. Ju anëtarët e kuvendit e dini që për shkak të këqklasifikimeve ministria sivjet n'a ka hequr kodin për pastrim të lumenjëve duke e vendosur në kategorinë mallra dhe shërbime. Sivjet e kemi pasur projektin e gatshëm për pastrimin e vijave në Krushë, Celinë dhe të vazhdojmë tutje, por tanë nuk kemi të drejtë të hapim procedurë sepse nga investimet kapitale ka kaluar në mallra dhe shërbime. Unë nuk kam dëshirë t'a luaj rolin e viktimit e as nuk përsitoj në momente, politikën dhe përgjegjësinë publike nuk e bëj me incidente, duhet investim i madhi prej moshës së re për të qenë një politikan aktiv. Mundësia jonë ka qenë t'i formojmë 7 komisione dhe komisionet kanë bërë një raport preleminar; deri 1.5 milion mund të shkoj vlera e dëmeve në bujqësi, mos harroni që në 2018 ka qenë gati 5 milion. Në amvisri; deri më tanë i kemi rrith 870.000euro dhe mund të kaloj mbi 1 milion sepse ende janë komisionet duke punuar. Për herë të parë vërvshime kemi pasur edhe në Zatriç, nuk di çka të bëj më! Vërvshime në bjeshkë!... Në Patoqan nuk ka vërvshime, mesiguri uji ka shkuar në Fortesë. Për herë të parë nuk kemi vërvshime në Çifllak, nuk kemi vërvshime në Kramovik. Pra, parashikime të sakta për dëme nuk mund të kemi deri në përfundim të raportit. Po përgatitemi t'a dërgojmë raportin në adresë të sakta të ministrisë së linjës ministrisë së bujqësisë një kopje, ministrisë së administrimit të pushtetit lokal, ministrisë për ndërmarrësi tregti dhe industri, zyrës së kryeministrit dhe të shohim, fjalët i kemi të mira, së paku të kompenzoohen sepse njerëzit janë dëmtuar në momentin kur kriza është e madhe dhe shumëplagëshe. Kanë ardhur tre ministra, përfshirë edhe zv.ministrin e bujqësisë, i kemi diskutuar këto tema. Mbrëmë në lidhje telefonike me ministrin Mehaj, kam kërkuar përfshirjen e FSK-së të na ndihmojnë me manikeritë e tyre si dhe uniforma e tyre na hapë rrugë te intervenimet te pronarët privat. Unë një herë i kam veshur çizmet, atëherë kur ka qenë koha e Luftës së ushtrisë që哩imtare të Kosovës. Kështu për qejf kurr nuk i kisha veshur, kjo nuk do të thotë që kisha ecur dathë, ka lloj lloj këpuca tjera, por për çizme nuk është nevoja... Dëmet preleminare në infrastrukturë i kemi 236.000euro, regjistrimi edhe vlerësimi i dëmeve vazhdon. Kemi dy objekte të dëmtuara shumë, QMF-ja në Fortesë që nuk e di se çka duhet të bëjmë me të, n'a tregon komisioni dhe shkolla në Sopniq e cila është në shënjestër nëse do të ketë vërvshime tjera në fshat, sepse është në pikën e ulët. Ka mundësi që vlera totale e dëmit në amvisri, ekonomi familjare, biznese, infrastrukturë publike dhe në bujqësi të kapë vlerën rrith 3milion. Nuk e kemi raportin përfundimtar sepse nuk ka shancë që për 5 ditë të përfundoj kjo punë. Javën

tjetër besoj që e kemi reportin të sakt me listë emërore të protokoluar të dërgohet në qeveri në zyrën e kryeministrit dhe në ministritë që llogariten që mund të na ndihmojnë. Te kolektori në Krushë të Madhe; ne e kemi grantin e performance-s 1.148.000 euro. I kemi marrur 592.000 euro këtë vit, pjesën tjetër ende jo, një pjesë e grantit është ndarë pikërisht për kolektorin në Krushë të Madhe dhe për pjesën e infrastrukturës që lidhet me drinin e bardhë. Sa i përket qerdhes; sivjet nuk mund të funksionalizojmë as qerdhen në Krushe, as në Xérxe as në Ratkoc, objektet janë gati ndërsa nga viti i ardhshëm i kemi 25 vende të lira për funksionalizim me personel pedagogjik-edukativ për qerdhet tona. Sivjet nuk kem të drejtë për konkurse, vitin e ardhshëm kemi fat që është plotësuar kërkesa janë drejtuar ministrisë së financave dhe ministrisë së arsimit për 25 vende të reja dhe mund t'a shihni në qarkoren e dytë buxhetore, është publike.

Kryesuesi – Faleminderi kryetar. Sot edhe gjethet kanë filluar të bijnë, zyrtarisht fillon stina e vjeshtës. Baci Rasim e ka fjalën.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues. Përvendetje për juve, kryetarin, nënkyetarin, anëtarët e kuvendit komunal, drejtoret, përfaqësuesin e OSBE-së, media dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Kryetari n'a dha sqarime të mjaftueshme rrethi situatës së vërvshimeve aktuale të fundit që kanë ndodhur në komunën tonë. Meqë i mora këto sqarime nuk do t'a zgjasë, por do të tha se; Fushat e Celinës – tokat i vërvshon lumi "Bellaja" dhe konsideroj që kjo çështje është dashur me mundësi të zgjidhet më herët, mirëpo ne nuk mund të kthehem prapa, por kisha propozuar te qeverisja komunale që lumi "Bellaja" të jetë së paku gjithmonë i hapur, e nëse ndodhin vërvshimet të shumta që nuk e përballon kuptohet në gjithë botën që ndodhin dukuri të tillë, nuk kemi çfarë të bëjmë por së paku mos të jetë arsyja që për shkak të mylljes së shtratit ose mos hapjes së shtratit në mënyrë të duhur të na vie uji të na mbulon tokat, pastaj dëmet janë shumë të mëdha. Kërkoj që kjo punë mos të përsëritet më në vërvshimet tjera sepse vërvshime do të ketë gjithmonë sa të ekzistoj njerëzimi, së paku konkretisht lumi "Bellaja" në çollësc ka mundësi buxhetore komuna të punohet dhe të jetë i hapur në mënyrën më të mirë të mundshme. Faleminderit, kaq pata.

Bejtullah Deliu – Faleminderit i nderuar kryesues, kryetar, zv.kryetar, drejtore të drejtive, kolegë asambleistë, media dhe gjithë të pranishëm. Deshta të ndalem në tre pikë; e para është kënaqësi që klubi i futbollit është duke avasuar, drejtori nuk qenka këtu – deshta t'ia jap një lavdatë të vogël për angazhim por po i kthehna në kritikë. Nëse DKRS së bashku me kryetarin kanë planifikuar që në këtë ecuri t'i dalin në krahë klubit shumë më tepër që të kaloj në superligë ku dhe bëhet një nam më i madh të ngrilet edhe komplet Rahovecit sepse futbolli është sporti më i popullarizuar në Europë. A keni menduar që të bëni ftesë nga institucionet drejtuar bizneseve për përkrahje më të madhe për klubin, më shqetësuese është planifikimi i ndërtimit të sheshit qëndror, në këtë pikë a keni ndonjë zgjidhje konkrete, nëse fillon rrënim i kësaj fushe, ku do të zhvillohen ndeshjet, stërvitjet?... E dyta; drejtoria për arsim, vitin e kaluar keni ngecë në nxehmjen pothuajse në të gjitha objektet e shkollave, a do të ndodh e njëjtë gjë këtë vit, a keni ndërmarrë diçka që të mos jetë kjo situatë?... E treta; te drejtoria për bujqësi, jemi dëshmitarë të faktit që po ndahen grante të subvencionimeve të ndryshme sidomos pjesë motorrike, plugje, traktorë të vegjël vit pas viti, mendoj që është mirë të merret një hap tjetër lutje të fokusohet drejtoria bashkë me menaxhmentin që të kemi zgjidhje për produktin final për bujqit, ata më herët kanë punuar edhe pa këto mjete motorrike pothuajse i tërë bereqeti i ka ngelur nëpër fusha. Eshtë shumë më mirë që komuna të konceptrohet në ndonjë projekt më madhor, t'i harroj këto grante të vogla, mirë është të vazhdohet me serra sepse nëse bujku ka vend ku e shet produktin final, besoj dhe ju garantoj që mjetet motorrike mund t'i blejë vet vitin e ardhshëm. Besoj që është më mirë të bëhet një shpallje ndërkombëtare me një organizatë që merret profesionalisht me bujqësi, të investohen këto mjete më mirë. Mund të marrim shembull Austrinë e cila është e rjohur për bujqësi dhe mesiguri ka organizata që operojnë për t'a bërë selektimin e fushave për mbjelljen e produkteve të ndryshme dhe të përshtatshme. Në fund kjo organizatë të na certifikoj dhc të na udhëzoj nga A deri në Zë se si bëhet puna e tillë. Poash tu besoj që nëse një organizatë ndërkombëtare të certifikon, t'a jep një vulë që produktet tona janë të shëndetshme dhe kualitative, atëherë besoj që tregu ndërkombëtarë është i hapur vetëm me atë vulë. Mendoj që kjo është mënyra më e mirë të investohet në produktin final, në ide se si të shitet sesa forma që është zgjedhur ndërvite me nga 1 milion euro duke shpërndarë plugje, traktora të vegjël. Të zgjerohem me një diapazon shumë më të lartë e më të gjerë për bujqësi, këtu fabrika të mercedesit nuk kemi, kemi

bujqësinë që mund të na bie të hyra bukur të mëdha. Sa i përket vërvshimeve, ndoshta mungesa e drejtorisë përmbrojje dhe shpëtim ka patur efekt, po të ishte do të reagonit më shumë.

Sejfullah Sejfullahu - Faleminderit kryesues, përshëndetje kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, drejtor, të gjithë ju. Për punën e Agro-festës, e kemi lënë me 15 shtator, nuk arritëm të bëhemi gati, tani vërvshimet pak na kanë çregulluar, por sigurisht në fund të muajit do të mbahet?... Nëse do të mbahet, do t'a shtyej operacionin deri pas përfundimit të Agro-festës. Nëse se mbajmë është ajo që kanë ndodhur shumë gjëra jo të mira shkaku i vërvshimeve edhe une gjithashtu shumë ia kam pa "sherrin". Pyetja tjetër; ditë më parë e keni pritur ministrin e kulturës z. Çekun, po pyes lidhur me sallën e sporteve në Krushë të Madhe, keni biseduar për projekte në përgjithësi, por konkretisht për sallën e Krushës a e keni ndërmarrë diçka?...

Ilir Pallqa – Inderuar kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive. Në fillim të rrugës "Gëzim Hamza" më saktësish përballë lokalit n'Qoshbar është një mur jo shumë i gjatë që e kufizon tërësisht hapësirën përmë këmbësorë. Aty me doemos duhet të krijuhet një hapësirë përmë këmbësorë me çfarëdo lloj forme, ngase mes tjerash asaj pjese i paraprinë një udhëkryq, e gjasat që të ndodh më e keqja nuk janë të vogla sidomos kur e marrim parasysh që ajo rrugë frekuentohej në baza ditore nga nxënësit të dy prej shkollave më të mëdha të komunës. Pyetja përmë këtë çështje; A është në pronë publike një mesatare prej 1m nga fillimi deri në mbarim të atij muri. Sipas gjeoportalit mua më figuron që po, nëse po, merrni masa- nëse jo, duhet shpallur si interes të përgjithshëm publik dhe vazhdojmë me procedura të tjera. Duhet të marrim vendime, kemi përgjegjësi edhe përmë vendimet që nuk i marrim. Kryelar, mes tjerash, ju vazhdimisht i keni thurrur lavde pronarit të asaj prone që lavdet e bëra nuk i kontestojmë, por meqenëse ju edhe ai po krijoni një farë sinergjie të intercesit publik, pse nuk bëni hapa konkret përmë këtë çështje, përderisa është në interes të banorëve, apo ke frikë që mos ndoshta prishen raportet shoqërore.

Leonard Morina – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, gjithë të pranishëm, qytetarë. Në webfaqen e komunës është një tender që është hapur me datë; 07.06.2022 dhe është mbyllur me 27.06.2022, kjo kontratë është përmë pajisjeve të shkollave me tabela digitale, 20 tabela. Janë 3 kompani që kanë ofertuar; kompania e parë ka qenë me 43.800, e dyta me 54.700, e treta me 59.800euro. Kontrata është nënshkruar me kompaninë e cila nuk është më e lirë përmë 10.900euro d.m.th me 54.700euro janë blerë 20 tabela, nëse do të zgjidhej kontrata më e lirë, do t'i blenim edhe 5 tabela tjera. Këto tabela digitale janë paguar me çmim 2735euro. Pse nuk është zgjedhur operatori më i lirë, por është zgjedhur operatori i mesëm 54.700. Në një kontratë tjetër të nënshkruar me datë 08.12.2021, riparimi i objekteve shkollore. Një kompani e ka fituar kontraten me 9060euro ku parashihen dy shkolla; shkolla "12 Maji" në Ratkoc dhe "Rilindja" në Çifllak. Te kjo e fundit parashihen të investohen diku 3551euro përmë renovimin e kulmit dhe aty në kontratë thuhet; të vendoset xhamat solarë në kulm. A janë vendosur xhamat solarë?

Drilon Mustafa – Përshëndetje përmë gjithë. Inderuar kryetar z. Smajl Latifi, kryesues z. Kafexhiu, drejtorë të drejtorive, kolegë. Deshta të ndërlidhem të menaxhimi i mbeturinave, komuna jonë prinë përmë së mbari, por problemi është te menaxhimi i mbetjeve të ngurta të bagëtive, këtu deshta t'a bëjë një kërkesë drejtorisë së inspektoriatit që në çdo banim në komunën tonë të inspektohet kjo çështje dhe të merret një vendim. Pyetja e dytë është përmë drejtorin e arsimit që lidhet me terrenin sportiv të shkollës në shkollën "31 Marsi" në Gurë të Kuq, e kemi parasysh edhe ngritjen e çmimive dhc neglizhencën e operatorëve, por ka shkuar një kohë e gjatë dhe mendoj që është afati i fundit që drejtoria t'a kushtëzoj operatorin ose t'a eleminoj tërësisht nga gara. Te transporti i nxënësve të shkollës së mesme të Gurit të Kuq, komuna iu siguron transportin vetëm përmë njëren rrugë dhc mendoj që është jo në rregull sepse rrugën tjetër duhet të vijnë në këmbë. Nëse keni mundësi buxhetore kërkoj nga ju që transporti të sigurohet vajtje-ardhje.

Kryetari – Faleminderit. Po, kf Rahovecin e përgëzojmë përmë sukseset edhe klubin e hendballit i cili është jashtëzakonisht mire. Këtë vit i kemi përkrahur aq sa kemi patur mundësi, nuk është që jemi të kënaqur me përkrahje, njejtë edhe ata me përkrahjen tonë. Në çoflëse ne i bëjmë ftesë direkt bizneseve direkt si institucione, mund të ketë ndonjë situatë diskutabile sepse ekziston mundësia të keqinterpretohet. Kjo nuk do të thotë që nuk bëjmë punë. Në takim e pata ministrin e kulturës rinisë dhe sporteve z. Hajrullah Çeku, biseduan shumë gjëra konkrete, kemi biseduar përmë memorandumin e datës 9 prill 2019 që kanë mbetur në letër dhe pa zbatim. Aty përfshihen stadiumi në qytet në Rahovec, palestra e sporteve në Krushë të Madhe dhe stadiumi në Ratkoc. Lëvizje konkrete mund të ketë te stadiumi në Rahovec përmë këtë vit, përmë palestrën në

Krushë dhe stadiumin në Ratkoc nuk ka shpresë këtë vit. Për herë të parë po e them në kuvend që me ministrin e kemi biseduar edhe lokacionin e stadiumit; ka qenë fat i mirë që qeveria që dikush po i thotë e PAN-it, në atë kohë na ka dhënë 7 hektarë te epopeja e UÇK-së mbi qytet, sepse nuk ka vend tjetër të përshtatshëm ose ndryshe hyjmë në prona private. Është një ide që t'ia kërkojmë edhe "Stone Castles", e kemi biseduar edhe me ministrin. Problemi është që pronat e "Stone Castles" janë kompleks bujqësor, e dyta; nevojiten 2 ose 3 hektarë por edhe në çoftëse ne e miratojmë në kuvend, gjithashtu ministria e kulturës është "për", ministria e planifikimit nuk është "për", ajo e bujqësisë nuk është "për" po flasim ligjërisht, jo pse iu mungon ndoshta vullneti, plus ne mund të ballafaqohemi me kërkësën për shpronësim që ndoshta "Stone Castle" kërkon shpronësim. Në fund në çoftëse nuk ka alternativa tjera, duhet të bëhet atje ku është. Sheshi qëndror në qytet është në fazën e vlerësimit. Do të kujdesemi që mos të krijojmë vakum duke shqyrtuar mundësinë që një herë të hyjmë me punë në pjesët ku nuk dëmtohet pozicioni i klubit se përofesionali i ndërtimit të sheshit nuk parashihet per 2 ose 6 muaj, por do të zgjatë që ndërkohë mund t'ë na lëviz ndonjë ide për stadium të ri dhe në momentin kur e kemi stadiumin e ri, punimet fillojnë në stadiumin ekzistues të parapara me plan. Ministria është vonuar 3 vite në memorandum e mirëkuptimin me ministrin Kujtim Gashi në 2019. Në procedurë të prokurimit ka patur lëvizje, janë anuluar procedurat, kodet ekzistojnë por para nuk ka. Këta tani dëshirojnë t'a ridizajnojnë që të kemi zhvillime në stadiumin e qytetit ndërsa në vitin e ardhshëm në stadiumin dhe palestrën sportive në Krushë të Madhe, ndërsa për Ratkoc meqenëse njëherë klub nuk ka, mos nguteni hiç. Te ngohja qëndrorc, furnizimi me dru dhe pelet; Kemi patur kontratë siç e dini, kemi rishpallur procedurat për shkak të rrëtjes së çmimeve sepsc janë ndërpërre kontratat ngase operatorët nuk kanë patur llogari të vazhdojnë punën me këto çmime. 200euro ka qenë peleti, në Pejë kanë lidhur kontratë me 750euro 1ton pelet, me këtë çmim mund t'a marrim edhe ne, prandaj jemi detyruar t'i ndërprenjë kontratat sepse operatorët nuk dëshirojnë të punojnë. E kemi rritur vlerën dhe besoj që shpejtë do t'i lidhim kontratat sepse janë në proces të vlerësimit edhe për dru edhe për pelet. Mekanizmi bujqësorë; Në këtë kuvend iu kamë thënë, po e përsërisë, nuk do të ketë më mekanizëm bujqësorë por ne jemi të obligueshëm t'i përmbrushim kontratat aktuale që i kemi. Nuk do të kemi kontrata të reja, në vitin e ardhshëm mund të futemi në impute bujqësore, po përpinqemi t'a rregullojmë tregun e madh të rrushit aty ku mbahet "Hardh festi". Jemi dëshmitar në vështirësinë e plasimit të produkteve bujqësore megjithëse kemi rezultate të mira dhe na bëjnë kranarë që prodhimet tona megjithatë mund t'i gjejme në tregun rajonal dhe evropian. Tjetër, mund të bëjmë një sigurim të një lehtësimi për plasimin e produkteve tona duke angazhuar ndonjë organizatë, por unë mendoj që shteti duhet t'u organizojë këtë organizatë sepse kapacitetet e një komune përfshirje të një organizate të certifikuar për të dhënë inpute të plasimit tutje në tregun e jashtëm është diçka që mund t'a bëjmë me kapacitetet tona por është problem jo vetëm te ne por në gjithë republikën e Kosovës.

Qendra përmagazin është në fazën e vlerësimit në procedurë të prokurimit. Sejfullah Sejfullahu- Agro festa; Unë me deshirë e kisha mbajte, por varet edhe prej vullnetit të bujqëve dhe të përfaqësuesve nga Krusha e Madhe, 2 asambleistë, drejtori i bujqësisë etj... Po nuk c' di a do të mund t'a organizojmë sivjet Sefcë edhe pse dëshirë kemi. Unë e kam mik Ruzhdi Haxhijahën, e kam pasë edhe Halimin. Nuk e kam mik të interesin individual. Ata bëjnë një punë të mirë, prodhojnë, kanë edhe të punësuar etj etj... Diskutimet rrëth atij murit në rr."Gëzim Hamza" nuk është që kanë filluar me neve, por shumë më herët, sepse ka qenë një ide të zhvendoset muri dhe ka patur një pajtim në mes komunës etj etj... Muri është në pronë private. Ortofotot neve na gjenjnjë pak se nuk tregojnë saktë. Është e vërtet që është ngushtë, ato gjëra që janë "n'Qosh bar", ato do të hiqen sepse e pengojnë trotuarin. Ajo rrugë është fyt i ngushtë, por mos harroni që ka prona private. Mund t'a bëjmë ndonjë zgjidhje me një projekt që është në procedur të tenderit, është projekt i fituar nga ministria e infrastrukturës e kemi në memorandum me Hysen Durmishin, hapja e ofertave bëhet në fillim të muajit nëntor sepse projektet e mëdha e kanë afatin 40 ditë për njoftim dhe ajo është një nga rrugët që do të trajtohet edhe me ujëra atmosferik dhe shpresojmë që gjatë këtij procesi t'a lironjë rrugën – fytin e ngushtë, a kupton Ilir?... duhet pak presion, pak mirëkuptim, pak të hyjmë në lojë sepse është rrugë shumë problematike me qarkullim të madh. Deri më tani nuk ka ndodh asnjë e keqe por kjo nuk do të thotë që nuk mund të ndodh në të ardhmen. Te pajisjet digjitale, Leonard; Të them të drejtën "qorba e lirë t'i djegë buzël" kjo fjalë e urtë është shumë e vertetë, këtë mund t'a dijë vetëm prokurimi se

pse është zgjedhur çmimi i mesëm, e jo ai më i liri, ndoshta operatori nuk ka dokumente!... Në ligj të prokurimit thuhet; operatori më i lirë po i përgjegjshëm, kjo është baza ligjore e dokumentacionit. Do t'a lus shesin e prokurimit të na jep një sqarim në seancën e radhës, sqarim zyrtar pse ka ndodh kjo. A ka ndodh kulmi në shkollën "Lirindja" me ato xhamat solare apo jo dhe çka ka ndodh me "12 Majin" këto përgjigje mund t'i jep Avniu. Te terrenet sportive Drilon, kompania është shumë e vertetë që është joscrioze, e papërgjegjshme, kuptohet edhe pasojat e rritjes së çmimeve na shkaktojnë vonesa dhe jemi duke e shqyrtau mundësinë të operojmë shpejtë ose t'a ndërprejmë kontratën me ata dhe të lidhim kontratë të re me tjetër operator. Te transporti në Xërxe nuk mund t'a dij këtë përgjigje, vetëm e di që ne nuk i përcaktojmë linjat, linjat i përcakton departamenti i posaçëm që është në ministri të transportit, Burimi e din më mirë. Mbetjet e ngurta; mund të themi që inspektorati jonë e ka dënuar një person 2000euro që ka gjuajtur mbetje shtazore në dri, 1000euro e ka paguar brenda 5 dite.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues. Kryetar, nuk mora përgjigje konkrete rrëth problematikës që e shpalosëm sepse është e pakuptimtë menjëherë të kyçemi se çka kishit mundur ju të realizoni me këtë problematikë rrëth produktit final. Më shumë hyrë në diskutim se çka mund të bëjë qeveria etj etj... Por është mirë që drejtoria të angazhohet në këtë pikë së bashku me juve dhe të bashkëpunoj me biznese të bëjë një konkluzion që këtë mjete që janë ndarë me vite të ridestinohen, mos t'a presim qeverinë por të marrim një hap sepse kur t'a shch qeveria që komuna po bën hap të mirë sigurisht që do të kemi përkrahje edhe nga qendra. Shumë është ide e qëlluar që të marrim një organizatë ndërkombëtare të certifikuar që garanton në produktet finale. Nëse investojmë në këtë projekt, produkti automatikisht është i shitur, velëm duhet kohë, durim dhe punë nga bujqit. Në vend të mjeteve bujqësore që janë dorëzuar çdo vit të merret një vij apo kahje tjetër në produktin final që është në mungesë dhc frikë e përvitshme e të gjithë bujqëve. E përmendët "Agro Celinën" vet kam qenë në një vizitë – është një biznes me standarde evropiane dhe nëse ky biznes ka sukses me idc dhe mjete vetanake, pse të mos përkrahet në produkte dhe zgjerimin e asaj pjese, e përgëzoj atë biznes dhe e di që është shumë scioz.

Ilri Pallqa – Faleminderit kryesues. Pyeta se a është në pronë publike, kryetari e dha përgjigjen, në seancën tjetër pres përgjigjen zyrtare me email ose material. Ajo hapësirë është shumë e ngushtë, nuk ka vend as për kontinier as për asgjë dhe do të ishte shumë mirë që ju dhe pronari i asaj prone t'a gjeni një mirëkuptim. Gjetja e mirëkuptimin të nderon ty edhe pronarin, neve n'a lehtëson ecjen.

Kryetari – Qendrat grumbulluese dhe përpunuese edhe sivjet do t'i mbështesim pak, me disa grante si komunë dhic marrim pjesë edhe në disa partneritete që ata i bëjnë. Kur qendra grumbulluese "Agro Celina" kur të bënë partneritet ose fiton ndonjë grant, marrim pjesë edhe ne me kapacitetet tona. Tjetra, ajo pjesë unë zyrtarisht e di që është pronë private Ilir, por kam dëshirë që kadastrat të thotë që është pronë publike, por edhe nëse është pronë private ne do të provojmë t'a zgjerojmë atë pjesë.

4. Informatë nga DKRS-ja për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrik deri më 15 gusht 2022;

Afrim Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkyetar, drejtora, anëtarë të kuvendit. Ne edhe në bazë të planit të punës së kuvendit e kemi informatën për muajin e mërgimtarëve. DKRS ka mbajtur aktivitetet tradicionale, muaji i mërgatës 15 korrik-15 gusht, si bartëse e aktiviteteve për muajin e mërgatës përgjegjëse ka qenë DKRS. Manifestimi ka filluar sipas agjendës e cila ka qenë e përpiluar dhe e hartuar nga kryetari i komunës sonë, kjo agjendë ka qenë edhe në webfaqen e komunës. Mbarëvajtja e procesit 30 ditorë; manifestimi ka filluar me datë 15 korrik-15 gusht, konsiderojmë që ishte një organizim dhe aktivitet më i madh deri më tanë. Me qëllim të ofrimit të mundësisë për takime reciproke ndërmjet mërgimtarëve tanë dhe autoritetet lokale. Komuna e Rahovecit gjegjësisht DKRS ka organizuar aktivitete të shumta duke filluar nga turneu në futboll, shah, koncerte të ndryshme, sofrën e mërgimtarëve. Kryetari i komunës për një muaj rresht ka pasur takime të rregullta me mërgimtarë duke filluar nga ora 10:00 çdo ditë duke shpalosur mundësitë dhe thirrjet rrëth investimeve në komunën tonë e kshtu me radhë. Kemi patur grupe të ndryshme të muzikës; Fisnikët, 04 band Xheriko dhe artistë tjerë të ndryshëm nga komuna jonë. Përveç koncerteve janë mbajtur edhe sofrat e mërgimtarit që janë pritur shumë mirë, në Drenoc, Krushë e Madhe dhe Ratkoc. Gjithashlu në kuadër të këtyre manifestimeve janë bërë edhe dy promovime të librave; "Deri në fryshtë e fundit" për dëshmorin Skender Gashi me autor Qemajl Krasniqi. Libri "100 kultivarë" nga Rexhep Kryeziu.

Eshëtë organizuar turneu dy ditorë ndërkombe të në shah "Korriku 98" ku kanë marrur pjesë 106 garues nga Shqipëria, Finlanda, Kosova, Austria, Mali i Zi dhe Maqedonia e veriut. Më poshtë në material i keni të gjitha aktivitetet tona me anë të fotove, ku për secilin aktivitet kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve. Gjatë muajit të mërgatës me datë 21 korrik ka qenë edhe përkujtimi i dëshmorëve te majë e Shkodranit, ku në të njëjtën ditë është bërë përrurimi i hapësirës rekreative për të rinjët. Përfund, e falënderoj policinë e Kosovës të cilët për një muaj rrresht n'a kanë përejellur që çdo aktivitet të ketë mbarëvajtje ashtu siç duhet, gjithashtu falënderoj edhe bizneset në rrugën "Xhevati Kasapi" të cilët kanë qenë të gatshëm dhe kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë.

Besmire Bytyqi – Faleminderit kryesues. I ndëruar drejtor, shfrytëzoj rastin për të shprehur mirënjojje dhe përgëzimet e mia për të gjitha organizimet gjatë muajit të mërgatës, juve dhe stafit tuaj, mos e harro zanatin vitin tjetër pak më mirë e pak më shumë.

Merisa Sharku – Përshtendetje për të gjithë. Besa duhet të na lë neve të opozitës t'a bëjmë ndonjë lavdatë. Për këto organizime e përgëzojmë edhe ne si opozitë drejtorin e kulturës, njashtu kërkesa jonë është që këtë organizime të vazhdojnë edhe në sezonë tjera. Përveç muajit të verës, mërgimtarët vijnë edhe në sezonën e dimrit, mirë është të ketë organizime që i përshtaten kohës dhe klimës por gjithësesi mos të mundojnë manifestimet.

Ilir Pallqa – Për organizimin e mbrëmjeve te kafet e vogla, e falënderojmë kryesuesin për idenë kreative që e ka dhënë. Faleminderit kryesues, ne si grup njihemi si kreativ dhe më vie mirë që je pjesë e jona.

Kryesuesi – Faleminderit Ilir, po kushtëzohna edhe unë t'i falenderojë anëtarët e ekzekutivit dhe komisioni organizues që ka qenë për një organizim tjetër, ku edhe këta e kanë shprehë vullnetin dhe gatishmérinë për t'i dëgjuar idetë e secilit dhe që ka funksionuar shumë mirë.

Bejtullah Deliu – Nuk e di a të filloj me lavdërimë unë. Drejtor, në fushë në Dejnë një gropë e madhe është hapur, a mund të na tregoni sepse është fushë e re, pse kaq shpejtë dhe çka është ndërmarrë.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për planin komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022 – 2026;

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, prapa suksesit të drejtorit të kulturës qëndron drejtori i shërbimeve publike sepse unë ia kam dhënë vendimit për kufizimin e lëvizjes në atë rrugë, pak shaka – kërkoi falje, përshtendetje edhe një herë për të gjithë. Në diskutim publik ka përfundur plani i menaxhimit të mbeturinave prej datës 11.08-11.09 sipas ligjit për qeverisje lokale, poashtu është mbajtur edhe një diskutim publik në sallën e kuvendit me datë 25.08.2022. Plani i menaxhimit ka asat pesë vjeçar në këtë rast komuna e Rahovecit ka zotim dhe obligim ligjor mjedisin ekologjik në komunë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit të qytetarëve. Ky plan i ka të gjitha specifikat që i kërkon ligji, duke përfshirë operimin, strategjinë dhe volumshmérinë të menaxhimit të mbeturinave, ndarjen, inkasimin, koston e shërbimit, siç e dini sipas ligjit, komuna e Rahovecit është e obliguar që të caktoj edhe tarifat për mbledhjen e tyre mbeturinave. Në përfundim të këtij plani janë paraparë objektivat dhe vizioni i këtij plani për periudhën 2022-2027. Për çdo këshillë dhe sugjerim, jemi këtu për të dhënë informata shtesë.

Besmire Bytyqi – Faleminderit kryesues, gjithashtu faleminderit edhe ty Përparim për këto infomacione. Unë kam vetëm disa ankesa te menaxhimi i mbeturinave – të kompanitë përkatëse. Hapësirat publike nuk po mirëmbahen aq sa duhet, parqet e vogla, oborret e ndryshme, varrezat e dëshmorëve dhe të tjera. Gjendja nuk është aq e mirë sa ka qenë vite më parë. Kërkoi nga ju si drejtor që të bisedosh me të gjithë operatorët ekonomik të cilët i mirëmbajnë hapësirat publike që me më seriozitet t'i marrin këto punë.

Kryesuesi – Faleminderit Besmire, dikush tjetër ndonjë gjë rrëth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për këtij plani?... Me shumicë unanime, miratohet edhe vendimi për planin komunal për menagjimin e mbeturinave, përfundon edhe pika e pestë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pauzë...

Kryesuesi – Përshëndetje edhe një herë për të gjithë, shpresoj që keni kaluar një pauzë të mire dhe xhuma të pranuar për ata që e praktikojnë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2023;

Afrim Limani – Përshëndetje për ju kryesues, kryetar, nënkyetar, asambleistë dhe gjithë të pranishëm. Siç jeni në dijeni edhe pse pak me vonesë por me datë 16.08.2022 ka arritur qarkurja e dytë buxhetore ku edhe janë përcaktuar limitet dhe tavanet buxhetore dhe pjesa apo “hisja” e buxhetit të komunës së Rahovecit për vitin 2023 si dhe projekzionet 2023-2025. Nuk ka ndonjë dallim të madh nga qarkorja buxhetore por vetëm kemi një zbritje prej 50.000euro nga pozicionet, nga kategoria e investimeve kapitale janë rritur pagat prej 50.000euro. Ndryshim tjetër për të mirë është një shtim të stafit në qerdhe d.mth. për arsim rrëth 21 vende dhe është zvogëluar stafi në shëndctësi, nga 69 në 52. Pra ky është dallim në mes të qarkores së parë dhe të dytë. Andaj buxheti për komunën e Rahovecit për vitin 2023 në total është prej 17.548.240 euro. Të hyrat vetanake 1.445.000, granti është 16.102.000 ku përfshihet granti për shëndetësi prej 2.600.000 dhe grantin e arsimit prej 5.872.000. Pra, dallimi nga viti 2022 në vitin 2023 kemi një rritje të buxhetit në vlerë prej 2.494.000euro, më pas buxhetin e kemi shpërndarë në projekSIONE NË TË GJITHA KATEGORITË EKONOMIKE që e keni materialin. Kalojmë te lista e investimeve kapitale, është e njëjtë listë me atë që ju e keni, mirëpo këtu siç po shihet jemi korrekt dhe transparent me ju duke e parë përbajtjen në tabelë, pjesa që janë të hijezuara me ngjyrë të verdhë, janë projekte kapitale të cilat janë nga viti i kaluar mirëpo departamenti i buxhetit i ka klasifikuar si keqklasifikime, prandaj këto nuk janë në listën e projekteve kapitale që i keni ju. Këto janë futur në kategorinë mallra dhe shërbime të cilat janë rritur për vitin 2023 dhe janë rrëth 400.000euro. Në këtë tabelar është i prezantuar edhe buxheti i vitit 2022 si pasqyrë ose si masë krahasuese që ju ta keni si informatë dhe t'i shihni ndryshimet që janë bërë në projekte kapitale. Në fund e kemi listën për projekzionet e vitit 2023. Në kuadër të projekteve kapitale janë të futura të gjitha kërkosat e qytetarëve apo rrëth 95%, që kanë dalur si rezultat i dëgjimeve buxhetore edhe pse juve ndoshta nuk iu doket që po, por për shkak të sistemit P.I.P (programi i investimeve publike) i cili nuk e lejon hapësirën t'i fusim të gjitha të dhënat, atëherë çdo kërkosë është në kuadër të këtyre projekteve. Për here të parë jemi shumë komod që vitin e ardhshëm krijojmë një stabilitet financiar. Ju e keni një listë të obligimeve kontraktuale e cila është 2.5 milion dhe nëse këtyre obligimeve iu shtojmë edhe disa projekte që janë në proces. Buxheti i investimeve kapitale në total për 3 vite është 20million, aktualisht kemi kontrata në vlerë prej 15million euro, e keni këtë document që e keni kërkuar. Obligime kemi rrëth 8.5million nëse ia shtojmë edhe vlerën e projekteve të kontratave të lidhura dhe në process të lidhjes, të gjitha së bashku bashkë me sheshin në total janë rrëth 17million euro, duke e ditur që kemi edhe 1.7million të buxhetit të vitit 2022. Për fund, kërkoi nga ju që t'a votoni këtë buxhet, është buxhet i qytetarëve dhe duhet t'a votojmë për qytetarë.

Kryetari – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë, përsaqësues që e monitoroni këtë mbledhje të kuvendit komunal, media, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovcit. Sivjet janë mbajtur 34 takime publike nga kryetari dhe ekzekutivi i komunës në periudhën maj – qershor 2022, janë mbajtur 8 dëgjime buxhetore në periudhën gusht 2022, është mbajtur një dëgjim buxhetor nga KPF në gjysmën e shtatorit 2022. Është hera e parë që debatet, takimet dhe dëgjimet buxhetore përvëç që i organizojmë në koordinim të plotë me KDI-në, kësaj radhe edhe me DEMOS-in që lidhet me fuksionet e transparencës në hartim të buxhetit, poashtu për here të parë me rekondit të këtyre organizatave kemi formuar një grup punues për trajtimin e kërkosave, shqetësimëve dhe nevojave që i kemi dëgjuar gjatë konsultimeve me qytetarë. Është hartuar edhe ky raport përfundimtar dhe mund të iu them që është bërë një punë e madhe rrëth planifikimit, hartimit dhe ndarjes së buxhetit në përputhje me kërkosat dhe nevojat e komunitetit. Ju e keni kërkuar një listë të investimeve kapitale të projekteve të reja, projekteve në vazhdim, ku do të zbatohen këto projekte dhe cilat janë kontratat. Ky dokument është gati dhe e keni në duart e juaja. Poashtu keni

kērkuar një listë të obligimeve kontraktuale dhe një listë të obligimeve që ka komuna e Rahovecit në rapport me operatorët e ndryshëm. Gjithçka që punohet në këtë komunë, kuq i domosdoshëm është stabiliteti financiar dhe përfshirja në projekte të gjitha kontratat të cilat janë të lidhura me komunën e Rahovecit dhe eventualisht për ndonjë projekt të ri. I kemi kushtuar shumë vëmendje kanaleve të kullimit të tokave bujqësore, shtretërve të përrrenjëve, e kemi prioritetizuar sheshin qëndrorë në qytet, që është një projekt shumë i madh capital, kemi përfshirë edhe dy projekte të reja siç është ndërtimi i shkollës në Xërxë dhe ndërtimi i aneksit të shkollës në Raikoc. E kemi adresuar edhe zonën ekonomike që është një projekt jashtëzakonisht i madh, kemi bërë një memorandum mirëkuptimi me ministrinë e tregtisë industrisë dhe ndërmarrësi, kjo ministri jep 1.5 milion ndërsa komuna jonë 300.000 euro. Të hënën kam edhe takim me ministren Rozeta Hajdari që të bisedojmë se kush do t'a mbuloj pjesën tjeter që mbetet. Pra mendoj që ky buxhet për vitin 2023 është preqatit me vëmendje të shtuar, janë përfshirë priorititetet e komunës, kontratat e mëdha, borxhet që potencialisht mund t'i kushtojnë nga operatorët komunës tone, kemi adresuar rekomandimet e ZKA-së dhe kemi ardhur në një ngjarje ku diskutimi i buxhetit të jetë një ngjarje solemne. Pas hapjes së debatit dhe diskutimeve të vlefshme të cilat i mirëpresim, besoj që janë pjekur kushtet që të miratohet ky buxhet dhe të votohet nga secili asambleist i zgjedhur në komunën e Rahovecit. Besoj që ky buxhet ka prioritete në kulturë, rini, sport, bujqësinë, ka prioritet përkrahjen e ndërmarrjeve të mesme atyre të voglave, artizanateve, prioritet ka infrastrukturën publike – rrugë lokale, shtretër të përrrenjëve, kanalet e kullimit të tokave bujqësore, rrugët fushore sigurisht edhe ndryshimin e mbështjetjes në bujqësi që e përmendi edhe Bejtullahu, pra, jo më në menakizma bujqësorë. Ju ftoj secilin grup politik që mbi dallimet që potencialisht ekzistojnë ndërmjet partive, ju ftoj që t'a votoni për hirë qytetarëve të komunës së Rahovecit, ky buxhet do t'i zgjidh shumë probleme, shumë do të mbesin të pazgjidhura sepse nevojat dhe kërkcsat e qytetarëve me mundësitet tonë natyrisht kanë shpërputhje. Buxheti është 17.5 milion ku prej tyre 40% janë për paga. T'i kapërcejmë kufijtë partiakë në mënyrë që mos të kemi vonesa sepse drejtorisë së financave i mbetet punë serioze për harmonizimin e asaj që kërkon ministria e financave, departamenti i buxheteve komunale në mënyrë që të certifikohet buxheti pa vonesa dhe mos të humbin qytetarët e komunës për shkak të ndonjë paqartësie që mund t'a krijomë. Unë jam i hapur për të gjithë për ndonjë ide interesante që mund t'a buxhetojmë dhe paketojmë në buxhetin e vitit 2023, sidomos në listën e investimeve kapitale.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Ne e kemi analizuar buxhetin e vitit 2023 dhe e kemi parë që ky buxhet nuk është i favorshëm për qytetarët e komunës sonë. Jemi kundër kësaj shpërndarje buxhetore në projekte që filluar të zgjasin 5 deri në 10 vite. Projekte në vazhdim... projekte në vazhdim d.m.th 85.5% janë projekte në vazhdim dhe vetëm 14.5 janë projekte të reja. Sipas ligjit kjo nuk është dashur të ndodhë sepse 1/3-ta duhet të jetë projekte të reja dhe 2/3 projekte në vazhdim. Njejtë edhe rapporti i ZKA-së ka thënë që rapporti është i kualifikuar për shkak të kësaj që kontratat janë shumë asfatgjate dhe që komuna nuk i ka përbushur obligimet që t'i lë kontratat 3 vjeqare. Te shpërndarja e buxhetit po ia nisi me zyrën e kryetarit meqenëse është në renditje; në vitin 2022 zyra e kryetarit ka në shfrytëzim 361.627 euro ndërsa në 2023 është 393.520 euro që i bie 31.893 euro ka më shumë në zyrën e kryetarit. Nuk e di kryetari a dëshiron rritje stafi apo rritje të cilësisë, apo janë rritur apetitet brenda zyrës. Kuvendit komunal buxheti i zgjedhur në vitin 2022 ka buxhet më shumë, ndërsa buxheti i ulet në vitin 2023. Te shkollat fillore; në vitin 2022 kanë buxhet 4.587.934 euro, ndërsa në 2023 buxheti për shkollat fillore është zgjedhur për 37.000 euro. Në shkollat e mesme; në vitin 2022 buxheti për këto shkolla është 1.307.559 euro, ndërsa në vitin 2023 për 26.553 euro më pak. Të gjithë thonë që në arsim duhet të investohet, por kryetari kësaj radhe ka zgjedhur që në arsim t'a zgjedhur buxhetin, ndërsa në zyrë të vet t'a rris. Te zjarrfikësat; këtë vit është paraparë për vitin 2023 rrëth 10.000 euro për izolimin e objektit të zjarrfikësve. Ata nuk kanë nevoj për fasada të jashtme sepse kushtet brenda objektit janë shumë të mjerueshme. Ne i kemi vizuatuar dhe aty

ka nevojë pér intervenim nē secilin detaj që e ka brenda sepse zjarrfikësit janë tē thirrur t'a shpëtojnë dikë, nē anën tjetër janë nē itrezik pér vete që kérkojnë shpëtim prej komunës pér shkak tē kushteve brenda objektit. Bujqësia; Në bujqësi keni paraparë 440.000euro pér vitin 2023, nē disa seanca tjera kemi kérkuar që subvencionimi mos tē ndodh vetëm pér mjete bujqësore, kemi familje që merren me artizanate e që kanë nevojë tē subvencionohet. Kjo kérkesë e grupit tonë nuk është marrë parasysh, po e shoh që nuk ka subvencionim pér gra që merren me artizanate. Në fushatën e kryetarit kemi parë që ka premtuar që pér lehonat do t'i rris subvencionet njga 200 nē 300euro, jo që kjo nuk ndodhi, por, ky i ndali edhe ato 200euro që i kanë patur subvencion. Nuk e pashë që nē këtë buxhet ka subvencionim pér grata lehona që është premtuar nga 300euro. Te zona ekonomike nē Opterushë, nē vitin 2023 keni paraparë 50.000euro, kshtu me radhë deri nē vitin 2025 nga 50.000euro që bie 250.000euro. Nëse e shikojmë se çfarë projekti është ai, kjo i bie që ky projekt nuk do tē përfundon as nē vitin 2050. Kryetari tha që kemi një marrëveshje tanë që do tē investohet 1 milion e diçka dhe besojmë që kjo t'a shpëtoj zonën ekonomike tē vetme që e kemi nē qytetin tone. Te shkolla e Fortesës keni paraparë 200.000euro pér vitin 2023, nëse e kqyrim me dokumente, kjo shkollë është e përfunduar dhe gati një vit nxansat mbajnë mësim nē këtë shkollë, kjo mund tē ndodh pér dy arsy; njëra; pér shkak se kryetari iu ka dashur tē mirën nxënësve dhe ka dashur tē sjellë një objekt tē ri pér ata ose para zgjedhjeve është dashur t'a prej shiritin e ndoshta i ka dalur edhe ndonjë votë më tepër, por besoj që është e para që e ka bërë pér nxënësa. Te ndërtimi i shkollës "Bekim Sylka" besoj që është një gabim, ndoshta edhe teknik; ndërtimi i shkollës "Bekim Sylka" nē vitin 2022 janë 60.000euro ndërsa nē vitin 2023 janë 20.000euro dhe me 80.000euro nuk besoj që ndërtohet shkolla, por është fjalë pér renovim. Furnizimi i shkollave me teknologji informative; parashihen 20.000euro edhe nē vitin 2023 / 20.000euro deri nē vitin 2025 janë paraparë 100.000euro dhe unë jam pér digjitalizimin e shkollave por jo tē nënshkruara me kontrata që një tabelë digitale t'a ketë çmimin 2735euro, me këtë çmim mund tē vijnë 7 tabela, me 7 tabela nuk digjitalizohet shkolla. Ne si grup më i madh i opozitës nuk e kemi obligim t'ia bëjmë votat kryetarit pér buxhetin. Bara i bie kryetarit Latifi, sepse nē zgjedhjet që ndodhën para 1 viti nuk e fitoi shumicën nē kuvend, e ka patur një mundësi pér koalicion me ndonjë parti që t'i ketë numrat, por siç duket më mirë po i del "hesapit" pa koalicion t'i ketë numrat. 12 drejtora i emëroi nga partia e AAK-së e këta tē tjerët nuk u morën parasysh. Kryetari tha që i kemi patur 34 takime me qytetarët, me drejtorin e financave nëpér lokalitete tē ndryshme, duke i dëgjuar hallet e qytetarëve pér nevojat e tyre. Sipas këtij buxheti po del që keni dalur nē terren, i keni dëgjuar, por ato kérkesat e tyre nuk i keni futur nē buxhet pér shkak se janë vetëm 10 projekte tē reja nē buxhet dhe këto nuk janë kérkesat që i kanë patur qytetarët. Në si VV do tē jemi kundër këtij buxheti.

Kryesuesi – Faleminderit Leonard. Meqenëse Leonardi foli nē emër tē grupit tē lëvizjes, atëherë kryetari po i përgjigjet menjëherë.

Kryetari – Faleminderit. Buxheli nuk është i kryetarit tē komunës, por i qytetarëve dhe pér qytetarët e komunës. Në dëgjime dhe konsultime kudo që kam qenë, më kujtohet që kam qenë edhe nē Malësi tē Vogël dhe Leonardi nuk ka qenë prezent, e që është dashur tē jetë. Premtimet janë tē kryetarit tē komunës, nuk janë tē LVV-së, ne i kemi fituar zgjedhjet dhe merre shikoje raportin 6 mujor tē institutit GAP dhe e sheh sa premtime i kemi përbushur. Kjo që dua t'a them nuk do tē bën tē lumtur, por jemi komuna që kemi përbush më shumë premtive nē 6 mujorin e parë. Vlerësimet i bëjnë qytetarët por ka edhe mekanizma që e masin punën e kryetarit tē komunës dhe natyrisht që është edhe puna e kuvendit tē komunës, andaj mos e nënçmo veten dhe grupin politik që i takon sepse edhe ju po bëni diçka. Te zjarrfikësit; nuk e di ti a e din që unë bisedova me Xhelal Sfeqlën që AME menaxhon me zjarrfikësit, me rekrutimin e tyre ndërsa komuna e Rahovecit investon te zjarrfikësit, nē pajisje, nē çizme, nē automjete, nē objekte, investojmë edhe nē drita tē veçanta që një prej tyre kushton 3000euro. Pér tē bërë ty tē lumtur, ne do t'a fitojmë një objekt tē ri tē

zjarrfikësve dhe do t'i zhvendosim zjarrfikësit dhe tē vendoset atje te ekoregjioni. Pēr Ichnonat nuk dua tē flas, shikoje premitimin nē GAP, unē i subenvionoj me 300euro, vitin e ardhshēm 400, por vetēm pēr foshnjet qē lindin nē QKMF nē Rahovec. Artizanalet; ne i mbështesim artizanalet, do t'i mbështesim edhe nē tē ardhmen edhe nē vitin 2023. Mē vie keq qē po flet nē emēr tē grupit, por kur t'a lexon mirë qarkuren e parē dhe tē dytē buxhetoree kupton mirë qē subvencionet janē rritur Leonard Morina. Kanë qenë 361.000 pēr këtë vit dhc janē bërë 800 e sa mijë pēr vitin e ardhshēm dhe rrjedhimisht rriten edhe subvencionet e zyrës së kryetarit. Këto subvencione nuk i kam pērveti e as pēr familjen time, ndoshta familja jote mund tē ketë nevojë nē tē ardhmen qē inshallah nuk ka nevojë. Nuk duhet folur pēr gjëra qē nuk e din qka janë. Te subvencionet nē bujqësi; i kemi ritur subvencionet, e kemi eleminuar keqklasifikimin. Pra, nuk mund tē shpërndajmë mē mekanizëm bujqësorë, nuk kemi kontrata tē reja pēr mekanizëm bujqësorë por do tē pērfundoj shpërndarja e këtyre kontratave qē i kemi, shpërndarje do tē ketë edhe nē tator e janar, por kuptohet pēr aplikimet qē kanë qenë 2020/2021 ndërsa aplikime nē vazhdim pēr mekanizma bujqësorë nuk do tē ketë. Bujqësia është duke u pérkrahur nē disa drejtime, ti i përmende 400.000 euro, kjo është gabim, janë mbi 1 milion euro. Ti i përmende vetēm subvencionet qē është diçka tjetër, janë rrugët fushore, kanalet e kullimit tē tokave bujqësore, investimet nē bujqësi. Meganizmat bujqësorë deri vonë, Rasim Fazliu edhe disa tē tjerë me provojë e dijnë, janë konsideruar nga ministria e financave si investime kapitale, tani auditori thotë qē janë subvencione dhe këto pagesa do tē bëhet nga kjo kategori buxhetore. Te shkolla nē Fortesë; i askujt nuk është faji qē unë jam i zoti, operatorit nuk i kam thënë qē patjetër tē pērfundohet objekti i shkollës "Liria" nē Fortesë një vit para. Nuk e di a iu ka shkuar mendja qē qeveria e republikës së Kosovës ndërtimin e kësaj shkolle nuk e ka mbështetur me asnë cent dhe iu tregoj pa marre hiç se cilat projekte i mbështet e cilat jo. Shkolla nē Fortesë me mbi rrëth 700.000euro plotësisht është financuar nga buxheti komunal, tani ne kemi obligime pēr pagesë tē kontratës sepse operatorit "Euro ing" është treguar shumë serioz duke e pērfunduar para kohe. Në këtë kriz globale këto janë lajme tē mira, problemin mē tē madh e kemi me ata qē nuk i pērfundojnë hiç as para kohe as pas, pēr shkak tē rritjes së çmimit. E përmende zonën ekonomike, nuk e di a jemi mirë unë edhe ti me vesh. Në seancën e paradites thash qē e kemi nënshkruar një memorandum mirëkuptimi prej 1.8million euro, 300.000 euro i bartë komuna, 1.5 milion ministria e tregtisë industriale dhe ndërmarrësë, tani jemi duke luftuar me ministren Hajdari pēr riformatim tē memorandumit se çka do tē bëhet me para tjera sepse vlera e këtij projekti është 3.159.000euro, kush i paguan këto tjerat? Po mundohemi t'a bëjmë një aneks memorandum qē edhe pjesën tjetër ata t'a martir përsipër sepse realisht sipas ligjit zonat ekonomike dhe parqet industriale i financon qeveria. Thoni qē nuk i kemi dëgjuar kërkesat e qytetarëve, Leonard Morina a e dini qē pēr këto kërkesa ekziston procesverbali, po mē vjen keq sepse i takon grupit mē tē madh opositarë, megjithëse me numër jeni njejtë. Ideja është qē me qenë tē sakt dhe korrekt. Kërkesat e qytetarëve nga ky vit janë tē regjistruala nē procesverbal sepse ne kemi hy nē një drejtim tē pakthyeshëm si komunë pēr shkak tē nivelit tē transparencës dhe performancës, nuk guxojmë tē bëjmë diçka ndryshe sepse është kthim prapa. Janë indikatorë pa tē cilët nuk ecim pērpara sepse "kur tē rreshtohesh i pari, vështir tē ulet garda". Ky buxhet asnëjëherë nuk është planifikuar e hartuar mē mirë nē koordinim me qytetarët dhe organizatat qē kujdesen pēr këtë temë. Në çoftëse po mendoni qē duhet me qenë kundër buxhetit, nuk keni nevoj t'a bëni votat Smajl Latifit. Në fillim e thash qē kjo është ngjarja më e rendësishme e secliës komunë mbredha një viti dhe duhet tē jetë ngjarje solemne. Leonard, mirë qē janë 2/3-at projekte tē vjetra dhe 1/3 janë projekte tē reja ose mē pak sepse nuk nuk goxon tē kemi projekte tē reja ende pa u pērfunduar atë tē vjetrat, e kemi rekomandim. Çka kemi bërë ne? I kemi mbuluar me projeksione buxhetore kontratat qē i kemi tē nënshkruara dhe kemi synuar edhe projekte tē reja sepse jela dhe trendi vazhdon. Pra, kërkesat e qytetarëve janë tē mbuluara nē këto "lotte"- kontrata qē janë ekzistuese. E ftoj lëvizjen vetëvendosje t'a votoj buxhetin megjithëse e drejta është e juaja tē vendosni se çka dëshironi

të veproni. Ti po thua qe e kemi zvogëluar grantin e arsimit, nuk e zvogëlojmë ne grantin e arsimit, është grant specifik. Granti i shëndetësisë është grant specifik ndërsa granti i administratës është grant i përgjithshëm. Afrim Limani e tha shumë mirë; është zvogëluar granti për arsim dhe është zvogëluar numri i punonjësve në shëndetësi. Në qarkoren e dytë buxhetore janë shtuar 25 vende punc për edukatore për qerdhe. Këto janë ndryshimet që kanë ndodhur në mes të qarkures së parë dhe të dytë, nuk i ka bë komuna e Rahovecit, por ministria e financave e qeverisë së republikës së Kosovës. Të ftoj për reflektim dhe alternativë, prandaj ty edhe grupin tënd e lus për votim. Faleminderit.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues. Kjo retorika e kryetarit se ne e kemi për detyrë t'a votojmë buxhetin i cili është propozuar dhe krijuar nga ai, është krejtësisht e paqëndrueshme. Keni thënë që e kemi për detyrë që me të marrë në përgjegjësi sepse nuk mund të të kërkojmë përgjegjësi nëse nuk e votojmë. Ne do t'a kishim për detyr t'a votojmë, nëse do të kishim qenë pjesë e krijimit të këtij buxheti (propozimi). Si ekzekutiv kryetari ka legitiimit të plotë për përgjegjësitë e tij, miratimi i buxhetit është përgjegjësi e kuvendit. Në kuvend partia e kryetarit nuk i ka numrat, rrjedhimisht vet si AAK nuk mund t'a krijoj propozimin për buxhet. Ne nuk pajtohem i këtë buxhet, shefi i grüp tonë i tregoi arsyet sepse ne e kemi programin tonë, gjithashtu përgjegjësinë për votën e cila duhet të jetë në përputhje me programin tonë me të cilin kemi kërkuar besimin që e kemi marrë, jo me t'AAK-së. Mes tjerash, siç e ceku edhe shefi, më shumë se gjysma e buxhetit është e destinuar për borxhe të investimeve kapitale dhe si të presim prej dikujt të bëjë diçka të re në komunë, kur ai shumicën e kohës duhet të mendoj se si t'i mbuloj borxhet. Nuk ka as vullnet e as kohë të mendoj të bëjë diçka të re, sepse koha njejtë si buxheti është në funksion të larjes së borxheve. Pra, jo vetëm që është ndalur ora, por tanë ka nis të punoj mbrapsht.

Kryetari - Ilir, ty po të punon ora mirë këtu, kuvendi është duke funksionuar mirë. Programi, vërtetë ka qenë i aleancës sepse me ato programe kemi kandidu. Në momentin kur i kemi fituar zgjedhjet, programit është i pasuruar me plotë ide edhe prej opozitës i futur në buxhet. Mos harro, është e pasaktë edhe ajo që tha Leonardi edhe kjo që po e thua ti kinse po paguajmë borxhe, ne i kemi kontratat me të cilat nuk ka punime. Ka projekte të reja sa të duash, kërkesa të qytetarëve në po ato kontrata. Borxhe paguan qeveria e Kosovës, madje ka krijuar edhe borxh publik, borxh të jashtëm. Asnjë investim kapital deri tanë, përvèq ministrisë së pushtetit lokal tash së fundi kanë filluar të lëvizin sado pak. Kjo është politik e arsyeshme dhe parimore. Ora nuk kthehet mbrapa kurr, ti je i zgjedhur, por zgjedhjet nuk i ke fituar ndërsa unë asnjëherë nuk kam thënë që i kam numrat në kuvend sepse unë nuk e kalkuloj qeverisjen me numra, qytetarët nuk janë numra. Ta parashtroj një pyetje ty; si anëtar i kuvendit, në cilin debat publik, konsultim dhe dëgjim buxhetor ke marr pjesë?...Ose e ke organizuar ti si grup politik?... Në asnjërin sepse nuk ka ndodh hiç. Prandaj a e dini që kryesuesit i kanë dështuar dëgjimet buxhetore?...kush ia ka dështuar? Grupi yt politik, Leonard. Prandaj ju nuk keni mundësi të bëni draft buxhet, sepse nuk punoni asgjë. Ekzekutivi ka për detyrë t'i bëjë takimet publike, dëgjimet buxhetore por normalisht i ka edhe kuvendi duke filluar nga kjo që kryesuesit të kuvendit nuk i keni qëndruar "karshi". Nuk e kemi marr mundit çoftë edhe një njeri t'a ftoni për të bërë një dëgjim publik si i ka hije kuvendit, prandaj unë nuk jam fajtor në çoftëse nuk e kuptioni buxhetin, nuk e ka kuptuar buxhetin në mirëfillje as Leonardi rrjedhimisht as ti. Qe 8 muaj është dashur t'a mësoni këllë fakt që; subvencionet, të hyrat vctanake janë rritur, buxheti është rritur për 2.494.000euro. E në këtë rast nëse duhet të flasim për turp, turpi iu takon juve që vetëm një dëgjim buxhetor e keni mbajtur, keni mundur t'i bëni 4 ose 5 dëgjime me kohë me standarde që bëhen 14 ditë para dhc jam i bindur që qytetarët që janë aktiv do t'i kishin paraqitur të njëjtat kërkesa sepse nuk ka diçka më shumë që kërkohet. Nuk dua të polemizoj as me Ilirin as me Leonardin dhe po them që nuk është detyra e juaj të votoni, por buxheti është ngjarja më e rëndësishme për një komunë. Ne kemi arritur t'a bëjmë një kombinim të mirë që kontratat i kemi mbuluar me projeksione buxhetore sipas standardeve dhe kemi hyrë në disa projekte të reja më pak se 1/3-ta.

Projekte të reja ka edhe në kontrata të vjetra sepse gjërat ende nuk kanë ndodhur. Për sheshin qëndror silitet qe dy vite, por pritet sivjet të lidhet kontrata, që e kemi mbuluar financiarisht. Ka projekt të ri që nuk ka qenë premtim i kryetarit të komunës; sheshi në qendër, por është duke ndodhur sepse e kemi fituar grantin dhe jemi në rregull.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Rasim Fazliu c ka kërkuar fjalën, para se t'a merr, dy fjalë unë rreth dëgjimeve buxhetore që i organizon KPF. Janë mbajtur dy dëgjime buxhetore, në njërin nuk ka pasur pjesëmarrje të qytetarëve. Ky fakt nuk mundet t'i faturohet grupit të lëvizjes vetëvendosje sepse lëvizja e ka vetëm një përsaqësues, atë e përfaqësoj unë si kryesues i komitetit. Nëse kanë dështuar dëgjimet buxhetore edhe pse një është mbajtur, atëherë i faturohet secilit grup të asambleistave edhe të AAK-së dhe të dy partive tjera opozitare, për shkak që nuk kemi arritur t'i flojmë njerëzit, në fund të fundit njerëzit me zor nuk mund t'i flojmë, interesimi ka qenë i vogël, kjo është arsyja që mund të quhet një lloj dëshimi por jo vetëm i lëvizjes vetëvendosje.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues. Me vëmendje e kam analizuar buxhetin dhe më vie mirë që për herë të parë nuk kam hasur si çdo vit me probleme rreth keqklasifikimeve dhe gjithmonë kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë vetëm për këtë punë, qeverisja komunale mundohej të na bindte që nuk është keqklasifikim, ne i thonim që është dhe kështu ishte puna me tollovi, megjithatë këtë vit më pëlqeu që nuk ka keqklasifikime. Buxhetin komuna e Rahovecit e ka aq sa e ka, nuk mund t'a rrissim as më shumë e as më pak, por, se si është i orientuar buxheti do të flasim me radhë; Më vie mirë që KPF ka kërkuar që kodet tëjenë të përgjithshme, më të analizuar, më të detajuar dhe mirë që ka ndodh kjo. Të them të drejtën nuk jam i kënaqur me detajet e ofruara këtu, te disa drejtori thuhet; lista e kërkesave nga ana e qytetarëve që janë mbajtur normalisht nëpër dëgjime buxhetore, çoftë nga qeverisja komunale, çoftë nga KPF që është dashur t'i mbaj të gjitha dhe kjo gjë drejtpërdrejt i faturohet kuvendit komunal, kryesuesit bashkë me anëtarët e KPF-së sepse e them me bindje që në vitet e kaluara KPF e ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm, ka raportuar para kuvendit me listë të projekteve duke i hartuar shumë mirë, asgjë nuk ka patur abstrakte, cdo gjë ka qenë konkrete, këtë herë më vie keq që ka ndodh kështu, por pajtohna me kryesuesin që i faturohet të gjitha grupeve politike. Unë besoj që nuk janë kërkuar listat e kërkesave, sepse lista e kërkesave është shumë e madhe nga qytetarët. Unë kam pritur që ju drejtorë të nderuar do të futni në listë vetëm ato kërkesa që mund të realizohen me buxhetin e vitiit 2023, duhet të jetë e saktësuar sepse siç e dini buxheti ndahet çdo vit. Kur të dal nga kjo mbledhje, nëse më pyet ndonjë qytetar se çfarë do bëni për Celinën, Çiflikakun ose për Operushën duhet të jem në dijeni që t'i them që do të bëhet kjo, kjo, ky projekt etj... etj, mirëpo nuk ka listë konkrete sepse unë duhet t'a dij që me buxhetin 2022 çka po realizohet në Celinë?... Nëse më pyet dikush, nuk mund t'i tregoj asgjë sepse është komplet lista, nuk e di çka do të realizohet saktë. Buxheti për vitin 2023 gjithashu nuk ka listë konkrete që të thuhet se në vitin 2023 do të bëhet kjo...kjo...ky projekt. Jo me qenë një listë e gjatë e më pas nuk e dijmë cili projekt kalon tutje, e cili jo. Në këtë drejtim me këtë listë jam i pakënaqur. Do të dal konkretisht në disa projekte, deshta të pyes për informacion drejtorin e bujqësisë; e kemi kanalin e kullimit të tokave bujqësore Celinë – Fortescë në vlerë prej 239.520 euro dhe i gjatë qenka 8760 metra, pyetja është; kah do t'a ketë shtrirjen ky kanal? Shtratin? Më intereson shumë ku nis dhe ku përfundon sepse unë jam prej atij vendbanimi dhe e di mundësitë aty. Tjetër, unë e kam një kërkesë kryesore të vogël që nuk është e paraparë këtu në buxhet. Celina përvëç shkollës që e kemi të ndërtuar nga KARITAS-i gjerman pas luftës, që e falënderojmë shumë, tjetër objekt nuk kemi të rëndësishëm të ndërtuar prej komunës dhe quditërisht 20 vite kaluan dhe asgjë nuk kemi as ambulanca as shtëpi të kulturës. Një shtëpi të kulturës e kemi që e kemi ndërtuar në vitet e 90-ta me vet kontribut me fshatarët, mirëpo fatkeqësisht ajo shtëpi sot e asaj dite ka mbetur pa meremetim brenda. Është jetike për banorët e fshatit Celinë sidomos për shkollën, nxënësit dhe arsimtarët por edhe partitë politike sa herë dëshirojnë t'i mbajnë mbledhjet, qytetarët e Celinës etj... Prandaj,

propozoj të futet në buxhet projekt dhe të kryhet në vitin 2023 sepse mendoj që aty nuk ka nevoj për investime shumë të mëdha dhe e luan një rol shumë të madh, nuk kemi nevoj të hyjmë nëpër shkolla ose objekte tjera, shtëpi private etj... Kërkesa ime dhe propozimi im është meremetimi i sallës afér shkollës të hyn në këtë buxhet për vitin 2023. Kryetari i ka situar zgjedhje, a bën koalacione a jo, është problemi i tij dhe unë nuk e lodhi kokën për punën e kryetarit se çka bën ai. Çdo kuvend komunal sipas meje në nivel të Kosovës është i obliguar t'a miratoj buxhetin, por në çoftëse unë jam kundër propozimit që e ka dhënë qeverisja komunale, unë duhet të dal me propozime konkrete duke thënë në këtë kod e dua këtë ndryshim, kryesuesi e vendos në propozim dhe në çoftëse miratohet nga shumica atëherë ecim tutje. Prandaj, nuk është c mjaftueshme me thënë e votoj buxhetin, se votoj buxhelin. Duhet të jepim propozime konkrete, vetëm atëherë e luajmë rolin e një anëtarit të kuvendit. Unë si individ meqenësë nuk kam ndonjë propozim tjetër, pos atij që e dhash më herët dhe që kam qejf kryesuesi t'a vendos si propozim para kuvendit, nuk kam ndonjë vërejtje tjetër dhe unë si Rasim Fazliu do t'a votoj buxhetin. Faleminderit që më dëgjuat.

Kryetari – Faleminderit Rasim Fazliu. E lus Beratin të flet rreth kanalit të kullimit të tokave bujqësore Fortesë – Celinë dhe t'a tregon trajektorën kah i bie. Është punuar diçka, por kemi kontratë edhe sivjet edhe vitin e ardhshëm. Mund të them që projekte kontrate për secilin vendbanim në këtë rast edhe për Celinën, mund të them që shumë shpejtë synojmë t'i përmbyllim varrezat e martirëve, synojmë t'a përmbyllim projektin që e ka "Mendi SH.P.K." me përroin, rrugët fushore, ndihmë për fermerët në bujqësi, projekte në kubëzim etj... Unë jan dakord, në çoftëse është dakord edhe Afrim Limani, ajo shtëpi në Celinë është e gatshme edhe duhet me qenë funksionale për aktivitete kulturore, publike, sportive. Afrim Limani të na tregoj a mundemi tanë t'a fusim në buxhet, apo me bartje të mjeteve? Unë e jap zotimin publik, jo para Rasimit, por para qytetarëve të Celinës dhe të komunës që është i nevojshëm renovimi në plotni i atij objekti që është i gatshëm. Andaj në emër të ekzekutivit të komunës shprehi gatishmërinë, shpresoj që të gjithë grupet politike do t'a mirëkuptojnë sepse është një kërkesë shumë real. E lus drejtorin e financave nëse ka mundësi të na jep ndonjë detaj për këtë kërkesë specifike të Rasim Fazliut.

Afrim Limani – Mësues, për shkak të buxhetit të limituar që e ka drejtoria për kultur, sepse ky projekt hyn në kuadër të drejtorisë së kulturës. Kisha propozuar dhe zotohem para juv që këtë projekt t'a përfundojmë me bartjen e mjeteve në fillim të shkurtit dhe hapësirën me kohë e kemi të mjaftueshme si t'a vendosim në listën e projekteve kapitale si kështu afati kohor është i mjaftueshëm për realizim.

Rasim Fazliu – E falënderoj kryetarin edhe drejtorin për mirëkuptim, për mua është e rëndësishme që në vitin 2023 të realizohet. Kaq.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Kryetar, unë po nisem pak më ndryshe, nuk është faji i kryesuesit e as i KPF-së. Kryesuesi i kuvendit komunal në Rahovec e ka krijuar një grup të KPF-së në "Whatsapp" të cilin grup i ka kërkuar të takohen për dëgjime buxhetore dhe për buxhetin. Përfaqësuesja e Aleancës në KPF dhe shefja e grupit të asambleistave të AAK-së ka thënë që nuk ka arsyë për takim, përndryshe e kemi diskutimin në bisedë, mundemi t'a prezantojmë kur të doni. Nuk ka qenë mungesë destruktiviteti jonë, por ndoshta për shkak të fitores së fundit dhe për shkak të votave c'ka bërë një mbivlerësim që të mos të përfillet kërkesa e kryesuesit për takim paraprak. Nëse nuk është kshtu duhet të ma demantoni cilido prej KPF-së. E dyta, para se të diskutoj rreth buxhetit, po nisna te obligimet buxhetore; 8.887.000 euro sipas raportit të drejtorisë së financave janë borxhe dhe obligime kontraktuale, kur them borxhe them në kuptimin e plotë sepse rreth 595.000 janë borxhe sepse janë kontrata të lidhura të vitit 2019 të cilave iu ka skaduar afati i ligjshmërisë së kontratës. Kur flitet për rastin, p.sh shkolla fillore e mesme e ulët "Liria" Fortesë, ndoshta operatori ka qenë i fortë dhe ka punuar para kohe, por drejtori duhet të thotë kuartë që janë afate ligjore që duhet përbajtur. Nuk jemi këlu në pazar, i fortë e i butë por ai e përfundon dhe duhet t'i përbahet afateve ligjore në përbushjen e obligimeve të veta. Te pjesa tjetër, sot kam pritur që materiali në seancë të na vici

pak më i harmonizuar, serioz, i kompletuar, të ketë një logo të komunës në fillim, të ketë një përshkrim filletar, qëllimin, synimet, çka pritet prej buxhetit, çka të realizohet, pastaj lista e investimeve kapitale dhe në fund listën e projekteve të detajuara dhe një përbledhje të caktuara dhe një nënshkrim çoftë i kryetarit të komunës çoftë drejtorit të drejtorisë së financave. Ka ardhur një fletë - një vendim, buxheti n'Exel dhe lista e investimeve. Dokumenti është i shthurur, nuk është serioz të paraqitet para asamblesë komunale. Sa i përkel buxhetit brenda, te çështje e subvacioneve zyra e kryetarit i ka nevojat e veta, e di që ka shumë kërkesa të qytetarëve, nevoja për mjekim që kryetari ka të drejtë të ndajë ndihmë, çshtë mirë qe e ka. Janë 160.000 / 2023-2025, por 401.680euro në 2024 nuk kam mundur t'a kuptojë kurr! Çka ka në vitin 2024 që zyra e kryetarit e ka 401.680euro subvacione. U tha vazhdimisht edhe prej kryetarit që kultura rinia dhe sporti e kanë hapësirën e vet, kanë me qenë të përkrahura dhe nuk harrohen. DKRS për subvacione i ka vetëm 110.000euro. E kam bërë një pyetje më herët se çka do të ndodh me shtëpitë e kulturës që nuk iu ka qelë dera për 4 vite dhe sivjet nuk iu qel dera asnjerës. Asnjë aktivitet nëasnje shtëpi të kulturës në komunën e Rahovecit nuk ka patur, përvëç aktivitetave dhc ngjarjeve që i kemi pasur për promovime të caktuara dhe ndonjë debat, këshill të fshatit, por jo ngjarje kulturore. Te aspekti i përbledhjes së obligimeve, kur e shohim në total buxhetin dhe projekcionet buxhetore për 3 vitet e ardhshme është fakt përbledhet, por kur e prejmë në vite, dalim jasht afateve ligjore d.m.th nuk e përmbyllim në 2023 obligimet e kontratave që përfundojnë në 2023, përsëri barten borgje në 2024. Te subvencionet në bujqësi; për 2023 i kemi 440.000euro mirë është kjo rritje e subvacioneve dhe iu ka mundësuar ikjen prej keqkualifikimeve të kodeve buxhetore, por sipas shënimive që na ke dhënë drejtor, për mekanizma bujqësorë kapin vlerën 674.797euro, vetëm në vitin 2021 janë 243.539euro duke patur parasysh numrin e mekanizmave bujqësorë që janë përndarë, kjo nënkuption që në 2023 do t'i paguani këto mekanizma bujqësorë përsëri dhe nuk do të ketë mundësi të çasemi ndyshe në subvacione të bujqëve, çoftë në fazën fillestare, ndihmë në plehëra apo farë, apo çoftë në produkte finale në çoftëse mendohet të subvencionohet ndryshe d.m.th ky borgj apo obligim kontraktual që e ka drejtoria e bujqësisë në raport me mekanizma bujqësorë me këtë shumë prej 440.000 nuk mund të mbulohet, në 2023 nuk mund të jep subvacione në inpute bujqësore, plus nëse kemi parasysh edhe 137.657euro që janë obligime për ndërtim të serrave me bashkëfinancim. Te investimet kapitale e kam bërë pyetjen edhe në KPF po është marrur me të qeshura. Ky liti ose ashensori i komunës i ka vetëm 5000euro, përfundimi ose totali është 15.000euro, këto 10.000 tjera kah vijnë nuk e di!... Te shërbimet publike; Ndriçimi publik në komunën e Rahovecit, kontrata e vitit 2019 e ka vlerën 222.846.85euro borgje të mbetur, buxheti i 2022 është 90.000 d.m.th përsëri mbetet në 2023, nuk po mbërrin kontratën e 2022 të mbyllt në afat ligjor, po e bart në borgj 2023. Ndërtimi i rrugëve; obligimi është 399.944.95euro e lidhur në 2020 të përfundoj në 2023, buxheti 2022-2023 i parashevë 550.000, mbetje janë 150.000, ndërsa lista e rrugëve që është paraqitur përfshin 23km rrugë plus me grantin e performancës bëhen rrëth 40km rrugë. Në çoftëse bëhet 40km rrugë me 150.000euro, tregoni ku se unë personalisht do t'a shtroj por nuk bëhet kjo, nuk e keni të specifikuar se cila rrugë bëhet 2023 e cila 2024. Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve te shërbimet publike; obligimi që është i mbetur prej 2021 e kap vlerën 463.490euro duhet përfunduar deri në 2024, ndërsa buxheti 2023-2024 është 380.000 që nënkupton mbi 80.000 prap të mbisin borgj e të bartë, nuk mbylljet finanziarisht si duhet. Te bujqësia; Kanali Shtavica – Fortesa thotë që do të përfundoj në 2025, a nënkupton kjo që edhe në 2023-2024 Fortesa do t'i ketë këto probleme me vërsime?! Kanali për kullimin e ujërave Rahovec- Fortësë-Dejnë-Çilliak-Sopniq, kontrata 2021 me borgj 3.354.190euro afati i kontratës deri 2024, buxhetimi çshtë 1.1670.000euro pra nuk e mbulon kontrata edhe 1.707.000 të mbisin obligime dhe dalin përtëj kontratës. Zona ekonomike në Opterushë; parashihen investime të vazhdueshme deri në 2025. A nënkupton që kjo nuk arrin të përfundoj dhe të jetë funksionale deri në 2025?... I kemi dy kode buxhetore që janë kontradiktë mes veti, ndërtimi i infrastrukturës për tregun

c rrushit “Hardh fest” faza e dytë dhe ndërtimi i objektit të depos bujqësore. Ku do të bëhet kjo depo bujqësore, a është i njëjtë lokacion? Kur është prezantuar te bartja e mjeteve është thënë që depot bujqësore do të bëhen te ish tregu i rrushit, do të investohet depoja apo ambienti për Hardh festin? Janë dy projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me të njëjtin vend. Sa i përkel çështjes së stadiumit, në 2022 nuk e di që bageri e ka bë ndonjë lëvizje nalt, cndc asgjë konkrete. Në çoftëse fillon sheshi pa e definuar stadiumit, do të vështirësohet kualiteti i lojës të KF Rahovecit nëse detyrohet të luajnë jashtë Rahovecit, bie shikueshmëria, nuk e ka entuziazmin e vet. Te lista e projekteve; Te drejtoria e kulturës nuk e pashë askund objektin e shoqërisë kulturo-artistike “Bajram Curri” që është paraparë si zhveshtore, nuk figuron askund. Buxheti 2023 ka vetëm 20.000euro për zgjerimin e ujit të pjes, a nënkupton kjo që Senoci edhe në 2023 nuk do të ketë ujë të pjes sepse janë dhënë mbi 30.000euro janë bërë disa shpuarje por pa rezultat, e kurse me 20.000 nuk bën hiç kjo punë. Mungon një planifikim serioz i trajtimit të ujërave të zeza në komunën e Rahovecit. Besoj që në 2023 duhet t'a kemi projektin detal dhe të kompletuar të trajtimit të ujërave të zeza në komunën e Rahovecit. Në përjashtim neve që kemi fat që ujërat e zeza derdhen në lum, shkoni në Pataqan, Senoc, Drenoc te të gjitha lokalitetet që nuk kanë lum afër, janë në gjendje epidemike sidomos gjatë stinës së verës. Si përfundim, mungesa totale e planifikimit buxhetor, borgji i trashëguar, kontratal e papërfunduara, obligimet kontraktuale të paplanifikuara mire sepse e ceka më lartë në 4 vite mbulohen, për ndër vite jo. Borgjet që janë krijuara me kontratal të lidhura në vitin 2020 nuk mbulohen komplekt në 2023. Ato që janë lidhur në 2021 nuk janë planifikuar mjaftueshëm të mbulohen në 2024, nuk është planifikuar pakoja jubilare, nuk ka asgjë rreth kontratës kolektive, nuk ka fond emergjent sepse kemi padi në gjykata që nesër mund t'i humbasim. Nuk ka një vizion të kuartë të zhvillimit të komunës në aspektin ekonomik, nuk ka askund diçka rreth agroturizmit që e kemi promovuar prej të gjithë neve në fushatë zgjedhore, asnjë rresht ose asnjë veprim konkret. Nuk ka përkrahje të kulturës dhe sportit për faktin që subvencionet janë aty ku janë, mund të ketë edhe dëmtim të stadiumit, për faktin që është dëshmuar që për 5 vite nuk ka aktivitete kulturore nëpër shtëpitë e kulturës që i kemi. Nuk përkrahje në prodhim për fermer për faktin që subvencionet në bujqësi nuk mund t'i mbulojnë borgjet ose obligimet kontraktuale që i keni të lidhura sot. Thjeshtë ky buxhet vazhdon me të njëjtin avaz që c bën komunën tonë jo interesante për vizitorë me përjashtim të “Hardh festit” që është ngjarje që është trashëguar dhe e ka marrë hovin e vetveti, përvçe që nuk kemi vizitorë edhe 80% të mjeteve tona që i fitojmë ne në komunë të Rahovecit dhe 80% të mjeteve të mërgimtarëve që vijnë, i shpenzojmë jashtë komunës së Rahovecit. Mendoj dhe besoj që buxheti duhet t'a ketë një orientim që sa më shumë të hyra tonat t'i shpenzojmë këtu dhe sa më shumë të të hyrave të mërgimtarëve të shpenzohen këtu, si dhe sa më shumë vizitorë të ketë për të ritur të hyrat e komunës, ta bëjmë këtë vend të jetueshëm mjaftueshëm. Kryetar, pa dashur të bëjmë politikë me buxhetin, është mirë të bashkëbisedohet edhe me të tjerët, e thash në fillim ka mungesë bashkëbisedimi në mes grupit të Aleancës dhe grupeve tjera në draftimin e buxhetit, duhet t'i ndëgjojmë bashkëpunorët profesionist brenda dhe jashtë komunës. Si përfundim me bindje të plotë e them mbi bazën e analizave që i kemi bërë si LDK në mbjedhjen e saj mbrëmë, del që buxheti përpos që nuk ka projekte të reja, nuk arrin të stabilizohet financiarisht, përsëri bart borxhe dhe nuk mbyllen kontratat në afate ligjore. LDK e thotë atë që është në harmoni me veprimet e saja, nuk është LDK që thotë që; ne nuk pajtohem me formën se si është bërë buxheti, me vërejtjet që i dhamë e në anën tjetër për hirë të qytetarëve e votojmë buxhetin, kjo është lojë politike. Kur them që diçka nuk është mirë, ne mendojmë që nuk është në të mirë të qytetarëve e jo në të mirë tonën. LDK nuk pajtohet me këtë format të buxhetit me vërejtjet që i dhamë më lartë, mbi të gjitha mospërbushja e të gjetura të ZKA-së ku thotë që ka vonesa në zbatim të kontratave dhe si e tillë grupi i asambleistave të LDK-së këtë format të buxhetit nuk e përkrah.

Kryetari – Unë nuk jam befasuar me Leonardin se e kuptoj, jam befasuar për të keq me Burimin, i cili flet gjëra që nuk kanë lidhje as me ligjin as me realitetin. Kontrata kolektive nuk mund të buxhetohet për vitin 2023. Më vie pak “marre” ajo që duhet t’ a them, por duhet të konsultohesh pak me rrethanat pak me ligjin, çka është kontrata kolektive dhe si paguhën mësimdhënësit sipas kontratës kolektive. Eshtë kodi kategoria paga dhe mëditje, prej këtij kodi marrin, ndërsa më vie keq që nuk ke ndryshuar asgjë prej debateve zgjedhore, as atëherë nuk ke folur saktë, as sot nuk je duke folur saktë. Aktivitetet kulturore në shtëpitë e kulturës, më vie përsëri marre që duhet me të thënë, e hiç nuk je i lumbtur ajo që do t’ a them, përvëq në Xërxe që nuk ka aktivitete kulturore në shtëpinë e kulturës. Në Krushe të madhe, Rahovec, në Ratkoc te kjo e reja në të gjitha ka aktivitete kulturore me një mori promovimesh, pavarësisht që dikush priton të merr pjesë sepse mendon dhe frigohet që fiton ndonjë gjë kryetari i komunës përkundrazi, jeta kulturore në komunën e Rahovcit është jashtëzakonisht e pasur, kemi lloj-lloj aktivitetesh kulturore dhe përkujtimore që mbahen në shtëpinë e kulturës por edhe në këtë sallë të kuvendit. Në Drenoc nuk ka shumë aktivitete kulturore sepse nuk ka shoqëri kulturo-artistike, ndërsa më vie keq që ne e ndihmojmë shoqërinë kulturo-artistike të Xërxes dhe nuk ka aktivitete kulturore në shtëpinë e kulturës të ndërtuar në Xërxe. Përndryshe shtëpia kulturore në Xërxe është e përshtatshme për aktivitete kulturore dhe e inkurajoj shefin e LDK-së që cdhe ky të merret sado pak me aktivitete le t’ a gjallëron pak Xërzen. Ujërsat e zeza; Ne kemi problem me impiantë të ujërave të zeza, nuk kemi problem me kanalizim të ujëravc të zeza, kemi problem me derdhje të ujërave të zeza sepse nuk ka impiantë të ujërave të zeza dhe impinanti i ujërave të zeza kushton kushton 30 milion Burim Krasniqi dhe nuk është mirë në kuvend me fol “kodër mas bregu” sepse e din shumë mirë që nuk është ashtu siç the dhe nëse LDK-ja paska paska mbajtur mbledhje duke i bërë këto analiza, po më vjen keq shumë për LDK-në. I kemi 20.000euro për ujë të pijshëm; ne kemi memorandum të mirëkuptimit me K.R.U Gjakovën. Po e potencoq që provokacionet e tua që a do të ketë ujë Senoci, projekt i është mbi 500.000euro, kurdo që i nis procedurat K.R.U Gjakova, unë i dal zot me 49% të mjeteve, a e dini se K.R.U Gjakova nuk ka marrë asnje financë prej së zhvillimit ekonomik siç ka marrë çdo vit dhe sivjet nga vetfinancimi dhe inkasimi i mjeteve mezi i ka bërë paratë për projektin Vranjakë – Bratotin se as atje nuk ka ujë të pijshëm. Është shpallur procedura dhe është lidhur kontrata 31.000euro. Kur do që të jetë gati K.R.U Gjakova çoftë për projektin Senoc – Drenoc çoftë për projektin në lagje të epërme, Hoqë e Madhe, Zogisht, Opterushë, këtu është komuna e Rahovcit dhe mos u lodh hiç për këtë punë a i kemi 20.000 apo sa i kemi. Asnjë borgj nuk ia kemi K.R.U Gjakovës në realizimin e investimeve kapitale. Ke folur për “Hardh festin” dhe një kontratë në fazën përsundimtare të tregun të madh të rrushit, ke folur edhe për një kontratë që është e ndryshme, për ndërtimin e depos ose qendrës së magazinimit të prodhimeve bujqësore, po, depoja bujqësore do të bëhet pikërisht aty ku kanë qenë kafiteritë, është kontratë tjeter nga ajo që e kemi për trajtimin e tregut të rrushit. Janë dy kontrata të ndryshme të cilat ndodhin në një pronë. Është me fat që depoja është në fazën e vlerësimit në depon bujqësore, është fat që komuna jonë e ka zënë vendim e parë për performance për vitin e kaluar dhe një pjesë të granteve është dedikuar për qendrën e magazinimit të prodhimeve bujqësore. Te zona ekonomike; A do t’ thotë që në vitin 2025 do të funksionalizohet zona ekonomike, mezi e kemi themeluar si zonë ekonomike në 2020 në janar është licencuar dhe qe dy vite duke luftuar për investime dhe tanë është lajm i mirë që ata e kanë procedurën për të filluar investimin në funksionalizimin e zonës ekonomike dhe ju thash 1.5 miliona janë prej ministrisë, 300.000euro komuna, por prapë nuk mbulohet e gjithë vlera sepse vlera e parashikuar e projektit është 3.159.000euro minimumi dhe me çfarë çmimi lidhet kontrata, këtë nuk e di. Te kanalet e kullimit; Këtu herë thuhet nuk po investoni në kanale të kullimit, herë thuhet pse po investoni në bujqësi. Të ishte shteti jonë i zhvilluar, komuna nuk është dashut të merret mc kanalet e kullimit të tokave bujqësore, por ja që ne duhet të merremi me këto t’ a ruajmë jetën e qytetarëve, pronën dhe tokat bujqësore. Burim Krasniqi, ti e din shumë mirë, je zyrtar me përvoj në

institucionë publike, e din shumë mirë që thirret një farë vazhdimi i sigurimit të ekzekutivit të kontratës, pra kur kontrata skadon, e thirr operatorin nëse dëshiron t'a vazhdoj edhe për një vit përmes zyrës së prokurimit. Ne kemi menduar, a kemi llogari t'i shkëpusim këto kontrata që janë më të vjetra apo të tentojmë të krijojmë marrëdhënie të re duke vazhduar sigurimin e ekzekutimit të kontratës ekzistuese. Auditori na ka dhënë vetëm rekomandim që pse nuk e kemi vazhduar sigurimin e ekzekutimit të tenderit për qerdhen e fëmijëve në Ratkoc dhe për rregullimin e shtratit të lumit që ndanë Krushën me Celinë, pra auditori nuk ka thënë pse është vonuar kontrata, problemi është që ne nuk e kemi vazhduar dhe nuk e kemi ditur që duhet ta vazhdojmë dhe kemi marrë rekomandim që të gjitha kontratat që skadojnë ju vazhdohet sigurimi ose riformatisohen dhe gjejmë forma për të lidhur kontrata të reja. Trottualet; Ka trottualet që janë bërë sivjet, por mos harro se ti e din, në çoftëse janë kontrata të vjetra dhe nuk kanë filluar ende të zbatohen dhe ti e din që ligjin thotë; 70% kemi të drejtë ta zbatojmë d.m.th ne i japim përparësi vctes me operatorët e lodhur që nuk ka ecir puna mirë. Por ne nuk e kemi këtë problem, problem e kemi sfidën e rrëtjes së çmimeve dhe mbulueshmëria e 20%, nescë miratohet në kuend dhe ky 20% ka gjasë t'i riaktivizoj operatorët dhe t'i rikthej në punishte. Nuk është më e njëjtë këngë si në vitin 2021 dhe e din shumë mirë që çmimet janë tjera dhe ka vështirësi. Te afatet ligjore Burim, ti ose nuk e din, por unë jam i bindur që e din, bile kur po thua kemi mbajtur si parti mbledhje, analiza dhe debate, mendoj që edhe mos t'a dije ti, tjerët që kanë qenë po. E din që afatet ligjore tejkalohen me vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës sepse rrëtja e çmimeve te ne i ka bllokuar edhe operatorët më të fuqishëm, janë lodhur dhe dërrmuar dhe vonesa e kontratave është si pasoj e kësaj gjendje. Zyra e kryetarit të komunës për subvencione për sivjet buxhetin e ka palur 129.000 euro. Kultura sporti dhe Rinia 100.000 euro dhe unë shumë subvencione nga zyra ime i kam ndihmuar sportit kulturës dhe rinisë dhe bursa për studentë. Te subvencionet se si do ti përkrahim imputet bujqësore; iu tregova këtu ose unë nuk di ta them saktë, ose nuk kuptohem drejtë. Thash që mekanizmi bujqësorë është pjesë e pagesës së kontratës, ka përfitues të shumtë, nuk guxojmë t'i anulojmë këto kontrata përkundër vonesës sepse janë të nënshkruara dhe paljetër që duhet t'i ekzekutojmë. Këto kontrata nuk janë për 1 vit, vazhdojnë edhe në vitin 2024 dhe neve na krijohet hapësira që subvencionet që i kemi të hyjnë në impute bujqësore dhe krijohet një sistem tjetër të subvencionimit të bujqësisë. Nuk e di si flitet më thjesht e më saktë, nuk është retorikë por është logjik reale origjinalë e zhvillimit. Nuk do të ketë kontrata të reja për mekanizëm bujqësorë, do t'a mbajmë pozicionin e serrave dhe do t'i shohim mundësilë me imputë bujqësore, rrugë fushore, kanale të kullimit, përkrahje të qendrave të grumbullimit, përkrahje të qendrave të përpunimit të perimeve, përkrahje të bujqëve të rinjë etj... etj... Ky është buxheti i komunës së Rahovecit dhe nuk mund të hyjmë në obligime tjera pa i përfunduar këto të vjetrat, nuk mund të hyjmë në projekte tjera përtëj mundësive buxhetore që përcaktohet me ligj, prej qeverisë si donacion çka të vjeç mirësevjen dhe besoj që do të vijnë edhe projekte të tjera të cilat nuk diskutohet në seancë të kuvendi të komunës. Po të ftoj edhe ty edhe LDK-në për reflektim, e keni kërkuar listën e projekteve kapitale gjithashtu listën e obligimeve, ja ku e ke, kërkuesi ke qenë ti. Kur i ke kërkuar të gjitha këto, LDK-së është dashur t'i thoni votojeni dhe meqenëse ti kemi dhënë të gjitha, ne ta japim mundësinë ta votoni buxhetin me gjithë grupin politik. Faleminderit shumë.

Burim Krasniqi – Kryetar, nuk po ta përmendi emrin për të kërkuar replikë, por meqenëse jci i pari i komunës e kam obligim të të drejtohem. Nuk është ajo se si po e thoni ju, ne të gjithë e kemi keq, veç ti e ke mirë. Nuk ekziston mundësia të gjitha partitë tjera keq, të gjithë keq, Burimi mos me ditë, Leonardi gjithashtu, LDK me pasë gabim, kalkulimi gabim, e ti me pasë mirë, ka diçka që nuk është mirë te ti, aty. Është dashur të bashkëbisedojmë me kohë, e jo ta injoroshi ftesën e kryesuesit për bashkëbisedim të përbashkët të të gjithë asambleistave për t'a parë buxhetin, diskutimet buxhetore dhe draftimin e buxhetit, kur nuk përfillet dhe nuk merret parasysh është pak "arrogance e votës" në raport me partitë opozitare. Uroj

që i keni votat dhe e kalon buxhetin i cili është i qytetarëve, jo i joti, është fakt i shërben qytetarëve. Megjithatë ne si LDK nuk jemi sot, por është një traditë, ka njerëz që kanë qenë kryeshef ekzekutiv, nënkyetar komune, drejtora, kryesues, që janë të vetëdijshëm plotësisht për qëndrimin politik që e kanë marrur mbrëmë në raport me draft buxhetin që është bërë. Në LDK të gjithë anëtarët informohen në plotni me zhvillimet në asamble komunale me materiale, sepse jemi të hapur plotësisht brenda shtëpisë tonë. Qëndrimi është i përbashkët dhe jo individual dhe nuk është ai autoriteti i Burimit në LDK që e determinon formën e sjelljes së LDK-së ose votimin në asamble komunale. Kërkoj mirëkuptim dhe mos të dalim që çdo herë ne e kemi keq, ka pak më shumë se ajo.

Kryetari – Burim, më vie keq por asnjëherë nuk e thash që jam më i dituri. Të them të drejtën burur disa gjëra i di, por më i dituri nuk jam. Unë jam i zgjedhur nga qytetarët, kryetar i komunës dhe në çoftëse i takon dikujt të flet në emër të qytetarëve dhe subjekteve politike, po flas unë, realisht i bie që jam mbi subjekte politike sepse jam kryetari i komunës, e ti e morre përsipër me fol edhe në emër të subjekteve politike. Unë thash për juve që pikërisht që i dini gjërat, po më del diçka tjetër te ju, edhe i dini edhe në fund nuk p'e votojmë buxhetin, kështu i bie kjo punë, sepse ti i din shumë mirë këto që po t'i them, bile unë të thash, në çoftëse ti nuk i din, ata që i ke pasur në takim kanë një përvojë dhe të kanë thënë; kërkoje listën e obligimeve në kuvend, parashtroje pyetjen; pse në 2024 zyrës së kryetarit iu kanë shtuar subvencionet, nëse dëshiron t'i them edhe tjerat se çka keni diskutuar aty, ne jemi të hapur dhe më duhet të bëjë partneritet me LDK-në për shkak të transparencës. Vlerësoje ti a e volon apo jo, por mos harro që unë nuk jam arrogant, e kam dëgjuar një komunikatë publike unë mbrëmë, e sot do të isha në dri duke shikuar se kush po zë peshk, por nuk jam arrogant sepse kam dashur të debatoj këtu, votat janë, i besoj komunikatave publike. Nuk jam unë prej atyre që i iki përgjegjësive, jam shkaktarë që po vonohna, përndryshe e ftoj kryesuesit t'a vendos në votim buxhetin dhe jemi në rregull.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Vazhdojmë me 5 minuta pauzë, rikthehemë prapë në seancë.

Kryesuesi – Përshëndetje edhe një herë për të gjithë, jemi në pikën e gjashtë të rendit të ditës, diskutimi është i hapur rrëth buxhetit për vitin 2023.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit këtu në sallë. Fillimisht dua të them që ne grapi i vetëvendosjes, i shterrëm mundësitetë dhe debatet në zyrën që e kemi në Rahovec, me mendimet tona, pas mendimeve dolëm në konkluzione dhe pas konkluzioneve dolëm me qëndrime konkrete. Qëndrimin tonë e prezantoi këtu shefi jonë i respektuar Leonard Morina. Mendoj që këtu te borgjet publike komunale, vlera totale është 8.797.511 euro, ajo që rastis të shoh te ky borgj publik prej kontratave që janë të ndërlidhura mes komunës dhe nënkontraktorëve është gjithsej 15.735.665 euro, këtu po i bie që janë borgj më shumë se gjysma e shifrës totale por ajo që më rastisi t'a shoh është që të gjitha borgjet që janë këtu; p.sh. shkolla e Bellacërkës u fol shpesh, ndërtimi i rrugëve është bërë në via të trasha pa specifikim se ku do të bëhet konkretisht. Në rubrikën e fundit më bën përshtypje dhe thotë; kontratat janë në proces. Kryetari disa herë e përsëriti ku tha që operatorët për shkak të ndritjes së çmimive kanë stagnuar në përfundimt e punëvc që i kanë të kontraktuara. Unë nuk dua të shes mend këtu por, kur lidhet një kontratë ta mendojmë hipotetikisht nëse një firmë, operator që po e quan kryetari ka marrë një kontratë prej komunës së Rahovecil, supozojmë 100.000 euro dhe brenda një muaje çmimet bijnë dhe ai i ka fitimet diku rrëth nëse parashihet 30% ai fiton 60%, shtrohet pyetje; a i thotë ai komunës që kam fituar shumë dhe dua të t'i kthej paret. Nuk ka kështu, as logjik, as ligj as asgjë. Kur jemi te kontratat; kontrata bëhet me pëlqimin e dy palëve, në këtë rast kontraktorit dhe nënkontraktorit, sa ka të drejtë ai nënkontraktori që e merr punën ka edhe detyrime dhe që i bie me ligj vendor dhe ndërkontaktor në momentin që nuk kryhet puna në kohë të caktuar se si është bërë me paragafe të kontratës me kushte të përgjithshme dhe të veçanta ai hyn në penalliti nga punëdhënësi në këtë rast, poashtu siç po e përsërit kryetari shpesh p.sh firma euroingi mund të na dërgoj

te përmbaruesi, a e kuptoni?.. sa kemi të drejtë si komunë, kemi edhe detyrime ndaj tij, kur e përfundon punën në kohë të caktuar dhe pagesa të bëhet në kohë të caktuar. Shefi jonë i grupit Leonardi që propozoi kundër buxhetit, gjatë diskutimit brenda në parti Leonardi ngriti si shtetësim duke thënë që zona industriale – ekonomike në Opterushë ka filluar në 2013 dhe ky e përdori atë logjikën që prej 2013 – 2022 tha që dyshoj që bëhet diçka e mirë këtu pavarësisht atij përlqimi nga ministria. Mendoj që është mirë të na respektoni mendimin tonë, neve na ndëshkon qytetari nëse e kemi gabim. Këtu jemi të japid kontribut aq sa dimë e aq sa mundemi, nëse e kemi gabim jemi në prani të mediave dhe qytetarët na ndëshkojnë. Do të ishte mirë që kryetari së paku të na kishte stuar për një kontribut në hartimin e këtij buxheti. Fatkeqësisht nuk jemi përsill nga askush. Më ka munduar fakti që shpesh kryetari këtu në asamble na ka paragjykuar që kemi bërë martesë – konorizim me partitë opozitare. Kryetari mund t’ a tërheqë këtë sepse fakti i sotit po del që ka qenë gabim dhe sot po vërtetohet që konorizim nuk me patur me asnje parti opozitare pavarësisht që kemi qenë të koordinuar për të mirë të qytetarit. Sot po e kuptoj që partia opozitare me ekzekutivin kanë bërë një fejesë që nga ana juridike fejesa i bie premtim për martesë dhe besoj që në të ardhmen do të kurorëzohen.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit për urimin Sinan. Ashtu si thua ti, hipotetikisht ke të drejtë se ashtu ka qenë. Burimit, Leonardit, kryetarit po edhe partisë time kam replikë shumë. E para; kryetari i tha Burimit që çdo send që e keni kërkuar iu kam realizuar, i bie që LDK-së ia ke plotësuar çdo kërkësë dhe nuk po të votojnë. Çka do që kam kërkuar unë këtu, nuk çshëtë bërë asgjë dhe unë kam vendosur të abstenoj ose kundërshtoj, por mund të më mbushet mendja si Rasimit që nëse kërkoj diçka për qytetarët e Krushës së Madhe edhe unë mund të hyjë në këtë fejesë. Kësaj radhe nuk po flasë si pjesë e grupit parlamentar, por si Sefë dhe si qytetar i Krushës. Partia ime ka dalur me një qëndrim. Kryetar, kur ke bë punë të mira, publikisht të kam lalënderuar dhe jam për të atyre që edhe kam postuar dhe nuk ke guxuar të ma bësh llajk. Çdo punë e mirë, çdo iniciativë prej atyre investimeve e deri te çmimi “Ukshin Hoti” poashlu Beratin e ke drejtorin më të mirë dhe krenohem që ai ëshlë në ekzekutivin tënd. Partia demokratike dje ka dalur me një qëndrim që e përkrah buxhetin, më vie mirë që PDK e ka lexuar dhe vlerësuar buxhetin, por jam i sigurtë që asnjeri nuk e ka hap dhe sidoqë të jetë jam autokritik prej të gjithçëve dhe nuk i marr hua askujt. Me përgjegjësinë më të madhe pa tendencë opozitar Krusha meriton më shumë sepse në raport me të gjitha investimet unë jam i pakënaqur, mendoj që nuk është bërë mjafitë. Dëgjimet publike i kam përcjellur, nuk e kam parë dikënd prej opozitës që ka bërë një propozim dhe është kyqur në buxhet. Më kujtohet Merisa një propozim për ngjyrosje. Kur jemi te Krusha, në përgjithësi ka nevoj shumë më tepër duke qenë i velëdijshëm për kufizimet buxhetore, por mendoj që është në një vend numri i banorëve është 5 lish më i vogël, ekziston një fushë sportive, ndërsa në Krushe të Madhe jo. Po flasim për stadium e për sallë të sporteve por përsëri po luajmë me top nëpër “hithra”. Sot kam pritur që të zgjidhet çështje e asaj përrrockës, sot e arsyetove në atë formë, por edhe ajo nuk është arsyet. Duhet t’ a gjeni një formë për operatorët sepse as 20% e 30% në këto rrethana nuk do të jetë e mjaftueshme, çdo send është duke u dyfishuar dhe duhet t’ a gjejmë një bazë ligjore t’ i kryejmë punët. Sot kam pritë një propozim dhe iniciativë për Krushë të Madhe, një banesë të banimit kolektiv për familjet e martirëve dhe dëshmorëve. Mos të harrojmë i kemi 206 të vrarë dhe të zhdukur si dhe 20 dëshmorë, i ke informata dhe ia din gjendjen çdo familjes. I kemi qinda hektarë të komunës në Krushe për një iniciativë të tillë. Për shtëpinë e kulturës foli edhe Burimi nuk dua t’ a zgjas iu kemi lëdhur edhe për të në 2-3 seanca kam pyetur, por përderisa jeni ekzekutiv faji mbetet i juaji, gjëjeni formën dhe përfundojeni atë punë. Në fund, po ju them edhe votuesve që nuk kemi as kurorë, as fejesë, as martesë e as ambicie me askënd hiç. Vota ime abstenim do të jetë për arsyet t’ fymjeve që po më vijnë prej portaleve që nuk janë aspak të mira. Çdo kush e ka dinjitetin dhe votën e vet dhe po më vie keq që jam i detyruar të marr një vendim të tillë prej këtyre fyerjeve, po flas kushtimisht. Faleminderit për vëmendjen.

Kryetari – Përshëndetje. Sefë, në Krushë të Madhe është një përrua që ka probleme, është vonuar kontrata, jemi marrur vesh që “Co-ing” të vazhdoj sigurimin e ekzekutimit të kontrataës dhe punën sepse më llogari kemi kështu sesa të lidhin kontratë të re e më pas nuk dihet çka bëhet. Varrezat e martirëve – dëshmorëve; është fat i mirë që është shpallur tenderi dhe përkrahjet nga agjencioni për menaxhimin e komplekseve përkujtimore që do të riparohet të gjitha varrezat të dëshmorëve dhe martirëve. Dy muze; muzeu te kompleksi do të bëhet dhe muzeu i “Ukshin Hotit” është në fazë të dytë. Kolektorin e ujërave të zeza nuk mund ta gjeni në buxhet sepse paradite iu thash që përmes gratit të performancës që e ka fituar komuna jonë do të investohet në kolektorë të ujërave të zeza në Krushe dhe në disa rrugë që të qojnë kah drini. Kemi nga mjete, por mjetet nuk i kemi të gjitha ende, DEMOS-i i ka lëshuar vetëm 592.000euro. Parku në qendër do t'i kompletohet dhe do të bëhet i mirë. Rrugët në Krushe janë duke vazhduar, i kemi kontratë po flasim për rrugë lokale me kubëza. Qerdhja e fëmijëve; pëlqimi energjetik është marrur, do të bëhet kyçja, është bërë stacioni i pompave dhe qerdhja do të jetë funksionale nga viti i ardhshëm dhe do të rekrutohen edukatorët për qerdhen në Krushe, Ratkoc, Xërxe dhe në qytet. Ne synojmë sa më shpejtë të themelojmë ansamblin e këngëve dhe valleve të komunës së Rahovecit me bazë në Krushë të Madhe sepse është me traditë. Palestra sportive dhe stadiumi nuk është projekt që financohet nga komuna, do të bëjmë diçka si komunë, por nuk është projekt i yni por i ministrisë së kulturës. Vitin e ardhshëm do ta bëjmë një fushë sportive në shkollën e mesme në Krushë të Madhe. Kemi edhe projekte të tjera që lidhen me Krushën e Madhe, nuk po përpinqem të të sfidoj në kuptimin pozitiv dhe mendoj që nuk ka arsyë mos ta votosh dhe nuk ka nevoj të ta dëshmoj që unë jam shumë i lidhur me atë zonë. Ne kemi shumë punë edhe në qytet por, kemi problem me vonesë të operatorëve për shkak të rritjes së çmimeve si dhe krizës globale. Operalorët janë në priti të 20% që shteti synon t'i subvencionoj. Të floj ta votosh buxhel, abstenimi është votë edhe kundërshtimi është votë, mendoj që Krusha e Madhe ka trajtim të vëmendshëm në shumë projekte nga ana e komunës së Rahovecit. Uroj që ky interesim rrëth fshatit të parë pas qytetit të vazhdoj më tutje në ajwendën e investimeve serioze. Qendra e banimit social; Një operator që e ka fituar atë projekt e ka bërë një nënkontraktor, nënkontraktori ka patur probleme me kontraktorin. Ne e kemi bërë prerjen e punimeve dhe e kemi shpallur tenderin për fazën e mbetur. Aty janë 16 banesa, ky projekt është financuar tërësisht nga komuna, ne mund ta shohim mundësinë edhe të ndërlimin e objektit të banimit social për familjet e martirëve në ndonjë pronë publike në Krushë me partneritet publiko - privat sepse është shumë i kushtueshëm. Edhe një herë ju floj ta votoni, pavarësisht debateve të ndyshme sepse në fund ëshira jonë është sa më shpejtë të shkëputemi nga kontratat e vjetra duke filluar me kontrata të reja.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues. Deshta ta kursej kohën për këtë debat, sepse pak a shumë është potencuar një deklaratë publike e dalur nga dega këtu. Po të mos ishte kjo deklaratë do të ishte debati pak më i nxeh të dhe më konstruktiv me atë martesë të opozitës edhe pse është banalizuar pak kjo punë e martesës – fejesës, sidoçofisë unë nuk mund të dal jashtë vendimit që partia e merr, por kjo nuk d.m.th që të kaloj pa kritikë kryetar. Nëse ju kujtohet në muajin shkurt – mars kur është dashur t'i kalojmë disa pika të rendit të ditës për bartjen e mjeteve, iu kam lultur po në këtë follore që të kemi respekt edhe si opozitë, të flohemi në pika të rëndësishme që i përkasin komunës tonë sepse edhe votat e opozitës janë të dikujt, janë të qytetarëve të komunës tonë të cilët duhet të respektohen me anë të mendimit dhe veprimit tonç. Mangësia këtu është që ne si opozitë duhet të bëhem vetkritik, po kritikojmë për buxhet por alternativë nuk po shoh nga asnjë parti opozitar përfshirë edhe PDK-në edhe mua personalisht. Nëse është në favor të qytetarëve që ky buxhet mos të kaloj, unë dal edhe kundër partisë dhe të gjithëve por alternativë nuk po shoh. Pasiqë jemi duke e akuzuar njëri tjetrin, opozitë – opozitë, çoftë opozitë me kryetarin apo pushtetin nuk po e shoh si debat të shëndetshëm në favor të qytetarëve. Nuk kërkua asgjë që shkon në favor të qytetarëve, përvëç kërkësës së mësuesit të nderuarit baca Rasim që e kërkoi, e cila është marrur parasysh që të futet në muajin

shikurt për realizim. Pajtohem me disa kritika që edhe të kritikosh edhe të votosh nuk bën, kritika gjithmonë është e mirë, por proceset që janë në favor të qytetarëve duhet të mos i ndalojmë duke pësuar përsëri qytetatët. Krizën po e përmendim vazhdimisht, unë vet merrem me biznes dhe e di çka d.m.th të martës një punë me një çmim të ulët ndërkokë të rritet poaq, edhe unë jam duke pritur një lëvizje të atillë nga qeveria e Kosovës dhe shpresoj që merren këto hapa. Nëse ka alternativë tjeter, kisha pas dëshirë t'ju ndëgjoj dhe ta diskutojmë atë propozim krahas këtij, nëse jo, unë personalisht obligohem të dal jashtë karakterit tim dhe të rrreshthohem nga vendimi i partisë me keqardhje. Vendimi dihet, është për publik. Duke uruar që mos të keqpërdoren këto lukse nga qeverisja, kryetari, drejtoret kur të del diçka në publik e tanë të relaksohen, uroj që herëve tjera të jemi më kompakt të gjithë. Pra ata që i përkasin subjektit të PDK-së duhet të marrin qëndrimin e partisë, i pëlqyer individualisht apo jo, ndoshta edhe mua nuk më pëlqen ky vendim por i përkas këtij subjekli, kësaj ngjyre dhe konstruktivitetit që PDK-ja me vite e ka treguar, këtë po e dëshmon edhe sot.

Merisa Sharku – Përvendetje për të gjithë. Po kyçna pak si vazhdimesi të parafolësit Bejtullahut. Në çdo seancë po më bie me përsëritë, këtë seancë po më bie t'a përsëris dhe të rikthehem te synimi im kryesor, që nga kryja, tendencia për të kontribuar në komunën e Rahovecit e që është përkrahje e grave dhe vajzave të komunës sonë. Duke e shikuar buxhetin askund nuk vërejta as edhe një përkrahje minimale për këtë kategori të shoqërisë që është gjysma përbërëse e numrit total të popullsisë së Rahovecit. E kam përsëritur disa herë edhe pse çdokush e din këtë fakt, në Rahovec si askund e asnjë vend tjeter gratë punëtore merren me artizanale, ku është komuna në këtë pikë?... Kur mendon t'a filloj përkrahjen për këtë kategori t'ë shoqërisë që jep kontribut jo të vogël në zhvillimin ekonomik të vendit. Në scanca më parë, kërkesa ime për subvencionim të grave që merren me artizanale u drejtua drejt ekzekutivit, në mënyrë retorike erdh përgjigja që ne japim subvencione për gra, për gra që merren me bujqësi. Ne e dijmë shumë mirë numrin e grave që merren me bujqësi në Rahovec. Nëse me të vërtetë dëshirojmë t'i ndihmojmë gratë me subvencione, atëherë duhet të hapim linja të subvencione enkas për artizanale, fushë me të cilën merren ato. Kjo kërkesë ka qenë edhe para disa scancave nga ana ime. Është përmendur që te buxheti në përgjithësi, te pjesa e subvenioneve ka rritje enorme, shumë mire. Ne si grup po e parashtrojmë një kërkesë reale dhc shumë të nevojshme përderisa gjysma e popullsisë së Rahovecit janë gra që merren me artizanale dhe gjysma e popullsisë janë burra që merren me bujqësi, duhet t'i ndajmë edhe subvencionet pak si përgjysmë. Prej 440.000 euro subvencione për bujqësi, pse mos të shkojnë gjysma për artizanale?... Është absurde me thënë që minden edhe gratë të aplikojnë për subvencione në bujqësi kur ato nuk aplikojnë për subvencione në bujqësi sepse nuk i duhet një traktor por një makinë për qepje. Kjo mund të jetë mënyrë ekskluzive për të mirën e ekonomisë së Rahovecit. Ndoshta me të vërtetë nuk e kemi kuptuar në mënyrë të drejtë ndarjen buxhetore siç po aludohet prej ekzekutivit, por duhet ta kuptoni që ne këtu jemi vetëm për të mirën e qytetarëve, nuk jemi për ta kundërshtuar askënd që bënë punë të mira dhe të drejta, si në rastin që u përmend më herët kinse dëshirojmë vetëm ta kundërshtojmë buxhetin, aprovojeni ndonjë kërkesë tonën. Kryetari dhe Bejtullahu e përmendën që nuk kenë kërkesa konkrete, kjo le të jetë një kërkesë konkrete që subvencionet të ndahen në mënyrë të barabartë. Po e mart me mend përgjigjen e kryetarit duke thënë që "nuk ka kërkesa" herën e kaluar kjo ishte përgjigja e tij. Duhet të ndërmerrin pak më konkretisht gjërat, kur ka filluar subvencionimi për bujqësi, ka qenë një fillim, është bërë regjistrimi i bujqëve. A janë të regjistruara sa gra punojnë artizanale? ...Jo, nuk regjistrohen, unë kam shumë familjare që punojnë, konkretisht kjo i bie që grata në Rahovec punojnë në të zezën. Ato duhet të stimuloohen duke i regjistruar bizneset dhe të vazhdoj ekonomia e Rahovecit të fuqizohet. Pres përkrahje nga të gjithë, veçanërisht prej gjinisë femrore që është në kuvend se pjesa e ekzekutivit është e "shëmtuar" të shikohet prej vendit ku jam ulur që kanë mbetur vetëm dy gra, kurse burrat dominojnë si në ushtri.

Besmire Bytyqi – Faleminderit kryesues. Duke ju përshëndetur të gjithëve, posaçërisht “babën” e opozitës siç po e quajnë portalet, Burim përshëndetje të veçantë për ty. Po pajtohem me shumicën e fjalëve që i tha Bejtullahu, këtu sot nuk kemi parë konstruktivitet. Kemi pa prej atyre që thonë nuk e votoj sepse nuk e përkrahim Smajl Lafitin, dalin disa “portale” që duhet me qenë të paanshme, por realisht janë shumë të anshme edhe i kritikojnë, kjo është arsyja pse nuk po votohet ky buxhet, përndryshe përvèç Merisës nuk kemi parë diçka konstruktive, ide creative. Uroj edhe shpresoj që muajve në vazhdim ose deri në vitin e ardhshëm kemi me u mbushë pak mend, përndryshe të nderas anëtarë të KPF-së dhe gjithë këshilltarëve komunal nga këtu ju bëj thirrje për pjesëmarrje nëpërdebatë dhe dëgjime publike, 90% nuk marrim pjesë, e dini shumë mire, më pas është shumë normale që nuk i dijmë kërkeshat e qytatarëve nëpër vendbanimet ku ne jetojmë sepse unë nuk i shoh asamblestat aty. Unë në vendbanimet e mia shkoj, në vendbanimin tim dhe në fshatrat përrteh dhe ne nuk e dijmë a e kanë kërkuar një rrugë fushore, subvencione apo diçka tjetër. Si Aleancë e përkrahim këtë buxhet, jo pse jemi parti në pushtet, por sepse ne ia duam të mirën qytetarit. Faleminderit.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues. Po ndërlidhem pak te këto kërkeshat konkrete, prej partive tjera tha që nuk pat ofertë dhe në momentin që nuk ka ofertë tjetër atëherë nuk duhet të votojmë kundër. Mendoj që ofertën është dashur t'a kërkoj kryetari dhe ekzekutivi të këshillohet në çoftëse dëshiron diçka nga ne. Në momentin që kryetari nuk na ka thirrur për bashkëpunim për këtë buxhet, ne nuk kemi se si ia ofrojmë alternativën. Më bëri pak përshtytje deklarata e Bejtullah Deliut, i cili tha; partia ka vendosur që të kaloj, por ndoshta unë kam pasur mendim tjetër. Unë mendoj që partinë e përbëjmë ne, vetëvendosje është Leonardi, Sinani, Merisa, Vlora, Iliri dhe ata njerëz që na rrëthojnë. Vendimet e parties janë atë që i bijnë këta njerëz, brenda partisë, unë nuk e di si e vendos një parti që nuk është këshilluar anëtarë i kuvendi komunal. Si do që të jetë kjo është pjesë tjetër. Ne nuk kemi kërkeshë individuale për një rrugë në lagje time ose në fshat timin. Merisa e tha një kërkeshë në nivel komunal, nuk kemi ardhur ne këtu të bëjmë kërkesa dikush për Malësi, dikush për Gexhe e tjetri për Ratkoc.

Bejtullah Deliu – Nuk e di sa ka dëgjuar me vëmendje kolegu Leonard, faleminderit për vërejtje por unë deshta të jem sa më i sinqeritë rrëth temës. Kjo që unë biscoja u zgjua dikush nga gjumi dhe lindën projekte tjera, d.m.th derisa unë fola përvèç Rasimit nuk pati askush ndonjë kërkeshë, demantom nëse ka diçka kundër. Nëse them unë që them partia, e kemi diskutuar dhe është marrë një qëndrim. Partia çshë partit, unë jam parti. Kritikat ia dhashë direkt kryetarit, që prapë po e përsëris që duhet të bashkëpunoj sepse edhe votat e opozitës janë të qytetarëve të komunës sonë. Hiç më pak se 60% opozitë jemi këtu dhe nuk e di çka ka të keqe këtu, që ju jeni parti – individë që vendosni, të gjitha këto rregulla secili i dijmë dhe besa e marrim përgjegjësinë secili për veti apo si subject në votim apo mosvotim të elektoratit, t'i shohim qytetarët a po na dënojnë apo na shpërblejmë me këto veprime që po i bëjmë. Nëse dëshirojmë debatojmë pa fund mund të vazhdojmë, por këtë debat të ndërsjellë kisha dashtë t'a ndërprejmë, të kalohet apo mos të kalohet kjo pikë, të vendoset në votim. **Lirigzon Kastrati –** Përshëndetje edhe një herë për të gjithë. Përtej interesit politik dhe përtej interesit të lokalitetit nga vijmë, është interesi qytetar. Nuk ka këtu as “babë” të opozitës ose diçka të tillë, duhet t'a përfaqëzojmë vullnetin e qytetarëve që e kemi marrur ne dhe për të cilët jemi të thirrur në këtë kuvend. Ky buxhet mbi 80% nuk i përfshin kërkeshat dhe nevojat e qytetarëve dhe si i tillë ka vetëm vazhdim të projekteve. Ne këtu debatuam dhe diskutuam. Duhet të instalohet një sistem qeverisës që projektet që nisen të përfundohen brenda afatit ligjor dhe çdo vit të kemi mundësi për projekte të reja të cilat kontribojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Rahovecit.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues. Unë jam i obliguar të reagoj. Kërkoj mirëkuptim nga anëtarët e partive tjera politik, cdo kush le t'i mbajnë qëndrimet e veta të partive politike dhe absolutisht nuk lejoj të përzihen në qëndrimet e partisë time PDK. Partia jonë ka dalur me komunikatë dhe ne e respktojmë

komunikatën tonë, nuk ka nevoj të më “jep mend” as Leonardi, as ai tjetri, e as ky, se kur kemi qenë ne parti ata kanë qenë organizatë. Ne jemi parti para tyre, kemi përvojë i kemi të gjitha, kemi qenë bartës të të gjitha proceseve, nuk ka nevojë që ata të na gjykojnë se pse po votojmë, ky është problemi jonë i drejtëpërdrejt. Subjekti jonë, dega ka marrë qëndrim dhe nuk iu intereson juve tjerëve se çka bëjmë ne. Kështuqë nuk do të ishte mirë që t'a ngacmonin çdo herë njeri tjetrin.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Kështu, në rrethanat që u krijuan së fundmi besoj që për shkak të disa proceseve që jemi, ndonjëherë kryetarin e komunës e mirëkuptoj përtensionet që mund t'i ketë sepse i ka proceset që duhet t'i shtyj tutje, siç është sot buxheti, djc bartja e mjeteve ose disa veprime të ndryshme të ngajshme që janë kritike në momentin e votimit dhe provon t'a imponoj mendimin e vet që është pjesë e demokracisë. Qëndrimet politike janë politike dhe kërkoj prej secilit kolegë të kursehen në raport me qëndrimet politike të partive tjera. Kryesuesi bcsqj që nuk duhet të lejoj të këtë kualifikime prej asnjë asambleistë në raport me asnjë asambleist sepse është e papranueshme. Dikush është “baba”, dikush “nana”, dikush merr qëndrim pro, dikush kundër. Këto janë çështje individuale të secilit ose secilit grup, nuk ka nevoj të lejohen kualifikimet jashtë gjuhës parlamentare në kuadër të asamblesë komunale. Disa herë na ka ndodhur në këtë mandat, përkundër sjelljes të ashpër të kryetarit të komunës kam qenë i qetë sepse ka pas çështje që ka provuar t'i imponoi shtyerjen tutje të proceseve, pjesa tjetër është e paarsyeshme. E dyta; potencova duke u bazuar në vërejtjet e ZKA-së, duke u bazuar në situatën që është, në dokumentacionin e kërkuar, nuk ka hapësirë përkreativitet sepse janë obligime kontraktuale, çfarë kreativiteti?... Një shtëpi e kulturës u kërkua për lyerje në Celinë, the duhet t'a bëjmë me bartje të mjeteve sepse nuk kemi hapësirë buxhetore. Planifikimi aktual nuk arrin t'i mbuloj në kohë kontratat, por do të detyrohen të vazhdohen sigurimet e kontratave sipas formatit që e kanë praktikuar që të arrihet deri në 2025 të mbulohen komplektë oblige. Qëndrimet politike i kemi secili tonat.

Kryesuesi – Faleminderit Burim. Besoj që mjafton ky cikël i diskutimeve, një fjalë e kam unë para se t'a vendosim në votim. Atëherë pëershëndetje përtë gjithë. I nderuar kryetar, nëkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive dhe qytatarë të dashur të komunës së Rahovecit. Fillimisht dua t'a shprehë mirënjohjen time ndaj asamblesë komunale apo ndaj anëtarëve të kuvendit komunal që po vazhdoj të jem kryesues edhe në përfundimin e këtij cikli buxhetor. Sot, me miratimin e buxhetit nga ana e kuvendit komunal përmbylljet një cikël buxhetor i cili është i domosdoshëm përfundimin e institucioneve komunale ku qytetarët janë përsitues më të mëdhenj të këtyre cikleve apo këtyre punëve që kryhen nëpër këto institucione. Sa i përket buxhetit përtë vitin 2023 sikur edhe në vitet e kaluara është një shpërndarje pothuajse e njejtë dhe nëse e shikojmë prej një anës është një shpërndarje korrekte në bazë të asaj se si kryetari i komunës apo Aleanca në Rahovec i ka fituar zgjedhjet dhe po udhëheq me mandatin e tretë. Pra, përkështetje që kemi një buxhet prej 17.548.000 kemi një ngritje prej buxhetit komunal në krahasim me vitin e kaluar prej 2.5 milion euro kjo duke iu falenderuar qeverisë së republikës së Kosovës dhe planit të saj qeverisës tanë e tutje. Pa dashur t'a gjykoj votën e ndonjërit të anëtarëve të kuvendit, jam gjithashlu kundër gjykimit të njeri tjetrit mes veti rreth përcaktimit të tyre përtë buxhetin, askush nuk mund t'a sheh në formën e tjetrit shpërndarjen e buxhetit apo buxhetimin në nivel komunal. Në fund të fundit është një propozim prej kryetarit të komunës dhe përgjegjësia e votës është individuale. Sa i përket buxhetit nuk përkon me idenë time qeverisësë dhe përtë një zhvillim të komunës duke patur parasysh edhe në mungesë të një alternative tjetër, duke e parë që është vetëm një alternativë unë nuk kam votë “për” këtë buxhet. Shembull konkret që mund t'a marr; është një vizion më ndryshtë se si e shoh unë buxhetimin apo miratimin e buxhetit. Nëse e marrim shembull këtu, tabelat digitale që po investohen në komunat e Rahovecit janë njëkohësisht me disa probleme në disa vendbanime ku mungon uji i pijes. Një diskrepancë e madhe meqenëse edhe politikat e Aleancës këtu janë duke funksionuar dhe janë duke u pëlyer prej qytetarëve, por në këndvështrimin tim nuk

është e aryeshme. Nëpër disa vendbanime kemi investime në drunj dekorativ, ndërsa disa pjesë të lagjeve sidomos në qytet ku nuk kanë kyçjen në rrjetin e ujërave të zeza apo në kanalizim. Poashtu edhe nëpër pjesë të lagjeve ku tensioni i energjisë elektrike në mungesë të pronave komunale që shfrytëzohen për vendosjen e trafove, energjia është e ulët ndërsa në anën tjetër kemi shërbime kulturore në vlerë prej 750.000euro, kur dikush nuk ka një tension të mjaftueshëm të energjisë elektrike. Ju falënderoj për kontributin e dhënë gjatë kësaj kohe rrëth buxhetit komunal për vitin 2023, po e vendosim në votim dhe po vazhdojmë tutje... Kush është “për” miratimin e buxhetit për vitin 2023?... Abstenim?... Kundër?... Atëherë me 18 vota “për”, 1 abstenim dhe 12 vota kundër miratohet buxheti komunal në vlerë prej 17.548.000 për vitin 2023.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për programin komunal tre vjeçar për banim 2022 – 2024;
Nënkryetari – Faleminderit kryesues. I nderuar kryetar, kryesues, përshëndetje për të gjithë.

Në mungesë të Lendriti, e kemi programin komunal 3 vjeçar, këtu me neve është edhe konsulentja e cila e ka ndihmuar këtë program bashkë me grupin punues. Pa dashtë t'a zgjasë më tepër, këtu i keni qëllimet, synimet dhe objektivat secili e keni planin para vetës. Nëse keni diçka rrëth aspektit profesional, këtu e kemi zonjën Drita Shabani që mund të përgjigjet në të gjitha pyetjet. Paraprakisht i kërkoj falje për prite dhe vonesë.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar. A ka dikush diçka lidhur me këtë plan?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e këtij plani?... Me shumicë unanime aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës... Pauzë prej 5 minutave dhe vazhdojmë me dy pika e mbeturë...

Kryesuesi – Para se të fillojmë me pikën e tetë të rendit të ditës, kryctari e ka një njofsim të shkurtër.

Kryetari – Atëherë meqenëse është lajm i mirë, ju ftoj te restorant “Panorama” në Opterushë të gjithë asambleistët për një darkë, e meritoni dhe e meritojmë. Faleminderit.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm P- 71510033-01041-1 në zonën kadastrale Xërxe;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues. Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush keni vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm për parcelën nr. 1041-1 në zonën kadastrale në Xërxe. Bëhet fjalë për parcelën në emër të pronarit Hysni Vehbi Thaqi në sipërfaqe prej 14 ari e 72m katror. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm është hapja e rrugës publike, saktësisht kjo parcelë gjendet në kuqi me parcela komunale që gjendjen afér depova të matrex-it, sipas PZHKGZ-s 2013 kjo parcelë është zonë ndërtimore. Ftoj anëtarët e kuvendit që t'a votojnë këtë vendim.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues. Sa e kuptova unë janë 1400m katror (14 ari), e gjitha do të bëhet rrugë, apo një pjesë e kësaj?...

Afrim Oruqi – Mendoj që projektori na ndihmon sado pak, një ortofoto ka qenë e prezantuar në projektor, kush e njeh atë zonë – terren. Bëhet fjalë për 14 ari e 72 metra komplet, aktualisht kjo parcelë në terren është e kalueshme, është rrugë dhe shfrytëzohet prej atyre përsituesve që janë me qera aty afér, çoftë prej kalimtarëve të rastit. Ne vetëm dëshirojmë ta zyrtarizojmë, në të ardhmen jemi dakorduar me pronarin aktual që ta këmbejmë parcelën sepse i njëjti e ka fituar me aktgjykim të plotëfuqishëm të shkallës së dyte të apelit. Ka tentuar disa herë ta bllokoj këtë rrugë dhe një pjesë të objektit, në mirëbesim kemi kërkuar që deri sa të marrim vendimin prej kuvendit të komunës që mos të pengoj punën në atë zonë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, dikush tjetër lidhur me këtë pikë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e tërë e rendit të dilës.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, media dhe ju të pranishëm. Para jush keni propozimin për formimin e komisionit për zbatimin e

procedurave dhe ofertave për vlerësimin e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 vite të lokaleve të palestrës. Këto lokale kanë qenë edhe më herët në ankand, mirëpo në mungesë të interesimit përmarrje në shfrytëzim, ne si drejtori për ekonomi zhvillim dhe turizëm planifikojmë që edhe një herë t'i shpallim përmes ankandit këto lokale. Ftoj anëtarët e kuvendit t'a votojnë këtë komision i cili përbëhet prej 2 anëtarëve të ekzekutivit, 2 të kuvendit dhe një nga përsaqësuesi joqeveritarë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve; 2 janë prej ekzekutivit, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritarë. Kryetari po i propozon menjëherë dy anëtarë prej ekzekutivit.

Kryetari – Faleminderit. Nora Boshnjaku – drejtoreshë për punë inspektuese. Erhan Morina – drejtor i drejtorisë për ekonomi zhvillim dhe turizëm.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Tani duhet të delegohet 2 anëtarë proj kuvendit – grupeve të asambleistave; ju ftojmë ta propozoni nga një anëtarë, do të shkojmë me votë në çoftëse nuk keni ndonjë mirëkuptim në mes të grupeve.

Besmire Bytyqi – Grupi i Aleancës propozon Feriz Thaqin.

Leonard Morina – Lëvizja Vetëvendosje propozon Sinan Kryeziun.

Burim Krasniqi – LDK nuk ka propozim.

Sejfullah Sejfullahu – PDK me të abstenuarin Sejfullah Sejfullahu propozon Melinda Iska Oruqi.

Kryesuesi – Atëherë kemi 3 propozime për 2 përsaqësues nga kuvendi i komunës, vazhdojmë me vota, cili anëtarë ka më shumë vota për, dy prej treve emërohet anëtarë të këtij komisioni.

Për Friz Thaqin, kush është për?... 17 vota për

Për Sinan Kryeziun, kush është për?...

Për Melinda Oruqi Iska, kush është për?... 22 vota për

Kryesuesi – Faleminderit. Kemi edhe një ndryshim prej ekzekutivit

Kryetari – Nora Boshnjaku është në komisionin për ankesa dhe ka konflikt interesit, mbetet ta propozoj Ofrim Oruqin. Erhan Morina mbetet në komision.

Kryesuesi – Atëherë katër anëtarë në këtë komision u emëruan, një nga sektori joqeveritarë që duhet të vendoset pas thirrjes publike që e bën komuna. Po e vendosim në votim këtë komision me këtë përbërje, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pikë e fundit e rendit të ditës. Faleminderit edhe një herë për dehatin dhe konstruktivitetin që e kemi zhvilluar. Ditë të këndshm

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Defrim Kafexhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Rahovec / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – President of the Municipal Council

Njësia Nr./Br./No 02(Kabinet i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No <u>2770</u> Nr. ifaq/Br str./No pg <u>48</u>
Data/Datum/Date <u>31/02/22</u>
R:HOVEC / CR:HOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 25 paragrafi 4, 5 dhe 6 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 10/2019), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënieve në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe 2 pikë 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhënien e PËLQIMIT për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Put, zona kadastrale Rahovec, ngastra me numër P-71510057-02186-0 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e P.S.H.E KOSOV.K.K.RAHOVEC RRUGET, me sipërfaqe prej $64m^2$ (gjashtëdhjetë e katër metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej $506m^2$ (pesëqind e gjashtë metra katror) i JEPET në posedim Sulejman (Halit) Durguti nga Rahoveci, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-02034-2 në posedim të Sulejman (Halit) Durguti nga Rahoveci me sipërfaqe të përgjithshme prej $3205m^2$ (tremijë e dyqind e pesë metra katror) i miret pjesa e parcelës me sipërfaqe prej $64m^2$ (gjashtëdhjetë e katër metra katror) dhe i JEPET Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për hapjen e rrugës publike.
2. Qëlliimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij propozimi është për interes publik, përkatesisht për hapjen e rrugës publike në Rahovec dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme përkëtë qëllim.
3. OBLIGOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përpunje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënieve në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës private të cekur në pikën 1 të këtij propozimi bëhet në bazë të ligjit përkates për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përbajtjen e të dhënavëve e provave të këmbyera, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
2. Sekretarisë së Kuvendit dhe
3. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo

Muajnini i Komunës Rahovec
Shqiptarët Shqiptarët
Municipality of Rahovec

Njësi Teqsh. Nr. 01/2022
 Rrugë Nr. 369, Rr. 01

05.09.2022

- H - 080-797

Në mëshjetje të nenit 12 pika 1 dhei pika 1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetejvejetjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitive të Ligjit Nr. 01/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZH) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.08.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-02034-2 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm publik pjesa e parcelës P-71510057-02034-2 në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 64m^2 (gjashtëdhjetë e katër metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3205m^2 (tremitjë e dyqind e pesë metra katror) në vendin e quajtur Blato-kajiqe qesme, me kulturë arë e klasës 2, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Sulejmian (Halil) Durgut nga Rahoveci.
2. Qëlliimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Hapja e rrugës publike".
3. Parcelsa e cekur në pikën 1 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZH) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
4. Autorizohet Kryetari i Komunes që komision dispozitive ligjore në luju të ndezmer te gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyr në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetejvejetjen Lokale dñe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtinin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dñe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web - faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së, dhe
- Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.363/22
 Datë: 30.08.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit

Uprava za urbanizam, planiranje i zaštitu okoline
Department for Urbanism, planning and environmental protection

Data:	09.08.2022
Për:	Znj. Arditë Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave, MAPL
CC:	z. Smail Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Përmes	Albnor Mullabuzi Drejtor i Drejtorisë për Urbanizm, Planifikim dhe Mbrotje (ë Mjedisit – Komuna e Rahovecit)
Lënda / subjekti	Letër Konfirmuese
Baza:	Planit Zhvillimor Komunal nr.2566 i datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative

Tënderuar:

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrotje të Mjedisit me anë të kësaj letre, ju konfirmojmë se:
Prona e cila është subjekt i shpaljes së interesit të përgjithshëm është pjesë e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2013-2023 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 dha ka destinim të përhershëm.

Ngasrat kadastrale me Nr. P-71510057-02034-2, Vend i quajtur Billato-Kajige Qesma, me sipërfaqe 3205 m², pronar Sulejman (Halit) Durguti z.k. Rahovec. Në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 i datës 30.05.2013 kjo parcelë gjendet brenda Zonës Ndërtimore.

Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 i datës 30.05.2013.

Pëlgimi i dërgohet:

1. Palës
2. Arkivit të Drejtarisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Muhafizat Mayor
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNËS/OPŠTINE RAHOVEC/PREDSEDNIKA OPŠTINSE/ MUNICIPIJAL MAFOR CABINET

Njësia Nr./Br./Nr. 02(Kabinet i Kryetarit i Komunës)

Nr./Br./Nr. 2874 Nr. i faq/Br.stu/No.pg. 59

Dati/Datum/Date 20.10.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Datë/Datum/Date:	14.10.2022
Për/Za/To:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Alban Gashi, Kryesues i Komisionit për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim
Lënda/Predmet/Subject:	Raport

Në bazë të vendimit të kryetarit 2767/22 të datës 03.10.2022 për caktimin e komisionit për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim në komunën e Rahovecit, komisioni në përbërje: Alban Gashi, kryesues, Miftar Krasniqi, anëtar dhe Ekrem Bytyqi, anëtar.

Komisioni ka mbledhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim në komunën e Rahovecit. Me datë 07.10.2022, komisioni ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka bërë vlerësimin e dy parcelave në zonën kadastrale Rahovec, pasuri Shtetërore e Kosovës (PSH) KK.Rahovec dhe Pronës private në Zonën Kadastrale Rahovec. Duke u bazuar në neni 24 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Komisioni ka bërë vlerësimin se prona komunale që do jepet në këmbim, ka këto karakteristika: parcela e cila gjendet në vendin e quajtur PUT në zonën kadastrale Rahovec, me sipërfaqe të përgjithshme 506 m^2 Certifikata P-71510057-02186-0, Pasuri Shtetërore e Kosovës KK.Rahovec, të ndahet pjesa e kësaj sipërfaqe prej 64 m^2 dhe ti jepet pronarit privat Sylejman (Halit) Durguti nga z.k Rahovec. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është: parcela e cila gjendet në vendin e quajtur Blato-Kajiqe Qesma, në zonën kadastrale në Rahovec, me sipërfaqe 3205 m^2 Certifikata e pronësisë P-71510057-02034-2, në emër të Sylejman (Halit) Durguti, të ndahet pjesa e parceles në sipërfaqe prej 64 m^2 dhe ti jepet Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit ku do të bëhet "Hapja e rrugës publike" në zonën kadastrale Rahovec.

Komisioni për Vlerësimin e pronës Komunale për këmbim, ka vlerësuar së këmbimi i pronave të Paluajtëshme duhet të bëhet pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme ku do të bëhet "Hapja e rrugës publike" ku do të shërbejë për lëvizjen e lirë të qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe më gjérë.

Bazuar në gjendje faktike në teren nga komisioni për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim, ka konstatuar se është sipërsaqe e përshtatshme ku do të bëhet "Hapja e rrugës publike" në Rahovec.

Komisioni:

Alban Gashi, kryesues



Miftar Krasniqi, anëtar



Ekrem Bytyqi, anëtar





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovac
Kryetari i Komunës – Prezident Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i datës 07.03.2019, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e pronës komunale për këmbim

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e pronës komunale për këmbim me pronën private, në përbërje prej:
 - 1.1 Alban Gashi, kryesues
 - 1.2 Miftar Krasniqi, anëtar
 - 1.3 Ekrem Bytyqi, anëtar
2. Komisioni ka përdetyrë të bëjë vlerësimin e Pronës Komunale me Nr. 71510057-02186-0 në Zonën Kadastrale Rahovec, në posidim të P.S.H.E KOSOV.K.K.RAHOVEC RRUGET e cila është rezultat i këmbimit me pronën private me Nr. P-71510057-02034-2 në Zonën Kadastrale Rahovec, se nuk ekzistojnë prona tjera komunës të përshtatshme përgjilim i këmbimit.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryeje duke u bazuar në Ligjet Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartoje raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtoren për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
 - Nga programi Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kod funksional (0451), fondi burimor (10), nga projekti **Ndërtimi dhe rregullimi infrastrukturës ne stacion te autobusëve ne Rahovec** kodit i projektit (49887), shuma prej **20,000.00€**;
 - Të transferohen në programin Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kod funksional (0451), fondi burimor (10), në Mallra Shërbime (13), shuma prej **50,000.00€**.
 - Nga programi Zhvillimi Ekonomik (480), nën programi Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48011), kod funksional (0411), në fondin burimor (10), nga projekti: **Investime në zonën ekonomike ne Opterushë** kodit i projektit (45690), shuma prej **30,000.00€**;
 - Nga programi Zhvillimi Ekonomik (480), nën programi Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48011), kod funksional (0411), në fondin burimor (10), nga projekti: **Investime në turizëm dhe shtigjet e ecjes** kodit i projektit (48159), shuma prej **16,873.50€**;
 - Të transferohen në programin Buxhet dhe financa (175), nën programi Buxhet dhe financa (17511), kod funksional (0112), në fondin burimor (), në projektin: **Projekte me donator (Helvetas)** kodit i projektit (40791), shuma prej **46,873.50€**.
 - Nga programi Arsim (920), nën programin Arsim (92055), kod funksional (0980), fondi burimor (10), nga projekti: **Ndërtimi i shkollës ne Reti** kodit i projektit (46534), shuma prej **31,987.40€**;
 - Nga programi Arsim (920), nën programin Arsim (92055), kod funksional (0980), fondi burimor (10), nga projekti: **Riparime ne shkolla** kodit i projektit (40870), shuma prej **25,739.35€**;

- Te transferohen ne programin Arsim (920), n'en programin Arsim (92055), kodi funksional (0980), foni burimor (10), ne projektin: Ndërtimi i Çerdhes ne Ratkoc kodi i projektit (45787), shuma prej 48,735,15€.
 - Nga programi Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), n'en programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), foni burimor (10), nga kategoria Rezervë shuma prej 10,000.00€;
 - Të transferohet në programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), n'en programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66360), kodi funksional (0620) në kategorinë Mallra Shërbime (13), shuma prej 10,000.00€;
 - Nga programi Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), n'en programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), foni burimor (21), nga kategoria Rezervë shuma prej 20,000.00€;
 - Të transferohet në programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), n'en programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66360), kodi funksional (0620) në kategorinë Mallra Shërbime (13), shuma prej 20,000.00€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Kryetari i Komunës,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL, dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAOVEC

01-Nr-____/22
Datë:00.10.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna e Rahovecit /Opština Orahovac / Municipality of Rahovec

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Odeljenje za Budžet i Finansije
-Department of Budget and Finance**

Datë/Datum/Date:	
Për/Za/To:	Zt. Defrim Kafexhiu: Kryesues i Kuvendit të Kuvendi Komunal Rahovec
Përmes/Preko/Through:	Zt. Smajl Latifi- Zyrtar Kryesor Administrativ
Nga/Od/From:	Zt. Afrim Limani - Zyrtar Kryesor Financiar
Subjekti/Predmet/Subject:	Shkresë për ridestinim



Të nderuar,

Me anë të kësaj shkresë po ju dërgojmë ridestinimin e buxhetit për vitin 2022.

Kërkojmë nga ju të na lejoni ridestinimin e mjeteve në shumë prej **175,608.65 €**, në këto kategoritë cekura më poshtë:

- 1.1. Nga programi Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga projekti: **Krijimi I parkingjeve te reja ne qytet kodi i projektit (48045)**, shuma prej **30,000.00 €**,
- 1.2. Nga programi Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga projekti **Ndertimi dhe rregullimi infrastruktures ne stacion te autobuseve ne Rahovec kod i projektit (49887)**, shuma prej **20,000.00 €**,
- 1.3. Të transferohen në programin Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), në Mallra Sherbime (13), shuma prej **50,000.00 €**,

- 2.1. Nga programi Zhvillimi Ekonomik (480), nën programi Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48011), kodi funksional (0411), në fondin burimor (10), nga projekti: **Investime në zonën ekonomike ne Apterushë kod i projektit (45690)**, shuma prej **30,000.00 €**,
- 2.2. Nga programi Zhvillimi Ekonomik (480), nën programi Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48011), kodi funksional (0411), në fondin burimor (10), nga projekti: **Investime në turizëm dhe shtigjet e ejeve kod i projektit (48159)**, shuma prej **16,873.50 €**,
- 2.3. Të transferohen në programin Buxhet dhe financ (175), nën programi Buxhet dhe finane (17511), kodi funksional (0112), në fondin burimor (), në projektin: **Projektet me donator (Helvetas) kod i projektit (40791)**, shuma prej **46,873.50 €**.

- 3.1. Nga programi Arsim (920), nën programin Arsim (92055), kodi funksional (0980), fondi burimor (10), nga projekti: **Ndertimi i shkolles ne Reti** kodi i projektit (46534), shuma prej **31,987.40 €**.
 - 3.2. Nga programi Arsim (920), nën programin Arsim (92055), kodi funksional (0980), fondi burimor (10), nga projekti: **Riparime ne shkolla** kodi i projektit (40870), shuma prej **25,739.35 €**.
 - 3.3. Të transferohen ne programin Arsim (920), nën programin Arsim (92055), kodi funksional (0980), fondi burimor (10), ne projektin: **Ndertimi i Çerdhes ne Ratkoc** kodi i projektit (45787), shuma prej **48,735.15 €**.
-
- 4.1. Nga programi Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (10), nga kategoria Rezervë shuma prej **10,000.00 €**.
 - 4.2. Të transferohet në programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nën programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66360), kodi funksional (0620) në kategorinë Mallra Sherbime (13), shuma prej 10,000.00 €,
 - 4.3. Nga programi Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (21), nga kategoria Rezervë shuma prej **20,000.00 €**,
 - 4.4. Të transferohet në programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nën programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66360), kodi funksional (0620) në kategorinë Mallra Sherbime (13), shuma prej 20,000.00 €,



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport



Datë/Datum/Date:	10.10.2022
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Rahovecit
CC:	
Nga/Od/From:	z. Afrim Dina, Drejtor për Kulturë /Rini dhe Sport/
Subjekti/Predmet/Subject	Draft - Plani për Trashëgimi Kulturore 2022-2025



Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa!

Drejtoria për Kulturë, Rini dhc Sport në bashkëpunim me Institucionet e përfshira në përgatitjen e Planit për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore si:

- Zyra e Kryetarit të Komunës;
 - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik/Zyra për Informacione Turistike;
 - Shoqëria Civile (SHL – Kosova) dhe profesionistët e fushës së trashëgimisë kulturore
- Kemi hartuar Draft Planin për Trashëgimi Kulturore për vitet 2022-2025.

Gjatë hartimit të Planit janë shqyrtuar gjerësisht përvojat e kaluara dhe gjendja e trashëgimisë kulturore në komunën e Rahovecit, si dhe çështjet që kërkojnë rishikim dhe orientim të ri në periudhën 2022-2025. Çështjet dhe përvojat janë identifikuar në formë të analizës së të dhënave nga dokumentet relevante të rëndësishme të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të përvojës institucionale komunale, në ballafaqimin ditor me problematikat e fushës së trashëgimisë kulturore.

Faktorët ndikues dhe orientimet e synuara me këtë Plan janë identifikuar gjatë një procesi pune dhe konsultimesh të grupit punues, debatet publike me grupet e interesit, nëpërmjet aplikimit të modeleve të afirmuara për analizë, procesi i punës së grupit punues është zhvilluar në formë të takimeve gjithëditore dhe konsultimeve të vazhdueshme.

Janë mbajtur takime konsultative të vazhdueshme për hartim e draftit të këtij dokumenti.



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vëlëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitive të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 29/2008), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 00.10.2022 miraton këtë:

V E N D I M
Për miratimin e Planit për trashëgimi kulturore 2022-2025

1. Me këtë vendim **miratohet** Plani për trashëgimi kulturore 2022 - 2025 në Komunën e Rahovecit.
2. Shtojcë e këtij Vendimi është edhe Plani për trashëgimi kulturore 2022 – 2025 në Komunën e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vëlëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – sajë zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC


01-Nr. ____/22
Datë: 00.10.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovac
Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport
Odeljenje za Kulturën, Omladinë i Sportit
Department of Culture, Youth and Sport



DRAFT

PLANI I TRASHËGIMISË

KULTURORE

(2022-2025)

TETOR, 2022

Përmbytja

Parathënie

Hyrja

Historiku

Anëtarët e Forumit Lokal të Trashëgimisë Kulturore Rahovec

Analizë mbi gjendjen ekzistuese të trashëgimisë kulturore dhc natyrore në komunën e Rahovecit

Metodologjia e hartimit të Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturore

Objektivat e përgjithshme dhe prioritizimi i projekteve

Lista e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme Rahovec

Analiza SWOT për Komunën e Rahovecit

Periudha e konsultimeve publike 18.8.2022 – 19.9.2022

Prioritetet dhe projektet e identifikuara në Komunën e Rahovecit

Vlerësimi i procesit të hartimit të Planit Lokal për trashëgiminë kulturore

Zbatimi i projekteve

Lista e figurave

Parathënie

Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (2022 – 2025), synon vendosjen e kornizave afatmesme për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë në komunën e Rahovecit. Ky dokument strategjik synon avancimin e sistemit dhe të mekanizmave përmes mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standarde të ndërkombetare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Me këtë Plan, trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të komunës së Rahovecit, që do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes efektive në avansimin e sistemit të mbrojtjes. Në të adresohen aspektet themelore që në mënyrë të drejtpërdrejtë synojnë promovimin e vlerave reale socio-kulturore, historike dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Komunës së Rahovecit, si dhe rrithjen e dukshmërisë së vlerave potenciale të saj.

Syntimet e Planit mund të përmbledhen si në vijim:

- Sistemi ligjor dhe institucional i mbrojtjes, në përputhje me ligjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, ligjeve tjera relevante dhe angazhimeve të Kosovës, si dhe orientimin e autoritetetve lokale në mbrojtjen e kësaj trashëgimie;
- Qasja e integruar në mbrojtje, sipas parimeve dhe trendeve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturor;
- Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar - me qëllim të nxitjes së ndjenjës së identitetit kulturor dhe si burim i fryshtimit dhe rinovimit.

Objektivat e Planit burojnë nga syntimet më lartë dhe mbi bazën e analizës së përvojave të kaluara, gjendjes aktuale në domenin ligjor, infrastrukturor dhe programor, si dhe të çështjeve në fushën e trashëgimisë kulturore, që bëhen subjekt trajtimit në periudhën vijuese.

Objektivat janë përkusituar si më poshtë:

1. Avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale;
2. Qasja e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, drejt zhvillimit të qëndrueshëm;
3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore;
4. Promovimi i trashëgimisë kulturore;
5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Objektivat dhe veprimet specifike do të identifikohen në përputhje me kompetencat komunale për planifikim dhe veprim strategjik sektorial, si pjesë e procesit të zhvillimit ekonomik të zonës. Prandaj, ky dokument duhet të kuptohet si politikë programore dinamike, e hapur ndaj kontributave sektoriale dhe multidisciplinare në fushën e trashëgimisë kulturore.

Në këtë vazhdë, Plani përcakton qasjet dhe veprimet orientuese për funksionim efektiv të sektorit të trashëgimisë kulturore në periudhën 2022-2025.

1. Në konsultim me aktorët relevantë dhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të komuniteteve relevante, përfshirë komunitetet fetare, si dhe pronarët, poseduesit dhe shfrytëzuesit e pronave kulturore, siç është përcaktuar me legjislacionin përkatës dhe angazhimet ndërkombëtare ligjore dhe politike. Në këtë kuadër, Strategjia përcaktohet për krijim të platformave të asocimit dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe multisektorial për ruajtjen dhc menaxhimin efektiv të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe përfshirjen e saj në agjendën komunale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.
2. Objektiv i veçantë dhe sfidues në këtë qasje bëhet përfshirja e trashëgimisë kulturore në plane dhe programe zhvillimore komunale dhe kombëtare. Metodologja dhe praktikat e mira të konzervimit të integruar të cilat promovojnë konkurrencë të lirë dhe të shëndoshë, si dhe nxitjen e kreativitetit dhe të inovacionit, do të velen në shërbim të komunitetit. Gjithashtu, vlerësimi i ndikimit në trashëgiminë kulturore si pjesë e mekanizmit përvlerësim të ndikimit në mjesid do të fuqizohet si masë që siguron ruajtjen e autenticitetit dhe meaxhimin adekuat të resurseve dhe pronave kulturore.
3. Komunikimi dhe promovimi gjithëpërfshirës i trashëgimisë kulturore dhe i arritjeve në fushën e zhvillimit kulturor, përmes këtij Plani bëhet hallkë vitale e procesit të mbrojtjes dhe njëherit e mëvetësishme, e cila garanton promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore në komunën e Rahovecit. Në funksion të zbatimit të këtij qëllimi, investimet do të orientohen në përmirësimin e turizmit kulturor dhe të infrastrukturës përcjellëse për interpretim dhe prezantim, si dhe promovim të diversitetit kulturor dhe simbolikës reprezentative të trashëgimisë kulturore.
4. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive, do të përkrahet me qëllim të zhvillimit pozitiv të debatit bashkëkohor në fushën e trashëgimisë kulturore. Së këndejmi, do të përkrahet ndërtimi sistematik i kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore, të cilët përbëjnë burimin formal të komunikimit dhe të veprimit pjesëmarrës me publikun e gjerë. Përtej këtij angazhimi dhe duke ruajtur të drejtat e pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të pronave kulturore, Plani ndikon në përmirësim të "qasjes për të gjithë" në trashëgiminë kulturore si e drejtë e të gjithëve dhe si kontribut i të gjitha palëve përsigurim të qasjes së papenguar, që garanton përmirësimin e imazhit të komunës së Rahovecit brenda dhe jashtë vendit.

Financimi i aktiviteteve, do të definohet në bazë të vlerësimit të përafërt të burimeve financiare në dispozicion; buxheti konsoliduar i Kosovës; fondet e buxhetit komunal; donacionet, iniciativat, të hyrat vetanake të institucioneve dhe fonde të tjera.

Mekanizmi për Monitorim të Zbatimit të Planit

Për zbatimin e këtij Plani kërkohet krijimi i një Komiteti (komisioni) Monitorues për Zbatimin e Planit (2022- 2025), që për qëllim ka monitorimin e progresit dhe kontrollin e veprimeve që çojnë në zbatimin e objektivave strategjike, si dhe sistemin e komunikimit dhe të raportimit në lidhje me progresin e zbatueshmërisë.

HYRJE

Trashëgimia kulturore është një ndër sektorët me rëndësi të veçantë për Komunën e Rahovecit, me ndikim në zhvillimin ekonomik lokal. Trashëgimia kulturore e komunës së Rahovecit përfshin monumentet, lokalitetet, artifaktet dhe atributet jomateriale të krijuara nga të gjithë njerëzit që jetuan në këto hapësira përgjatë shekujve. Komuna e Rahovecit angazhohet në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, në përputhje me gjendjen aktuale të kësaj trashëgimie dhe mundësitë buxhetore. Komuna obligohet që të promovojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të të gjitha komuniteteve, si dhe ka detyrimet të veçanta për sigurimin e mbrojtjes efektive të të gjitha objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet, ashtu siç përcakton legjislationi në fuqi dhe dokumentet tjera përkatëse, përfshirë Letrën e institucioneve të Kosovës drejtuar Delegacioneve Kombëtare të UNESCO-s të datës edhe 7 tetor 2015, që përbledh angazhimet e Kosovës lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës. Këto dokumente dhe dokumente të tjera (marrëveshje, memorandumc, zotime komunale), përbëjnë bazën institucionale për hartimin e këtij Plani për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore 2022-2025.

Bazën ligjore e përbëjnë ligjet në fuqi, respektivisht: Ligji për Trashëgimi Kulturore, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (përfshirë Ligjin për Hoçën e Madhe), Ligji për Lirinë Fetare në Kosovë, Ligji mbi Ekspropriimin, Ligji i Ndërtimit, Ligji për Institucionet e Kulturës dhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale; gjithashtu ligjet tjera si Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Ligji për Arkivat, aktet ligjore dhe nënligjore.

Korniza e veprimit të këtij Plani mbështetet në parimin bashkëkohor të konceptlimit të trashëgimisë kulturore si nocion i hapur dhe dinamik me qëllim të adaptimit ndaj arritjeve dhe sfidave gjithnjë të ndryshueshme në kontekstin zhvillimor global. Prandaj, ky dokument duhet të kuptohet si politikë programore dinamike, e hapur ndaj kreativitetit dhe diversitetit të kontributave sektoriale dhe multidisciplinare në fushën e trashëgimisë kulturore. Në këtë vazhdë, objektivat spccifike do të identifikohen nga institucionet e trashëgimisë kulturore në përputhje me kompetencat e tyre për planifikim dhe veprim strategjik sektorial, si pjesë e procesit të reformës institucionale dhe në funksion të zbatimit të këtij Plani.

HISTORIKU

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Gjakovës dhe ka pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri térësi ose mikro regjione. E këto janë: rrafshi-luginor, kodrinor dhe malor. Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.5 km².

Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distance rrëth 45 km, në VL me Komunën e Malishevës rrëth 16 km, në JL me komunën e Suharekës rrëth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km dhe në P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rrëth 70 km .

Në Komunën e Rahovecit temperaturat mesatare vjetore janë 11,680°C. Maksimumi absolut paraqitet në muajin korrik prej 38,50°C, ndërsa minimum në muajin shkurt me -14,50°C. Rreshjet maksimale në Rahovec janë 1.047,2 mm, ndërsa minimale janë 609,9 mm. Mesatarja e reshjeve është 707.7mm. Të reshorat e dëborës janë më të mëdha në Rahovec dhe atë në muajin Janar. Ditë me borë në Rahovec janë mesatarisht 15,7ditë. Rahoveci ka mesataren vjetore me mjequll prej 19.7 ditë apo 5,4 %. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes : Manastiri i Zoçishtës në Zoçishtë dhe Fshati Hoçë e Madhe.

Objktivi i përgjithshëm, i Planit është që të kontribuojë në përforcimin e rolit të Komunës, OJQ-ve dhe komuniteteve në ruajtjen dhe revitalizimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore lokale dhe shfrytëzimin e saj të qëndrueshëm në shërbim të zhvillimit lokal. Objektiv tjetër kryesor është sinergjia e veprimeve të të gjithë aktorëve të nivelit qendror, komunal dhe të komunitetit që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Qëllimi i Planit për Trashëgiminë Kulturore është të përmirësojë gjendjen e të gjilha monumenteve kulturore dhe natyrore në komunën tonë, duke vazhduar të bëhet restaurimi, mirëmbajtja e të gjitha objekteve të lashta historike dhe ndërtimin e monumenteve të reja si shtëpitë e vjetra, shtëpitë-muze, komplekset përkujtimore, kullat dhe objektet tjera që përbëjnë térësinë e trashëgimisë materiale në territorin e komunës së Rahovecit.

Metodologjia - Në mënyrë që të plotësohen objektivat e përgjithshme dhe qëllimi i programit është shfrytëzimi i metodologjissë së punës gjithëpërfshirëse, që në vete përfshin grupeve të ndryshme të interesit, njohës të trashëgimisë kulturore, organizata, shoqëria civile dhe zyrtarët komunal të kyçur në procesin e identifikimit, dokumentimit, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në komunë.

Hartimi dhe aprovimi i Planit do të hapë rrugë për zbatimin e projekteve kapitale të mbështetura nga Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, si dhe do të aktivizojë një numër projektesh nga ana e OJQ-ve, me synim rrjetin e ndërgjegjësimit të qytetarëve përrëndësinë e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë mundësitë e materializimit dhe përsitimit ekonomik nga kjo trashëgimi.



- Analizë mbi gjendjen ekzistuese të trashëgimisë kulturore e natyrore në komunën e Rahovecit

Qëllimi kryesor i analizës së gjendjes ekzistuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunat partnere është që të krijohet një pasqyrë e gjërë e karakteristikave të komunave, duke përfshirë aspektin historik, gjeografik, demografik, ekonomik dhe kulturor. Hartimi i profilit të komunës do të kontribuonte në kuptimin më të mirë të gjendjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe faktorët që ndikojnë në këtë gjendje. Kjo analizë është kryer nga koordinatorët lokal të angazhuar dhe nën mbikqyrje të zyres së CHwB-së në Kosovë. Pjesë të kësaj analize e bëre në vitin 2012 janë përfshirë në këtë Plan.

Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikim urban komunal

Në profilin e gjendjes ekzistuese trashëgimia kulturore prezantohet përmes pjesës tekstuale, ku jepen informata për lashtësinë e territorit të Rahovecit, vendbanimet e lashta dhe një historik i shkurtër i qytetit.



Anëtarët e Forumit Lokal të Trashëgimisë Kulturore në RAHOVEC

Nr	Forumi Lokal i Trashëgimisë Kulturore	Institucioni
1.	Smajl Latifi	Kryetar i Komunës
2.	Arim Dina (kryesues i GP)	Komuna- drejtor i DKRS
3.	Qemajl Krasniqi	Komuna- DKRS
4.	Shedat Ukaj	Komuna- DKRS
5.	Muharrem Morina	Komuna- DKRS
6.	Blerta Nalli-Gashi	Komuna – Zyra e Kryetarit
7.	Saranda Shala	Komuna-Ekonomi dhe turizëm
8.	Vjollca Gurgule	Qendra Rinore S.H.L-Kosova
9.	Zaim Kryeziu	Ing. i ndërtimitarisë
10.	Irfon Ramadani	Antropolog
11.	Albulena Rexha	Juriste
12.	Arsim Kastrati	Jurist
13	Skender Krasniqi	Historian

METODOLOGJIA

Gjatë hartimit të Planit janë shqyrtuar gjerësishi përvojat e kaluara dhe gjendja e trashëgimisë kulturore në komunën e Rahovecit, si dhe çështjet që kërkojnë rishikim dhe orientim të ri në periudhën 2022-2025. Çështjet dhe përvojat janë identifikuar në formë të analizës së të dhënave nga dokumentet relevante të rëndësishme të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të përvojës institucionale komunale, në ballafaqimin ditor me problematikat e fushës së trashëgimisë kulturore.

Faktorët ndikues dhe orientimet e synuara me këtë Plan janë identifikuar gjatë një procesi pune dhe konsultimesh të grupit punues, debatesh publike me grupet e interesit, nëpërmjet aplikimit të modeleve të afirmuara për analizë të situatave (përfshirë analizën SWOT) dhe për arritje të rezultateve të matshme dhe të zbatueshme (parimeve SMART). Procesi i punës së grupit punues është zhvilluar në formë të takimeve gjithëdhere dhe konsultimeve të vazhdueshme.

Janë mbajtur takime konsultative të vazhdueshme për hartim e draftit të këtij dokumenti.

Institucionet e përfshira në përgatitjen e Planit për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore janë:

- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, me sektorët vartëse të trashëgimisë kulturore;
- Zyra e Kryetarit të Komunës;
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik/Zyra për Informacione Turistike;
- Shoqëria Civile (SHL – Kosova) dhe profesionistët e fushës së trashëgimisë kulturore

Fazë e rëndësishme e procesit të hartimit të Planit është edhe konsultimi i ekspertëve të fushës dhe palëve të ndryshme të interesit, përfshirja e të cilëve garanton zbatueshmërinë e Planit. Po ashtu, janë organizuar edhe dëgjesa publike dhe janë marrë opinionet e propozimet e komunitetit.

Gjendja e objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje

– Kartat e trashëgimisë kulturore

Metodologjia e përdorur për hulumtimin në terren është:

Konsultimi i dokumenteve ekzistuese rrëth objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike, për të krijuar një pasqyrë të lokacionit dhe karakteristikave kryesore të tyre;

Vizitat në terren për të vlerësuar dhe evidentuar gjendjen e objekteve,;

Intervista me përgjegjës të institucioneve për objektet e përfshira në listë dhe

Intervista me posedues të objekteve dhe komunitetin për të mësuar rrëth ngjarjeve të ndryshme që ndërlidhen me objektet e trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike.

Hulumtimi në terren ka mundësuar përcaktimin e elementeve sikurse: lokalizimi i monumenteve në hartë, studimi i gjendjes fizike të tyre, dokumentimi fotografik i tipareve kryesore dhe i dëmtimeve, si dhe një vlerësim gjeneral rrëth vlerave kryesore të monumentit dhe veprimeve që që do të duhej të ndërmerrës hin për nuajtjen e tyre.

Hulumtimi në terren dhe plotësimi i kartave të Trashëgimisë Kulturore është bërë në bazë të udhëzimeve dhe kritereve të përgatitura nga grupi punues, duke u bazuar në ligjet aktuale në Kosovë dhe kartat ndërkombëtare për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Më poshtë është dhënë përshkrimi i kritereve dhe sqarimet shtesë mbi terminologjinë e përdorur dhe mënyrën e plotësimit të kartave të Trashëgimisë Kulturore:

- ♦ Emërtimi i monumentit bëhet në bazë të Listës së Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkoħshme të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit. Nëse objekti ka emërtim tjetër apo alternativ tō shënohet në rubrikën e fundit
- ♦ Në tabelën 2 janë dhënë informata rreth kohës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të tanishëm të objektit/lokacionit, burimi i informatës (është Qendra Regionale për Trashëgimi Kulturore, publikim apo edhe vetë pronari i objektit).
- ♦ Në tabelën 4 përcaktohet niveli i dëmtimit bazuar në këto kriterë:
- ♦ Pa dëmtim – Gjendja strukturore e objektit është në gjendje tē mirë dhe është në funksion të plotë.
- ♦ I ulët - Nuk ka ndonjë dëmtim të dukshëm struktural, keqësim tē gjendjes fizike të objektit, kryesisht pér shkak të mungesës së mirëmbajtjes, si korniza të prishura tē dritareve dhe tjegulla të thyera të kulmit, etj.
- ♦ Mesatar - Disa dëmtime strukturale me ndikim në mure ose kulm dhe dëmtime serioze që gjenden në gjithë objektin, siç janë dëmtim më i madh i suvasë dhe elementeve tjera arkitektonike.
- ♦ I lartë – Dëmtime serioze strukturale, siç janë muret e çara, muret e shkatërruara, mungesa e kulmit, mungesa e dritareve, etj.
- ♦ Shkatërruar - Vetëm gjunnët e objektit janë të dukshme dhe atë në formë gërmadhe.
- ♦ Në tabelën 5 përshkruhen atributet e vlerave të objektit bazuar në një objekt mund të posedojë më shumë se një vlerë të atribuar. Vlerat janë të grupuara në tri kategori (kulturore, shoqërore dhe ekonomike) dhe nëngrupe bazuar në këto kriterë:
 - ♦ Vlerë identiteti – ndërlidhet me lidhjet emocionale të shoqërisë pér një objekt apo vend specifik. Mund tē përfshijë veçori: vjetërsie, tradite, kontinuiteti, memoriale, legjendare, mahnitjeje, sentimentale, shpirtërore, fetare, simbolike, politike e patriotike.
 - ♦ Vlerë artistike - shprehet me dekorime, detaje dhe zejtari tē papërsëritur e cila është e aplikuar në objekti. Ky grup i vlerave bazohet në vlerësimë dhe evaluime shkencore dhe kritike historike mbi rëndësinë e dizajnit të resursit/objektit të trashëgimisë dhe rëndësinë e konceptit tē tij artistik.
 - ♦ Vlerë teknike - Ky grup i vlerave bazohet në vlerësimë dhe evaluime shkencore kritike historike mbi rëndësinë e dizajnit të resursit/objektit të trashëgimisë dhe rëndësinë e konceptit tē tij teknik, strukturor dhe funksional, si dhe mjeshtërisë me të cilën është punuar.
 - ♦ Vlerë rariteti - Ky grup i vlerave ndërlidh resursin/objektin me ndërtimet e tjera tē njëjtë sipas tipit, stilit, ndërtuesit, periudhës, rajonit apo ndonjë kombinimi tē këtyre kategorive; ato definojnë raritetin e resursit/objektit, se sa është ai reprezentativ dhe unik.

- ♦ Vlerë komuniteti - Vlera shoqërore e resursit/objektit të trashëgimisë lidhet me aktivitetet tradicionale shoqërore dhe shfrytëzimin modern kompatibil. Kjo përfshinë ndërveprimin shoqëror baslikëkohor në komunitet dhe luan rol në vendosjen e identitetit shoqëror dhe kulturor.
- ♦ Vlerë edukative - e resursit/ objektit të trashëgimisë përfshinë potencialin e tij për turizëm kulturor dhe vetëdijesim për kulturën dhe historinë që e promovon si mënyrë e integrimit të resurseve historike në jetën e sotme.
- ♦ Vlerë funksionale - lidhet me vlerën ekonomike, pasi që përfshinë vazhdimësinë e tipit original të funksionit apo fillimin e përdorimit të ri kompatibil me ndërtuesën apo zonën. Në struktura të shkatërruara.♦ Vlerë ekonomike - Pasi që ekonomia inkurajon alokimin e resurseve për të plotësuar një spektër të gjërë të nevojave, vlera ekonomike nuk kufizohet domosdo vetëm në vlerën financiare. Sa i përket trashëgimisë kulturore, vlera ekonomike mund të kuptohet si vlerë e cila gjenerohet nga resursi i trashëgimisë apo nga veprimi i konservimit. Vlerat ekonomike kanë katër burime potenciale të ardhurave: turizmin, tregtinë, përdorimin dhe shërbimet e akomodimit.
- ♦ Në tabelën 6 definohen sugjerimet për trajtimin në bazë të vlerave të atribuara dhe analizave shtesë në terren. Përkufizimet e sugjerimeve për trajtim janë dhënë në vijim:

- ♦ Hulumtimi - nënkupton aktivitetet paraprake të ndërmarrja me qëllim të identifikimit, dokumentimit, rilevimit dhe regjistrimit të saktë të asetit kulturor. Kjo nënkupton hulumtimin e të dhënavës në arkiva, gërmimet arkeologjike, rilevimi i objekteve, futja e të dhënavës në bazën e të dhënavës, etj.

Hulumtimi i paraprin aktiviteteve të ruajtjes, konservimit, konsolidimit, restaurimit, rikonstruimit e anastilozës.

- ♦ Mbrojtja dhe ruajtja - Masat e mbrojtjes dhe ruajtjes përfshijnë inspektimet e rregullta dhe mirëmbajtjen ciklike e rutinore. Kjo nënkupton që riparimet duhet të kryhen kur është e nevojshme për të siguruar integritetin e resursit / objektit.

- ♦Konservimi - nënkupton sigurimin apo ruajtjen e gjendjes ekzistuese të resursit/objektit të trashëgimisë nga shkatërrimi apo ndryshimi, d.m.th. vçprimi që ndërmerrjet për të parandaluar prishjen dhe të zgjatë jetën.

Qëllimi kryesor i konservimit është të ruhet autenticiteti dhe integriteti i resursit kulturor.

Statistikat kryesore nga analizat në terren

Nga hulumtimet e kryera në Komunën e Rahovecit janë plotësuar Kartat e Trashëgimisë Kulturore për gjithsej 29 Monumente në kategoritë: Trashëgimia Arkeologjike dhe Trashëgimia Arkitekturore.

Analiza SWOT:

Në punëtorinë e organizuar nga grupi punues janë hartuar dy SWOT analiza.

1.1 SWOT analiza e parë është ajo e përgjithshme, e cila i definon përparrësitë, mangësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Komunën tonë.

1.2 SWOT analiza strategjike është një analizë më specifike dhe ka për qëllim kryesor që atributet negative, pra dobësitë dhe rreziqet t'i shndërrojë në atrabile pozitive.

SWOT analizat e hartuara nga grupi punues kanë shërbyer si mjet për definimin e objektivave kryesore për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Komunën e Rahoveccit.

SWOT Analiza e përgjithshme

SWOT analiza është një mjet për vlerësim të gjendjes ekzistuese e cila shërben për të mbledhur ide të ndryshme nga përfaqësuesit e sektorit të caktuar, të cilët marrin pjesë në procese në mënyrë aktive.

Kjo analizë është njëra nga metodat që janë përdorur në punëtori për përcaktimin e gjendjes aktuale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Komunën e Rahovecit.

Puna e tri grupeve rezultoi me këto të dhëna:

♦ PËRPARËSITË

Pozita gjeografike dhe klima e volitshme

Resurse natyrore, kulturore dhe njerëzore

Lokalitet i pasur me trashëgimi: Arkitektonike – arkitekturë e veçantë e banimit, objektet fetare, urat, rrjeti i krojeve, etj.

Arkeologjike – rruga e vjetër tregtare (e karvaneve), arti në gur, kështjellat shpirtërore

Festivalet folklorike, festivali i rrushit, verës, ushqimit dhe kulturës, ritualet e teqeve, dita e pranverës, dita e Sharanicës

Natyrore – toka pjellore, vreshtat, gurrat, peizazhet natyrore

Lista e objekteve të Trashëgiminë

Kulturore nën mbrojtje të përkohshme

Inventarizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore

Përfshirja e trashëgimisë kulturore në Pianin Zhvillimor Komunal

Infrastruktura ekzistuese e trashëgimisë kulturore: Muzeu komunal “Ali Hasku”; Muzeu “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe, Shtëpia-Muze “Skënder Rexhepi” në Mrasor, Shtëpia – muze e UÇK-së në Drenoc, Qendra Informativë Turistike, harta turistike dhe broshura.

Plani hapësinor për Zonën e veçantë “Ujëvara e Mirushës”

Shoqatal aktive për promovimin e trashëgimisë shpirtërore, artizanatet dhe punëdore, si p.sh: Hareja, qendra rinore SHL-Kosova, Krusha e Madhe, ... etj.

Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për ruajtje dhe promovim të natyrës – Shoqata e Gjuetarëve.

♦ DOBËSITË

Niveli jo i mjaftueshëm i njohurive për trashëgiminë kulturore, sidomos te gjeneratale reja.

Mungesa e planeve për trashëgimi kulturore:

Mospërcaktimi i zonave të mbrojtura.

Ekspeditat dhe gjetjet arkeologjike të pakontrolluara

Mungesa e objekteve për banim- bujtinat.

Migrimi.

♦ MUNDËSITË

Zhvillimi i rrjetit për turizëm kulturor me komunal përrtheth.

Zhvillimi i ekonomisë lokale duke shfrytëzuar potencialin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Përkushtimi i qeverisë lokale për ruajtje të trashëgimisë kulturore.

Tërheqja e investimeve të huaja (organizatat, fondacionet, partneriteti publiko-privat)

Ngritja e kapaciteteve njerëzore për trashëgiminë kulturore

Dita e Hashures “Muaji Muharrem”

Zhvillimi i agro-turizmit, adaptimi i shtëpive për bujtina dhe zhvillimi i turizmit.

♦ KËRCËNIMET / RREZIQET

- Gjendja e rëndë ekonomike
- Mosdefinimi i qartë i zonave të mbrojtura dhe përgjegjësive institucionale
- Ndërtimet e egra (në zonat e veçanta) dhe zhvillimet e pakontrolluara
- Mos respektimi i ligjeve për mbrojtje të trashëgimisë kulturore
- Mospërfshirja e të gjitha monumenteve me vlerë në listën e inventarizimit
- Fatkeqësitë natyrore

Shënim: Elementet e SWOT-it janë listuar ashtu si janë prezantuar nga tri grupet dhe vetëm në rastet kur grupet kanë përmendur të njëjtin element, ato janë eliminuar për të evituar përsëritjet.

SWOT Analiza strategjike

SWOT analiza e përgjithshme u pasua me SWOT-in Strategjik, që është një analizë më specifike dhe ka për qëllim që atributet negative, pra dobësitë dhe treziqet t'i shndërrojë në atribut pozitive.

Puna e grupeve rezultoi me këto objektiva:

- Ngritja e vëtëdijes, edukimi dhe arsimimi për rëndësinë e trashëgimisë kulturore.
- Promovimi dhe forcimi i brendit të Rahovecit në Kosovë dhe rajon.
- Harmonizimi i ligjeve për trashëgimi kulturore dhe ligjeve për planifikim hapësinor.
- Kooperimi i legjislativit me pushtetin lokal, aktorët ndërkombëtar dhe komunitetin.
- Krijimi i mekanizmave për zbatim të ligjeve të trashëgimisë kulturore.
- Promovimi dhc zhvillimi i politikave financiare buxhetore për stimulim të partneritetit publiko-privat dhe thithjes së donacioneve.
- Vëtëdijesimi dhe fuqizimi i resurseve njerëzore në përgatitjen e projekteve kapitale dhe në zbatimin e tyre.
- Funkksionalizimi dhc shsrytëzimi i trashëgimisë kulturore për zhvillim të qëndrueshëm.
- Përforcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal.
- Aktivitete promovuese për rritjen e buxhetit në fushën e trashëgimisë kulturore.
- Sensibilizimi i moshave të reja për rëndësinë e trashëgimisë kulturore nëpërmjet programeve edukative: ligjérat, ekskursionet, vizitat studimore etj.
- Zbatimi i strategjisë së Planit Zhvillimor Komunal për promovim të komunës për tërheqjen e fondave.
- Menaxhimi më i mirë i mbikëqyrjes së funksionimit/zbatimit të ligjit për trashëgiminë kulturore.

Objektivat e përgjithshme

Pas takimeve dhe vlerësimeve të monumenteve kulturore që mundësuan definimin e gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore e natyrore, respektivisht duke u bazuar në informata e marra nga terreni, ekziston baza për parashikimin e së ardhmes nëpërmjet projekteve dhe propozimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes aktuale. Grupet punuese të terrenit, duke u bazuar në strategjitet e dala, konstatojnë se duhet të ndërmerrin aktivitete për përbushjen e disa objektivave të përfshira në këtë Plan për Trashëgiminë Kulturore 2022-2025:

1. Mbrojtja dhe renovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore / Trajtim i objekteve historike dhe zonave të trashëgimisë natyrore.
2. Integrimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në jetën bashkëkohore dhe zhvillimi lokal përmes saj / Trajtim hapësinor dhe zhvillimor i trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
3. Edukim, trajnim, vëtëdijesim mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore/Aspekti human mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Prioritetet e Planit për Trashëgimi Kulturore (2022-2025)

Është e qartë se Plani për Trashëgimi Kulturore (2022-2025) është i përqendruar në vetëdijesimin e qytetarëve dhe krijimin e partneritetit me institucionet komunale e qendrore me qëllim të promovimit, mbrojtjes dhe shfrytezimit të saj në veprimtaritë ekonomike në komunën e Rahovecit.

Andaj, në përbushjen e këtij qëllimi do të ndërmerren këta hapa:

- **Ndalimi i ndërtimeve që cenojnë strukturën dhe dëmtojnë vlerat kulturore, historike e monumentale të objekteve të trashëgimisë kulturore.**

Ky aktivitet është tejet i rëndësishëm nga fakti se krijon parakushte për restaurimin dhe konservimin e objekteve të trashëgimise kulturore dhe mundeson shfrytëzimin efektiv për aktivitete kulturore dhe ato turistike. Ndërsa tjetra, ky aktivitet është thlbësor për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Për përbushjen e këtij aktiviteteti rolin kryesor do ta luajnë institucionet komunale përmes organeve të tyre (inspektorateve), por edhe organet kompetente profesionale të Republikës së Kosovës.

Rol të rëndësishëm mund të luajnë edhe qytetarët dhc shoqëria civile, si dhe profesionistët e kësaj fushe.

- **Përcaktimi i kufijve të monumenteve të trashëgimisë kulturore**

Ky aktivitet është i një prioriteti të madh ngase parandalon çfarëdo intervenimi të paautorizuar dhe degradimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Përcaktimi i kufijve të monumenteve të trashëgimisë kulturore mund të bëhet përmes aktivitetetve të zonimit dhe përpilimit të Hartave Zonale Komunale e të cilat janë pjesë e Planit Zhvillimor Komunal. Ky aktivitet pritet të ndërmerret nga Drejtoria Komunale për Urbanizëm në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorinë për Kadastër dhe Çështje Pronësore dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren (QRTK-Prizren).

- **Sinjalizimi adekuat dhe shenjëzimi i objekteve të trashëgimisë kulturore**

Procesi i sinjalizimit të trashëgimisë kulturore është tejet i rëndësishëm. Ndikim do të ketë edhe harta e të gjitha monumenteve kulturore ku tregohet saktë vendndodhja e monumentit. Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes botimit të një guide turistike të detajizuar: Ekziston nevoja e pasurimit të materialit informues për trashëgiminë kulturore dhe për këtë arsyë guida duhet të pasurohet me informacione shkurtësish, me qëllim të ngalljes se kërshtërisë së turistëve potencial. Pra, krahas materialit ekzistues duhen dizajnuar edhe guida të detajizuar dhe të përkthyerë në gjuhë të ndryshme.

- **Aktivitete promovuese tradicionale për njojjen e trashëgimisë kulturore të Rahovecit**

Në funksion të nxitjes së zhvillimit të komunës së Rahovecit do të shfrytëzohen pasuritë kulturore, arkeologjike dhe natyrore. Në këtë vazhdë do të organizohen aktivitete tradicionale të ecjeve të

gjata (hiking), sidomos gjatë kohës së qëndrimit të mërgimtarëve tanë në vendlindje, por edhe në raste të tjera festive apo organizime të veçanta me profesionistë të fushës. Këto aktivitete mund të organizohen nga DKRS në bashkëpunim me shoqërinë civile.

- **Aktivitete të tjera tradicionale në fushën e kulturës brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore**

Organizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore, arkelogjike dhe arkitkturore do të ndikonte dukshëm në promovimin dhe mbrojtjen e asaj trashëgime dhe në materializimin ekonomik të saj. Aktivitetet si ekspositat e artit figurativ, skulpturës, ditëve të poezisë, shfaqjeve teatrale, promovimit të veprave artistike, do të organizohen brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore. Kjo do t'organizohet nga DKRS dhe aktorë të tjera shoqëror.

- **Fushatat e ndërgjegjësimit për trashëgiminë kulturore**

Aktivitetet ndërgjegjësuese mund të organizohen nga DKRS në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile. Për më tepër, aktivitetet e tillë do të zbatohen nga vetë organizatat e shoqërisë civile të mbështetura nga institucionet komunale në Rahovec dhe MKRS. OSHC-të janë të profesionalizuara në hartimin dhe zbatimin e fushatave të ndryshme andaj partneriteti i institacioneve komunale me shoqërinë civile është i domosdoshëm në përbushjen e objektivave për ndërgjegjësimin e qytetarëve për ruajtjen dhe kujdesin ndaj kësaj trashëgimie.

- **Fushatat mediale për trashëgiminë kulturore**

Gjatë periudhës 2022-2025 do të organizohen fushata mediale, me qëllim të ndërgjegjësimit të gjerë të qytetarëve për trashëgiminë kulturore. Për këtë qëllim mund të organizohen debate tematike në radio e televizione, rajonale dhe ato nacionalë ku në qendër të debateve të jetë ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore. Ky aktivitet do të organizohet nga DKRS në bashkëpunim me shoqërinë civile, të mbështetura nga autoritetet lokale e qendrore.

- **Gara tematike shkollore për vetëdijesimin e të rinjve për rëndësinë trashëgimisë kulturore**

Krijimet artistike dhe idetë kreative të të rinjve duhet të fokusohen në promovimin dhe ruajtjen e kësaj trashëgimie. Këto aktivitete mund të organizohen nga DKRS dhe DKA, nga partnerë të brendshëm e të jashtëm dhe nga shoqëria civile.

Me qëllim të ruajtjes dhe promovimit të vlerave tona të trashëgimisë kulturore, historike dhe të monumenteve të natyrës, Komuna e Rahovecit, respektivisht drejtori komunal, mund dhe duhet të organizojnë aktivitete të ndryshme promovuese; tryeza, takime pune, debate publike, fushata vetëdijesimi, stimulim të aktorëve të shoqërisë civile që merren me këtë trashëgimi, si dhe aktivitete e masa konkrete për jetësimin e Planit për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore, Historike dhe monumenteve të Natyrës në tërë territorin e komunës së Rahovecit.

- **Lista e objekteve**

Prioritetet strategjike ceket zhvillimi i turizmit bazuar në potencialin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Në pjesën e tretë Korniza e Zhvillimit Hapësinor të Komunës, në mënyrë të përgjithshme jepen disa propozime për menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Propozimet përfshijnë:

Hartimi i planit menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore;

Hartimi i planit rregullues për trashëgiminë kulturore në Hoçën e Madhe;

Hulumtimi dhe restaurimi i objekteve fetare islame dhe ortodokse, lokalitetet arkeologjike;

Ruajtja e zonës së vjetër të qytetit;

Përbledhja e dorëshkrimeve dhe këngëve të vjetra në shqip apo gjuhët tjera të komuniteteve dhe

Hartimi i katalogut të trashëgimisë kulturore.

Këto propozime, edhe pse përfshijnë kryesisht të gjitha aspektet e trashëgimisë kulturore nuk janë të paraqitura hollësish.

Raporti në vijim ngërthen informata të rëndësishme rreth Komunës së Rahovecit, duke përfshirë karakteristikat kryesore, prioritetet, dinamikat sociale, ekonominë, analizën urbane, analizën e shpërndarjes së buxhetit dhe specifikat e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Analiza është pasuruar me Hartat e Trashëgimisë Kulturore të hartuara në formë tabele, ku paraqiten të dhënat kryesore rreth vendndodhjes së pasurive të trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike, kohës së ndërtimit, nivelit të dëmtimit, atributet e vlerave, sugjerimet për trajtim, informatat shtesë, të plotësuara me pozitën e monumentit në hartë dhe pamje të tij.

Plotësimi i Kartave të Trashëgimisë Kulturore është bërë sipas udhëzimeve dhe kritereve të përgatitura nga ekipi i CHWB-së, duke u bazuar në ligjet aktuale në Kosovë dhe kartat ndërkombëtare për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore në komunën e Rahovecit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, respektivisht Departamenti i Trashëgimisë Kulturore është institucioni përgjegjës për futjen nën mbrojtje të Monumenteve në territorin e Kosovës.

Lista e trashëgimisë kulturore përpilohet nga ana e Qendrave Regionale për Trashëgimi Kulturore (QRTK), që janë nën varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe të Sportit.

Listë e objekteve të evidentuara

Paraqitja e listës së monumenteve të evidentuara nga përgjegjësit e QRTK-ve në Kosovë, me rastin e hulumtimit në terren. Në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej 70 objekte të evidentuara gjatë viteve 2002-2003.

Gjenden nëntë (9) lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe një (1) monument në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore.

Listë e Trashëgimisë Kulturore në Mbrotje të Përkoħshme

Paraqet listën zyrtare të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit. Në këtë listë, në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej 12 lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 17 monumente në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrotje të Përkoħshme.

Në vitin 2021- 2022 në Komunën e Rahovecit janë përfshirë 19 Monumente në kategorinë Trashëgimia Arkologjike dhe 25 Monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore, objekti e luajtëshme janë 3, duke e rritur numrin total në 47 monumente.

I. Kategorija: Frashëgjimita arkeologjike

A. Nënkategoriar: Mënuimtëri/Anësorëtë

Nr.	Emiterimi	Periudha	Vend/ Komuna	Statusi	Nr. Unik në Database
20	Manastiri i Zogishtës	Mesjetë	Zogishtë, Rahovec	Zonë e Verantigë	3126
21	Kisha Bernjatë	Mesjetë	Bernjatë, Rahovec	Mbrojtur	3132
85	Rënjojat e Kishës Mesjetare dhe varrezat e vjetra	Shek. XVI-XVII	Opterushë, Rahovec		4669

A. Nënkategorja: Lokalitet Arkeologjik / Rezervat

Nr.	Emiterimi	Periudha	Vend/ Komuna	Statusi	Nr. Unik në Database
257	Vendbanimi parahistorik dhe romak në vendin e quajtur "Maqine"	Parahistori	Rahovec		4184
258	Vendbanimi neolitik i Opterushës (Gërmadhat e kishës 'Shpëtimi i Shenjët' (Shën Gjergj)	Parahistori	Opterushë, Rahovec		4185
259	Mesjetë	Opterushë, Rahovec			3134
260	Gërmadhat e Glyterut – Fortesa Antikë	Parahistori, Antikë	Zatriq, Rahovec		3017
261	Kisha varrezore e Shën Nikollës	Mesjetë	Hoçë e Madhe, Rahovec		3128
262	Kisha varrezore e Shën Gjonit ne Hoçë te Madhe	Mesjetë	Hoçë e Madhe, Rahovec		3129
263	Gërmadhat e kishës së Shën Llukës	Mesjetë	Hoçë e Madhe, Rahovec		3000
264	Lokaliteti Arkeologjik romak ne Pozhigë	Romake	Bellacërëkë, Rahovec		3009
265	Tumë dhe vendmanimi në Pastasel	Parahistori	Pastasel, Rahovec		4181
266	Vendbanimi neolitik në Pastasel	Parahistori	Pastasel, Rahovec		4182
267	Vendbanimi romak në Pastasel	Romake	Pastasel, Rahovec		4183
268	Vendbanimi romak i Senocit	Romake	Senoc, Rahovec		4186

269	Varezë mesjetare në Vranjëk	Mesjetë	Vranjëk, Rahovec	3427
270	Varezë mesjetare në Celinë	Mesjetë	Celinë, Rahovec	3428
271	Tema - banjo romake në Çiflik	Romake	Çiflik, Rahovec	3429
		Parahistori,		2995
272	Këshijella në Gëzëhë	Antikitet i vonë	Gëzëhë, Rahovec	

II. Kategoriat Trashëgimia Arkitekturore

Nënkategoriat Monument / Ansambeli		PRIZREN		
Nr.	Emërtimi	Periudha	Vendi/Komuna	Statusi
485	Teqja Halveti	Shek. XIX	Rahovec	1774
486	Kulla e Qamil Vuqitnës	Shek. XX	Rahovec	1789
487	Kulla e Hajrulla Qantës	Shek. XVIII	Rahovec	1791
488	Kroni i vjetër	Shek. XVI	Rahovec	1792
489	Teqja e Melamive	Shek. XIX	Rahovec	1793
490	Kulla e Sahatit	Shek.XVIII	Rahovec	1768
491	Xhamia e Kasumit	Shek. XIX	Rahovec	1772
492	Xhamia e Sokolit	Shek.XVIII	Rahovec	1773
493	Kulla e Ismet Qemegës	Shek. XIX	Rahovec	3414
494	Kroi i gurit	Shek.XIX	Rahovec	4760
495	Shtëpija e Mustafa Jusuf Kadriut *	Shek.XIX	Rahovec	1775
496	Xhamia e Zatrigit	Shek.XVIII	Zatriq, Rahovec	1798
497	Konaku i Manastirit të Decanit	Shek.XVIII	Hoqa e Madhe, Rahovec	3412
498	Shtëpia e familles Spasiq	Shek. XIX	Hoqa e Madhe, Rahovec	3413
499	Minarja e xhamis së Drenocit	Shek.XVII	Drenoc, Rahovec	1805
500	Xhamia e Xérkës	Shek.XVIII	Xérkë, Rahovec	1806
501	Ura e gurit	Shek. XIX	Fartësë, Rahovec	3415

502	Rrënojat e Xhamisë në Fshatin Brestoc	Shek. XVI	Brestoc, Rahovec Potoçan i Ulët		1763
503	Tyrbja e Dervish Avdiut dhe Ahmatit	Shek. XVIII-XIX		Rahovec	4124
504	Kulla e Mehmet Pashës	Shek. XIX	Opterushë, Rahovec		1767
505	Shtepia e Morze Ukshin Hotit	Shek. XX	Kushe e Madhe, Rahovec		4808
506	Kulle	Shek XIX	Kramovik, Rahovec		4508
507	Xhamia e Pastasellës *	Shek. XIX	Pastaselli, Rahovec		1083
531	Mulliri i familjes Isaku Vuçitërrna	Shek.XX	Rahovec		4827

A. Nënkategori: Fushat e konservimit arkitekturor					
Nr.	Emërtimi	Datimet	Vendi/Komuna	Statusi	Nr. Unik Databasi
900	Fshati Hoqë e madhe		Hoqë e madhe - Rahovec	Ligji për Fshatin Hoqë e Madhe	4805

III. Kategoria: Objektet e luajtshme

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Signatura - Konteksti i gjeljes dhe vendodhja	Vendgjetja/Komuna	Status
73	Stelë-gur mbivarror	Shek. III	Gjetje rasti (MK)	Rahovec	
174	Stelë-gur mbivarror	Shek. III	Gjetje rasti (MK)	Rahovec	
209	Divani dhe dorëshkrimet e Sheh Malës	Shek. XIX		Rahovec	

1

¹ <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,153>



KULLA E SAHATIT



KULLA e SAHATIT – RAHOVEC



Ora e vjetër me model LEOPOLD DPABEINGER in SSJENN A793 e cila ka qenë e vendosur në kullë nuk funksionon dhe është ruajtur në hapësirat e Muzeut të Rahovecit. Qasja në Kullë e Sahatit mundësohet nëpërmjet shkallëve nga guri. Hapësira rrethuese e Kullës është e dëmtuar, pranë saj gjendet një shtëpi e shkatërruar dhe një shtëpi e re e ndërtuar, që pengojnë qasjen dhe shfrytëzimin e hapësirës për nevoja turistike dhe kulturore.

Kulla gjatë viteve 2009-2010 është restauruar në bashkëpunim ndërinjet CHwB-së dhe Komunës së Rahovecit. Gjatë punëve restauruese janë ndërmarrë këto aktivitete: Riparimi i mureve të jashtme dhe forcimi i perimetrit të konstruksionit me breza hekuri; Rivendosja dhe forcimi i shkallëve të brendshme nga druri; Mbulimi i platosë dhc shkallëve të jashtme me pllaka guri; Vendosja e këmbanës dhe orës së re; Vendosja e parmakëve mbajtës dhe Instalimi i energjisë elektrike nëpër shkallë dhe mure.

Muzeu Komunal “Ali Hasku” Rahovec



Objekti është ndërtuar gjatë viteve 1950, në fillim ka shërby si postë kurse pas luftë janë kryer shërbime tjera Komunale. Prej 2009 këtu është vendosur Muzeu Komunal “Ali Hasku” dhe Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi”.

Në muze ka eksponate të ndryshme që janë mbledhur nga qytetarët e komunës sonë. Biblioteka komunale është pajisur me një fond rreth 25.000 ekzemplarë, gjithashtu më 09.03.2022 u përruua Këndi Arkivor nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.

TEQEJA E TARIKATIT HALVETIE – RAHOVEC



Kompleksi i teqesë përbëhet nga elementet përcjellëse që gjenden në oborr.

Tyrbe - vendi ku gjenden varrezat e udhëheqësve shpirteror - Shehlerëve, të teqesë; Çezma e vjetër e punuar nga guri i gdhendur; Pitosi që daton nga periudha iliro-romake që është gjetur në Rahovec; Guri mbivarror nga periudha Romake po ashtu i gjetur në fshatin Retijë. Kulmi i vjetër i teqesë ka qenë i mbuluar me rrasa guri. Gjatë viteve 1990-1998 kulmi është rindërtuar dhe mbulesa me rrasa guri është zëvendësuar me tjegulla argjilore. Teqeja e Halvetive në popull ndryshtet quhet edhe Teqeja e Sheh Sylejmanit dhc paraqet një vend të rëndësishëm për besimtarët e tarikatit Halveti në Kosovë.

TEQEJA E TARIKATIT RIFAI – RAHOVEC



Teqja e tarikati Rifai është e shek XIX, së bashku me Tarikatin Kadiri janë ndër tarikatet e para dhe më të vjetra..

TEQEJA E TARIKATIT - MELAMI



Teqja e Melamive ndryshtet edhe me emërtimin Teqja e Sheh Malës- sipas ndërtuesit dhe themeluesit të tarikatit Melami në Rahovec. Ndërtesa e teqesë është ndërtuar në shek.XIX, kurse në vitin 1970 ka pësuar një rindërtim, për arsyet e zgjerimit të hapësirës. Elementet origjinale të lëvizshme janë ruajtur në brendi të teqesës. Poashtu edhe mbishkrimi në gjuhën arabe në fasadën balllore është ruajtur.

SHTËPIA E QAMIL VUÇITERNËS – RAHOVEC



Në përgjithësi në enterier të shtëpisë janë ruajtur elementet origjinale nga koha e ndërtimit të saj. Shkallët nga druri; Tavani i dekoruar me rozetë nga druri; Dera e vjetër; Oxhaku në përdhesë; Hapja harkore nga guri në fasadën ballore, janë disa nga elementet karakteristike.

KULLA E HAJRULLAH ÇANTËS – RAHOVEC



Shtëpia ka shërbyer si bazë ushtarake e Perandorisë Osmane, deri në vitin 1908.

Gjatë kohërave të ndryshme kjo shtëpi ka luajtur rol të rëndësishëm kombëtar, duke qenë vend tubim për diskutimin e çështjeve kombëtare.

Mbulesa e kulmit fillimi isht ka qenë e mbuluar me trasa guri, karakteristikë për ndërtimet e shekullit XIX në Rahovec, por më pas është zëvendësuar më tjegulla nga argjila.

Qyteti i Rahovecit është mjaft i pasur me kroje.



Kroi i vjetër në Qytet

Kroi nga guri përmban elemente artistike që e karakterizojnë: Në pjesën e sipërme të murit të kroit, duket një gdhendje në formë dielli.

Kroi i vjetër është njëri prej disa krojeve aktive në qytetin e Rahovecit. Në këtë krua rrjedh uji i pijshëm që përdoret nga banorët e lagjes dhe kalimtarët.

Riparimi është bërë në vitin 2020 nga Komuna e Rahovecit.

"Kroi i Sahatit", afér "Sahatkullës" së Rahovecit

"Kroi i Bugarëve", kah rajoni i "Hamovceve" të Rahovecit,

"Kroi i Haxhijës", në qendër të qytetit,sot, "Muri i Pikkellimit",

"Kroi i Tarës", në rajonin e "Rremë Nikut" afér gërmadhave të një gjyleti,

"Kroi i Hajdëve", në rajonin ndërmjet "Dublanës" dhe "Rrastokit",

"Kroi i Plavës", në rajonin e Përre-zinave,

"Kroi i Asma' Nikës", në krye të "Li-vadheve të Mark Lalës", nën "Livadhete Shalës" të Vhapëve,

"Kroi i Carecit", bri rrugës Rahovec-Malishevë, jo larg "Lugut të Gjeraqinës",

"Kroi i Jollxhijës", në rajonin e "Hamov-ceve" të Rahovecit,

"Kroi i Lajthishtës", afér ambulancëssë Rahovëcit,

"Kroi i Remë Nikës", buzë lumit të "Remnik",

"Kroi i Kishës", pranë kishës ortodoksenë lagjen e serbëve,

"Vrella", në qendër të qytetit,

"Kroi i Kadirëve", në murin e xhamisë së Kadirëve.

Kulla e Ismet Çmegës- Rahovec



Kulla e Ismet Çmegës -Rahovec.

Kulla e Ismet Çmegës gjendet në qendrën e vjetër të Rahovcit, në sheshin “Vrella”. Është ndërtuar gjatë shek. XIX nga ana e Dervish Meriqit, kurse tani është në pronësi të familjes Çmeqa. Ndërtesa i ka veçoritë karakteristike të kullave që janë ndërtuar gjatë shek. XIX në rrafshin e Dukagjinit.

Është e ndërtuar në përdhes; dhe ka dy kate. Përdhesa dhe katë kanë nga një hapësirë, ku vetëm hapësira e shkallëve ndahet me mur të brendshëm. Bazuar në skemën tipike funksionale të kullave, ambienti më karakteristik që paraqitet në katin e dytë është dyshekllëku.


Material tjetër që hasim në ndërtimin e kësaj kulle është druri, i cili është përdorur për ndërtimin e konstruksionit të kulmit, si dhe për konstruksion meskatësh në formë të trarëve dhe dyshemesë nga dërrasat. Kulmi është katërujor i mbuluar me rrasa guri, mbulesë karakteristike e kulmeve të rajonit të Rahovcit. Prej kohës kur është ndërtuar e deri tani, kulla ka qenë e shfrytëzuar për banim. Restaurimi i kullës është bërë në vitin 2016. Është e pabanuar.

XHAMIA E KOSUMIT - RAHOVEC



Xhamia është e ndërtuar në vitin 1826 dhe e renovuar gjatë viteve 2010-2011. Kupola dhe minareja e xhamisë janë ruajtur në gjendje origjinale, me dekorimet e brendshme të kupolës.

XHAMIA E FSHATIT DRENOC



Xhamia e vjetër është rrënuar dhe në vend të saj është ndërtuar një xhami e re më e madhe, nga xhamia e vjetër vetëm minarja ka shpëtuar.

Projekti i intervenimeve emergjente për vitin 2012, financuar nga MKRS ka ndarë mjete për konsolidimin e minares.

Fshati Drenoc gjithashtu në objektin e shkollës së vjetër janë të grumbulluara eksponatet e shumëta etnografike të dhuruara nga qytetarët.



Objekti ku janë të vendosur eksponatet dhe enterieri etnografik - Drenoc
BURIMET- DRENOC



Burimi i ujit në pjesën fushore – Drenoc



Kroi atër xhamisë, supozohet jetë i lashtë rreth 200 vjet

XHAMIA E FSHATIT ZATRIQ



Në oborrin e xhamisë gjenden varreza të personaliteteve të rëndësishme fetare të fshatit Zatriq, enterieri është ruajtur në gjendje origjinale me elementet nga druri.

Minarja e ndërtuar me gur –

KROI I FSHATIT ZATRIQ



Kroi i fshatit në Zatriq hynë ndër krojet me të vjetra në komunën e Rahovecit, i cili ka shërbyer si burim për tu funizuar me ujë të pijes për banorë. Në ruajtjen e këtij kroi komuna ka bërë restaurimin në vitin 2020.


Fshati Zatriq gjithashtu ka kalanç e Gradinës e cila shtrihet në majen e rrufshtë të malit shkëmbor, vlen të theksohet se fshati Zatriq ka lartësinë më të madhe imbidetare në komunën e Rahovecit prej 1038m.

MANASTIRI NË ZOÇISHT



Manastiri i Zoçishtës është një monument i trashëgimisë kulturore, monumenti është i kategorisë "Arkeologjik", i cili është në Listën e Trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme me numër 494/54.

KISHA NË HOÇË TË MADHE



Kisha varrezore e Shën Gjonit në Hoçë të Madhe është një monument i trashëgimisë kulturore në Hoçë e Madhe, Rahovec, Kosovë. Ky monument është i kategorisë "Arkeologjik", i miratuar me numër 02-54/58.

Në komunën e Rahovecit janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes: Manastiri i Zoçishtës dhe Fshati Hoçë e Madhe.

Xhamia e fshatit Pastasel



Guri me mbishkrim arab dhe dekorime florale, i cili gjendej në fasadën e xhamisë së vjetër, është ruajtur dhe gjendet në oborr të xhamisë së re.

Minarja e xhamisë në Pastaselë është granatuar dhe rrënuar gjatë luftës së vitit 1999. Në vitin 2011 xhamia e vjetër është rrënuar dhe në vend të saj është ndërtuar një e re.

Të dhëna nga terreni – Rahovec

Mbledhja e materialit në terren për Planin e Trashëgimisë Kulturore të komunës së Rahovecit ka filluar më 1.09.2022 dhe është në vazhdim.

Qëllimi i këtij aktiviteti në terren është evidentimi dhe përshkrimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, vendeve dhe monumenteve të natyrës, që mund të përbëjnë interes për zhvillimin ekonomik të komunës së Rahovecit.

Grupi që ka kryer vizitat në terren:

1. Irfon Ramadani, Etnolog - antropolog kulturor
2. Skender Krasniqi, profesor i historisë
3. Zaim Kryeziu, Ing. i Ndërtimitarisë

Fshatrat e vizituara: **Krushë e Madhe, Xërxe, Celinë, Fortesë, Nagavc, Hoçë e Vogël, Reti, Opterushë, Hoçë e Madhe.**

Inventarizimi nëpër fshatra ka filluar me vjeljen e materialit në mënyrë të shpejtë dhe pa ndonjë analizë të hollësishme e profesionale.

Bazuar në listën e objekteve të Trashëgimisë Kulturore, që është aktualisht në mbrojtje të përkohëshme të vitit 2021 konstatojmë se, kemi edhe shumë objekte për të cilat nuk ka pasur njohuri apo shënimë të hollësishme. Mbetet që në të ardhmen të punohet për evidentimin dhe mbledhjen e të dhënave konkrete për objektet që mund të përbëjnë interes për autoritetet.

Krushë e Madhe

Subjekti:

Fatmir Sejfullahu; Blerim Shala; Halit Shala; Xhemë Shala; Xhevdet Nuredini dhe Shaip Shala.

Shtëpia-muze e Ukshin Hotit, me nr. Unik 4308 në LTK.

Shtëpia është djegur nga serbët në luftën e fundit. Aty i ka kaluar ditët e fundit në liri veprimtari i çështjes kombëtare, profesori universitar Mr. Ukshin Hoti. Shtëpia është e rindërtuar në vitin 2017 dhe një pjesë është konservuar. Në oborrin e shtëpisë është vënë busti i Ukshin Hotit, ndërsa në brendi janë vendosur fotografji, libra dhe gjësende të profesorit Ukshin Hoti.

Aktualisht po realizohet projekti për qendrën kulturore e historike “Ukshin Hoti”, që është pjesë e kompleksit muzeor “Ukshin Hoti”. Objekti dhe ambientet e jashtme janë nën përkujdesin e

autoritetet komunale dhe aty frekuentojnë numër i konsiderueshëm i vizitorëve të vendit dhe të huaj.



Pamje e Shtëpisë-muze me ambientin rrethues



Pamje e bustit të prof. Ukshin Hotit dhe ambienti i brendshëm konservim-renovim

Xhamia e fshatit

Xhamia është ndërtim i ri, pasi që në luftën e fundit e objekti dhe minareja e xhamisë janë minuar dhe shkatërruar nga serbët. Objekti i ri është ndërtuar mbi themelat e objektit të vjetër me një arkitekturë moderne, e pasuruar me dekorë e mbishkrime orientale.



Pamje e pjesshme e xhamisë, punimet e reja

Shtëpia e Kulturës "Muhamet Malsori"

E ndërtuar në vitin 1952, ndërtim kënddrejtë e ndërtuar me gurë e lidhur me llaç gëlqere e betoni. Objekti është përdor si komunë dhe ka pasur zyrë të gjendjes civile. Më vonë objekti ka pësuar ndryshime dhe është renovuar disa herë. Aktualisht është përshtatur biblioteka, salla e shfaqjeve dhe hapësira për vodosjen e pajisjeve ndihmëse. Ngjitur është ndërtuar një shtojcë e objektit rinas.



Pamje e Shtëpisë së Kulturës "Muhamet Malsori"



Pamje e sallës, amfiteatrit brenda shtëpisë

Kompleksi i varrezave të dëshmorëve

Ky kompleks është ngrit në vitin 2013 për të nderuar të rënët në luftën e fundit, gjithsej 241 njerëz. Në këtë Kompleks ndodhen varrezat e martirëve dhe dëshmorëve, lapidari me emrat e të gjithë të rënëve, amfiteatri dhe Muzeu i luftës (në ndërtim).

Kompleksi është i rrethuar me mure betoni, i mveshur me rrasha gurësh. Hyrja në kompleks bëhet në tri drejtime (dyer), me mure harkore. Të dera hyrëse kryesore, në perëndim të kompleksit, afër derës, është një fontanë funksionale e ujit.



Pamje e pllakës përkujtimore



Pamje e Muzeut brenda Kompleksit të Dëshmorëve – Krushë e Madhe

Varrezat e vjetra

Varrezat janë në pjesën veriore të kompleksit të dëshmorëvc, aty afér muzeut të luftës (në ndërtim), janë disa varreza më gurë mbivarror, të cilët gradualisht me kalimin e kohës kanë filluar të humbasin.



Pamje e varrezave të vjetra dhe varrit të vjetër (mulla Bajram Sejsullahu 1808-1882)

Rrënojat e Banesës së vjetër (Kullës)

Kjo banesë ka ekzistuar si fortifikatë deri në vitin 2013, por tani janë vetëm rrënojat. I përket shek XVIII-XIX. Ka qenë dy kate e ndërtuar me gurë të bjeshkës, të sjellë nga bjeshka e Pashtrikut, Gradishi dhe nga bjeshka e Rahovecit. Në afërsi nuk ka gurore me gurë bjeshke, ndërsa rruga kryesore është e rregulluar me gurë të lumit. Kjo rrugë, Sokaku i Madh, kalon skaj varrezave, skaj shkollës fillore dhe ngjilet deri te banesa e madhe apo kulla, për të vazhduar në drejtim të xhamisë.



Pamje e rrënojave të themelove të kullës dhe dyerive të vjetra afer xhamisë

Çeshmja / Çezma

Çezma është ndërtuar në vitin 1969 nga organizata Shqiptare LNÇ-së. Në të njëjtën kohë u bë edhe përmendorja për të rënët e LNÇ-së (më 07.7.1969). Përmendoren e ka strukturuar profesori Osman Sejfullahu. Afér përmendores ndodhet edhe Bunari i Nezës, mirëpo tanë ky pus ëshlë mbuluar nga rruga e asfaltuar.

Çezma gjithmonë ka qenë funksionale dhc ka pasur ujë të rrjedhshëm. Çezma kishte gypa nëntokësor dhe një govatë për të pirë ujë bagëtitë. Të vjetrit kanë treguar se uji vinte nga Mali i Madh, në pjesën kah Krusha e Vogël. Është në interesin publik që kjo rrjedhë e ujil të funksionalizohet përsëri.



Pamje e çezmes me pllakat nga rregulluesit/pamje e pllakatës së LNÇ-së

XËRXË

Subjektet:

Murat Kryeziu, ish-kryetar i Ishitit, mësimdhënës i shkollës "Hamëz Thaçi";
Gani Kryeziu, Historian, prof.

Stacioni i trenit (1962)

Stacioni është ndërtuar në vitin 1962 dhe ka qenë funksional për një kohë të gjatë, duke shërbyer si pikë e rëndësishme e transportit hekurudhor për një pjesë të rajonit të Dukagjinit (Gjakovë Rahovec, Malishevë). Objekti i stacionit është pa mirëmbajtje dhe është duke u rrënuar. Ekziston një linjë e veçantë me shina

për nevojat e industrisë së grurit dhe miellit "Sillosi". Në oborrin e kompleksit të stacionit ndodhet një pus (bunar) i braktisur, që ka shërbyer përfurnizimin e trenave të mallrave.



Pamje e stacionit të trenit dhc ndërtësës banuese



Pamje e mullirit "Sillosit" dhe e pusit (bunari) të stacionit të trenit

Shtëpitë e banimit të Binak e Sadik Kryeziut

Janë dy shtëpi të vjetëra të ndërtuara me tulla nga llaçi e balta (qerpiç), të pa banuara. Objektit janë dy katëshe me kulm katër ujérash, me një oborr të rrethuar me mur tulle e llaç balte. Në oborrt të shtëpive ekziston një hambar i vjetër druri në gjendje të mirë.



Pamje e pjesshme e shtëpisë, murit rrethues dhe dyerve

Xhamia e fshatit shek XVIII

Xhamia është në gjendjen e saj të vjetër. E ndërtuar kohë më parë, por janë bërë ca meremeetime në vitin 2018. Ndryshimet e fasadës krijojnë imazhin e një objekti të ri, por në fakt është më i vjetër si strukturë. Në oborrin e xhamisë ndodhet një pllakatë nga guri me mbishkrim arab dhe me disa forma gjeometrike, që duhet të analizohet nga ekperitët.

Në oborrin rrethues të xhamisë janë dy varre, njëri i babës Cenë dhe varri i babes Musë, të cilët thuhet e kanë ndihmur komunitetin.

Në anën jugore të xhamisë është e ndërtuar oda e fshatit për raste të ndryshme familjare.



Pamje e ballore e xhamisë dhe pllakata te dera hyrëse



Pamje e minares së xhamisë dhe shkallët e brendshme.

Varri në varrezat e mëdhaja

E njohin si varri i vajzërisë. I rrethuar me gurë. Aty janë gurët e varrit (stellla), pos këtij varri janë edhe dy tipe varresh, një është varr i rretuar më gurë që ka dy varre brenda dhe tjetri është varr i rrethuar me gurë dhe është i gjatë se varret e zakonshme.

Te varrezat e mëdhaja janë edhe disa varreza të vjetra, ku duken gurët mbivarror.



Varri i vajzerisë dhe varri tumë

Varret e Vogla

Këto varre janë më në brendësi të fshatit. Këtu ndodhen disa varre të vjetra që tregohen nga vjetërisa e gurëve mbi varrc. Varri i tillë është ai i Deli Etëhemit, i rrethuar me gurë dhe ka gur mbivarror (stellë) me kupolë sipër.



Varri i Deli Etëhemit

Ura e Murat Agës

Ura gjendet në rrugën Xerxë-Gjakov. 50 metra afér rrugës së Gradishit, ku shihet muri anësor i urës në një anë. Ura është e qëndrueshme por pa mirëmbajtje.

Një atraksion i ri turistik është përvuuar më 02.09.2021, afér Urës së Fshajtë, saktësishtë në kanionin e Drinit të Bardhë. Është fjala për “Urën Tibetiane” e cila kalon nga komuna e Rahovecit te komuna e Gjakovës dhe anasjelltas.

GRYKA E LUMIT “MIRUSHA”

Parku Natyror i Mirushës gjendet në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha. Sipërsfaqja e territorit të mbrojtur është 555.80,70 ha dhe shtrihet në territorin e komunave: Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Lumi Mirusha derdhet në lumin Drini i Bardhë dhe përfaqëson vlera të pasura natyrore të Kosovës, përfshi ujëvara e liqene të shumta (16 sosh), florë dhe faunë shumë të pasur, duke i dhënë vlerë të jashtëzakonshme natyrore, shkencore, kulturore e turistike krejt zonës.



Pamje e ujëvarës Mirusha

MAJA E SHKODRANIT



Gryka e Drinit të Bardhë (Kanioni)

Gryka e Drinit të Bardhë (kanioni) është një grykë e vogël e vendosur në jugperëndim të Kosovës, që e ndan lumi Drini i Bardhë, në afersi të fshatit Xerxë. Gryka është relativisht e shkurtër, rrëth 900 m gjatësi me një thellësi prej 45 metra. Në hyrje të grykës është Ura e Fshajt, një urë e vjetër Osmane, që lidh brigjet e lumit në mes të komunës së Gjakovës dhe Rahovecit. Për shkak vlerave hidrologjike dhe geomorfologjike, në vitin 1986 ishte marrë nën mbrojtje ligjore si një Monument Natyror. Zona e mbrojtur përfshin një sipërfaqe prej 199 ha. Komunës së Rahovecit i takojnë 124.96 ha, ndërsa komunës së Gjakovës 73.86.

Kanioni është fenomen morfo-hidrologjik me vlera gjenetike, vizuale dhe edukative. Ajo u formua gjatë periudhës së neogjenizmit. Gryka ka karakteristika tipike dhe përmban shumë formacione kalciumi. Ura e Fshajtë dhe gryka e Drinit të Bardhë përsaqësojnë vlera të rëndësishme dhe tërheqje turistike. Mbi urë organizohen edhe garat e kërcimit në ujë.

Në afersi të urës ka dy gurë të njobur si "Shqiponja Rock" (Shkëmbi i Shqiponjës) dhe "Skënderbeu Rock" (Shkëmbi i Skenderbeut), që përbën një ghendje të figures së fisnikut shqiptar të shek. XV Gjergj Kastrioti – Skënderbeu. Portreti i Skënderbeut është piktuar në shkëmb në vitin 1968 nga Mexhid Yvejsi me rastin e 500-vjetorin e vdekjes së tij.



“Maja e Shkodranit” përsaqëson vlera të veçanta historike, kulturore e natyrore. Kompleksi përkujtimor i ndërtuar aty u kushtohet katër dëshmorëve të UÇK-së, të cilët ranë në korrik të vitit 1998. Nga ky vend mund të soditen peizazhe mahnitëse të krejt zonës, ndërsa shikimi të ndesh Prizrenin dhe më tutje liqenin e Dukagjinit.

Sipër “Majës së Shkodranit” ndodhen rrënojat e një fortifikate të lashtë, supozohet të jetë e periudhës lire-romake. Fortifikata duhet të gërmohet dhe të nxirret në sipërsaqe.

Punimet u përfunduan në 2022

Kompleksi i Dëshmorëve në Gradish

I ndërtuar në vitin 2019 përnder të rënve përliri në komunën e Rahovecit. Investim i Komunës së Rahovecit. Ndodhet në Zonën e Mbrojtur në një pikë të dukshme nga rruga magjistrale Prizren – Gjakovë dhe Xerxë – Klinë.

Kompleksi është i rrethuar me mur prej gurit, ndërsa objektet brenda kompleksit janë të ndërtuar me beton e të mveshur me gurë. Kompleksi përbëhet nga një kullë-muze, amfiteatri, obilisku (kompleksi memorial) dhe varrezat (vendi i varrezave të dëshmorëve). Ambienti mirëmbahet, i shoqëruar me shtegun e cajes, shteg që të shpie të Ura Tibetiane, ku shihet gryka (kanioni) i Drinit të Bardhë, Ura e Fshajtë. Në faqet e grykës është shpella e Llapatanëve, ndërsa pak mbi shpellë ndodhen rrënojat e një fortifikate të kohës ilire-romake.



Pamje e Kompleksit të dëshmorëve – Gradish 2022.

Opterushë

Subjektet e intervistuar janë:

Më 01.09.2022

1. Egerem Spahiu
2. Hashim Spahiu
3. Skender Krasniqi

Kulla e Mahmut Pashë Rrotullës


Kulla është ndërtuar nga Mahmut Pashë Rrotulla në shek. XIX. Kullë tre (3) katëshe, e ndërtuar me gurë gëlqeror, me dyshekllëk nga druri të dalë jashtë. Konstruksioni meskatësh nga druri, dyshemeja nga druri, dyert dhe dritaret nga druri, konstruksnë i kulmit prej druri, kulm katër ujërash, mbuluar me pllaka apo rrasa guri. Subjektet tregojnë se Kulla ka shërbyer si "Kuvend". Kati përdhes ka funksionuar si mulli me rrymë. Këtu ka qenë edhe sallë kinemaje në vitet e para të sistemit komunist.

Objekti është në mbrojtje të përkohshme të Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me nr. unik 1767.



Foto: Pamjet e Kullës së Mahmut Pashës, gjatë inventarizimit në terren, shtator 2022.

Kulla e Heronje



Kjo kullë është ndërtuar në nderim të heronjve Xhelal Hajda – Toni, Selajdin Mullaabazi – Mici, Hamdi Hajrizi, Nezir Ymeri e Bektesh Haliti. Kulla do të shërbejë si muze i luftës së UÇK-së. Veturat ku janë vranë dëshmorët janë vënë nën mbulojë dhe ruhen nga ndikimet atmosferike. Përurimi i kullës është bërë në vitin 2021.

Burimi (Vrella)

Burim natyror i ujit. Uji është i pastër dhe banorët e përdorin për pijc, larje dhe gatim. Në vitet '90 banorët e kanë rregulluar vetë shtratin e burimit, që banorët vendas e quajnë "Vrella". Dyshemeja është e shtruar me zhavort (gur), si dhe është bërë mbulimi i rrjedhës për ta mbrojtur nga ndotja dhe depërtimi i ujit sipërfaqësor. Në vitin 2004 është ndërtuar ndërtesa e re dhe prej aty është shpërndarë rjeti i gypave të ujit në disa lagje të fshatit, që përmes pompave uji dërgohet në një lartësi deri në një km. apo rrëth 170 metra mbi nivelin e burimit. Teprica e ujit del në shtrat dhe përhapet në një ujëmbledhës, ku pijnë ujë kafshët dhe freskohen fëmijët. Rrjedha e ujit është aktive gjatë gjithë vitit.



Pamje e shtratit të burimit, ku shihen edhe fëmijët duke u freskuar



Çezma e Abedin Mazrekut 12.03.1969

Në vitet '70 është ndërtuar si çezmë për nevojat e banorëve, ndërsa ende vazhdon të rrjedhë ujë i pijshëm.

Gërmadhat e Kishës “Shpëtimi i Shenjtë” (Shën Gjergji), mesjetë

Gjendet në mes të fshatit në kodër, tek vendi që quhet Raush. Në afërsi të kishës ka edhe disa varreza shumë të vjetra. Në këto varreza janë edhe disa gurë varri dhe disa janë të dëmtuara rëndë.

Në foto shihen punime të mëhershme. Objekti është në LTK, me nr. unik 3134



Pamje: Gërmadhat e Kishës, shtator 2022

Nagavc

Subjekt: Arian Gashi

Lisi i Mujës (Lisi i Nagavcit)

Lis i vjetër, supozohet të jetë rreth 500 vjeçar. Në brendësi është i zbrazët, sepse vite më herët ka qenë i pa mbrojtur dhe ka pasur vatrë zjarri në trungun e lisit. Drunj të tillë janë të rrallë në Kosovë dhe duhet të ruhen me kujdes.



Pamje e lisit në kohën e vizitës, shtator 2022

Celina

Subjektet

Muhamed Ramadani

Kroi i Celinës

Burim natyror i ujit, kroi i fshatit është i vjetër mbi 200vite burim i pandalshëm, ku janë furnizuar banorët për shumë breza.



Pamje e vendit të kroit (2022)

Bunari i Vuçiternës

Bunari gjendet në pjesën perëndimore të fshatit, rruga Celinë- Fortesë, në anën e majtë në tokat e punuara. Thellësia e pusit duket të jetë rreth 10 metra.



Pamjet e gjendjes së pusit (2022)

Mali Pisjak – ndryshe i njohur si mali “Hajrat” nga banorët e fshatit.

Mali ka shërbyer për nevoja të komunitetit (Hajrat) dhe drunjtë janë përdorur për varrimin e të vdekurve dhe për ngrohje të objekteve publike; shkolla, xhamia. Zona mund të përbëjë interes për rekreacion dhe hapësirë për ndonjë aktivitet të organizuar shoqëror. Në këtë mal me një sipërfaqe prej 8/ha, në luftën e fundit janë strehuar rreth 8000 persona nga fshati Celinë e rrethinë.



Mali Pisjak

Objekti ku ruhen foto dhe dëshmi të masakrës serbe në fshatin Celinë



Shtëpia-muze në Celinë.

Ky objekt është pranë me varrezat e të rënëve për liri. Janë të eksponuara fotografitë e të vrarëve si dëshmi të krimeve serbe në këtë fshat.

Xhamia e fshatit Celinë

Xhamia është ndërtim i ri. Xhamia është ndërtuar mbi rrënojat e objektit të vjetër të xhamisë, e cila është djegur e rrënuar nga forcat serbe gjatë luftës. Pjesë të xhamisë së vjetër janë groposur nën ndërtimin e ri.



Pamje e pjesshme e xhamisë (2022).

Në fshatin Celinë gjithashtu gjendet Tyrbeja e Dervish Hysenit 1986

Është ndërtim i ri. I përket tarikatit Nakshi bendi.

Zoçishti

Subjektet

Bajram Shala – Historian

Enver Kabashi- Kryetar i fshatit

Xhafer Kabashi, banor i fshatit

Kisha e vjetër

Në pamundësi për ta vizituar, subjekti na tregon se kjo kishë i ka rrethojat e murit 1 (një) metër lartësi mbi tokë. Në ballë të objektit janë tri stigma (gurë) për ndezjen e qirinjve.

Kalaja e Dafinës

Në pamundësi për ta vizituar nga afér, për shkak të mungcsës së rrugës, rrënojat e kalasë së Dafinës ndodhen në kodrën mbi fshatin Zoçishtë, në pjesën lindore të fshatit. Kalaja e ka marrë emrin nga druri i dafinës që mbulon tërë zonën. Sipas kryetarit të fshatit (E.K), në brendi të kalasë ekzistojnë shkallët-tunel që kanë dalje te burimi i ujit në fshat. Objekti mund të përbëjë interes të madh për turizmin në këtë zonë.

Burimi i ujit të fshatit Zoçishtë

Uji që rrjedh nga bjeshka kalon skaj kalasë së Dafinës, vazhdon skaj Manastirit të Zoçishtit dhe e ndan fshatin në dy anë. Dikur këtu ka pasur edhe mullinj pasi që uji ka rrjedhur gjatë gjithë vitit. Në vitet 1950-‘60 banorët e kanë rrëgulluar objektin e burimit, duke e bërë më të qasshëm.

Ura e gurit

Ura e gurit është ndërtuar në vitin 1961 nga guri dhe llaçi gjelqeror. Ndodhet në mes të fshatit Zoçishtë dhe Retijë. Perimetri urës është 3.50 m, lartësia 1.40 m, trashësia e murit 0.40 m gjerësia e urës mbi të cilën kalojnë mjetet është 3.50 m.



Pamje e urës së gurit (2022).

Varrezat e Vjetra

Në këto varreza ndodhet një varr, për të cilin banorët thonë se i përket një emigrant nga Shqipëria, i cili ka qenë kryetar i fshatit në vitet 1940-43 dhe ishte vrarë në Prizren për motive të hakmarijes. Trupi i tij është varrosur në Zoçishtë për shkak se aty ka qenë i strehuar për disa vite. Nuk dihet identiteti i personit të varrosur aty.

Retija

Subjekti: Binak Kryeziu

Ura e gurit

Ura lidh fshatrat Zoçishtë-Retijë, pak metra pas urës së Zoçishtit. Është në gjendje të mirë, e mbuluar me beton dhe asfalt. Dallohet vetëm harku me gurë i urës.



Pamjet e urës së gurit dhe betonimi i urës së re (2022).

Kalaja e Hisarit

Kalaja gjendet në pjesën e fshatit që të shpic te Zoqisht, pasi e kalon uren e gurit, në rrrethojat e kalase thonë se tokën e punojnë mbjellin grurë.

Fortesë

Subjekti:

Hilmi Popaj

Fortesa ka lokalitetin Arkeologjik në anën veriore të fshatit, ku janë edhe varrezat e vjetra.

Bunari i Vjetër



Bunari është në gjendje të mirë por i mbyllur. Ndodhet në afersi të shkollës. Guri në formë rrethore mbi tokë është i padëmtuar.

Ura e gurit



Pamje e urës së gurit në qendër të fshatit (2022)

Ura e gurit në Fortesë (monument i ri)

Ura e gurit gjendet në pjesën veriore të fshatit, mbrapa restaurant Natyra, në tokat bujqësore. Është në gjendje të mirë dhe mbi të kalojnë makina të rënda bujqësore. Duhet të vihet nën mbrojtje dhe bri saj të ndërtohet rrugë alternative.



Pamjet c urës së gurtë, Fortesë 2022

Hoçë e Vogël

Subjektet: Kadri Berisha; Ramadan Krasniqi; Sheh Halil Shehu, Abedin Rexhep Krasniqi.

Tybja e Sheh Ibrahimit (Tarikati Halveti) në vitin 1658

Tyrbja është në qendrën e fshatit Hoçë e Vogël, të cilat janë me një oborr të përbashkët me xhaminë e Hoçës, ku afër kanë edhe lapidarë dëshmorëve.

Tyrbeja është e ndërtuar me tetë (8) kënde, te dera hyrëse e tyrbes është një pllak e gurit sigë me mbishkrime (arabe), mirëmbahet nga Kadri Berisha, ka shumë vizitorë nga fshati dhe rrëthina, pos kësaj tyrbe në Hoçë kemi edhe një tyrbe tjeter së bashku me teqe.



Pamje e Tyrbes Sheh Ibrahimit

Tyrbja dhe Teqeja e Sheh Halitit

Prej vitin 1930 ka ekzistu si teqe. Në këtë teqe ka shërbyer Sheh Halit (Ramadan) Krasniqi pas tij Sheh Muharemi, këta dy varret i kanë në tyrbën afër teqesë. Tani shërben Sheh Halit Shehu, i cili e ka trashëguar nga këta dy të parët nga babai dhe gjyshi. Këto janë të tarikatit Halveti të njëjtë me tyrben e Sheh Ibrahimit.

Teqeja është rindërtuar në vitin 2004, në të njëjtat themelë vetëm se tani është më e vogël, sepse e vjetra ka pasur në të objekte të banimit për gratë dhe një ahur.



Teqja dhe Tyrbja e Sheh Halitit

Xhamia e Hoçës së Vogël

Xhamia është e ndërtuar në vitin 1920, por e dëmtuar gjatë luftës në vitin 1999, ku kishte shpëtuar vetëm minarja e xhamisë, e cila shihet e renovuar por me disa pjesë të konservuara.

Në themelët e xhamisë së vjetër u rindërtua xhamia e re, që është në formë të qëndrueshme dhe e mirëmbajtur. Ambientin e gjelbëruar e ndajnë së bashku me tyrbën. Ambienti i oborrit është i rrethuar me mure në të gjithë anët. Tani xhamia ka dy minare, njëra është e vjetër, afër saj është ndërtuar minareja e re.



Pamje e xhamisë së rindërtuar dhe minareja e mbijetuar.

Brestoci

Subjekti: Lendrit Berisha

Rrënojat e xhamisë në fshatin Brestoc është e shek. XVI me nr. Unik 1763 në LTK.



Pamje e minaresë së xhamisë që është konservuar-restauruar më 2016. Pamje e gurëve mbivarror afér minaresë së vjetër.

Dejnë



Tyrbja e Sheh Rremës dhe tyrbja e Dervish Brahimit, të tarikatit Sadii



Pamje e tyrbes së Tarikatit Rifai – Dejnë Lisi i Mllakut – Dejnë



Amfiteatri i Festivalit Anadria Jehon-Dejnë, i përuar me 11.05.2022

Festivali “Anadrenia Jehon” filloi me iniciativën e OJQ “Forumi i Pavarua Rinor i Kosovës” dhe me përkrahjen e rinisë së fshatit. Aktiviteti i parë është mbajtur më 5 dhe 6 maj 2002. Festivali është tritur vit pas viti dhe tashmë është bërë pjesë e rëndësishme e kulturës materiale e shpiriёre. Aktualisht mbahet në datat; 11, 12 dhe 13 maj të çdo viti.

Ratkoc



Bunari i Madh – Ratkoc



Xhamia Ratkoc

Bunari i Madh u ka shërbyer banorëve të fshatit Ratkoc për shumë breza. Supozohet të jetë qindra vjeçar dhe nuk mbahet në mend kur mund të jetë hapur. Deri në fund të viteve '80 ka qenë burimi i vetëm ku janë furnizuar mijëra banorë të kësaj ane. Është renovuar dhe ruhet si monument i trashgëmisë natyrore në këtë zonë.

Kramovik

Turbe e Shyt Alisë



Turbe e tarikatit Sadii e ndërtuar më 1957.

Mrasor



Më 3.06.2022 në fshatin Mrasor, është përruuar shtëpia – muze e heroit Skënder Rexhepi - "Komandant Hekuri", investim nga Komuna e Rahovecit. Në oborrin e shtëpisë është ngritur edhe busti i heroit Rexhepi.

Kazniku



Lisi i Madh apo Lisi i Mëhallëve, në vendin e quajtur Barkoc. Sipas banorëve, lisi supozohet të jetë i vjetër rreth 400 vjet.

POTOÇAN I ULËT

Tyrbja e Dervish Avdiut dhe Ahmatit



Tyrbeja daton nga shek. XVIII-XIX.

Kroi i fshatit Potoçan i Ulët

Shtojcë:

Bashkangjitur në material është edhe Karta e Trashëgimisë Kulturore për Rahovec.

ANEKS 1 – KARTAT E TRASHËGIMISË KULTURORE PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

KATEGORIA: TRASHËGIMIA ARKITEKTONIKE

TEQJA HALVETI – RAHOVEC



Emërtimi	PLANET LOKALE TË TRASHËGIMISË
Teqja e Halvetive	

KARTA E OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
KOMUNA _____Rahovec_____

Plotësuar nga (Emri dhe mblemi)
Dala (DD MM VVVV)

Nora Arapi Krasniqi
11.10.2012

1. Lokacioni	
Komuna	Rahovec
Fshati	/
Lagjja	Qendra e vjetër
Numri/numrat i/e parcellës	x
Koordinatat gjeografike	Lat. 42.40 N; Lon. 20.65 E; Alt. 429.6 m

2. Karakteristikat e përgjithshme	
Koha e ndërtimit	shek. XVII*
Shfrytëzimi i tanishëm	Objekt Fetar - Teqe
Evidentimi në listën e MKRS (Po / Jo)	
(Të shënohet numri i vendimit zyrtar nëse egziston)	Po/ Nr. Vendimi 02-251/68
E inventarizuar nga QRTK (Po / Jo)	
(Të shënohet numri i vendimit zyrtar nëse egziston)	Po/ Nr. Unik në Databazë 001774

3. Tipologjia	4. Niveli i dëmimit
Trashëgimi arkitekturale	Pa dëmtim
Monument	x
Ansambël	
Fushë e konservimit arkitektural	
Trashëgimi arkeologjike	

5. Atribuimi i vlerave	6. Sygjerimet për trajtim
Kulturore	Identiteti x
	Artistike x
	Teknike
	Rariteti
	Komuniteti x
Shqërore	Edukative x
	Politike x
	Funksionale
Ekonomike	Ekonomike
Metodologjia	
Mbrojtje	
Ruajtje x	
Konservim x	
Konsolidim	
Restaurim	
Rekonstruim	
Anastilozë	

Shënim: Atributet e vlerave të veçanta të objektit mund të kërkojnë një apo më shumë trajtime

7. Objektet / elementet shtesë të lëvizime apo të palëvizioni që gjinden në lokacion
Kompleksi i teqes përbëhet nga elementet përcjellësa që gjinden në oborr të tij. Tyrbe - vendi ku gjenden varrezat e udhëheqësve shpirtëror - Shehlerëve, të teqes; Çeshmja e vjetër e punuar nga guri i gdhendur; Pitosi që daton nga periudha paraistorike që është gjetur në Rahovec; Guri mbivarror nga periudha Romake poashlu e gjetur në Rahovec. *

8. Informata shtesë relevante
Kulmi i vjetër i teqes ka qenë i mbuluar me rrasa guri. Gjatë viteve 1990-1998 kulmi është rindërtuar dhe mbulesa me rrasa guri është zëvendësuar me tjegulla argjilore. Teqja e Halvetive në popull ndryshtë quhet edhe Teqja e Sheh Sylejmanit dhe paraqet një vend të rëndësishëm për besimtarët e tarikatit Halveti në Kosovë.
* Intervistë me përgjegjësin për trashëgimi kulturore në Komunën e Rahovecit, Kadri Durguti, më datë 11.10.2012.

9. Pozicionimi në hartë



** Harta e huazuar nga <http://www.bing.com/maps/#Y3A9NDluMzQ4MTk3fjleLjU3NTgxNSZsdmw9MTYmc3R5Peg=>

10. Fotodokumentacioni shtesë



Pamje e jaشتme e Teqes



Pamje e Tyrbes - Mauzoleut në pjesën e pasme të Teqes



Pitosi Romak



Çeshnja e vjetër nga guri



Guri mbivarror në oborr të Teqes



Pamje e brendshme e dhomës së lutjeve - Semahane



Pamje e brendshme e dhomës së takimeve

***Fotografitë e realizuara nga Nora Arapi Krasniqi - CHWB dhe QRTK Pz - Tetor 2012

SHTËPIA E QAMIL VUÇITËRNËS– RAHOVEC





PLANET LOKALE TË TRASHËGIMISË

Shtëpia e Qamil Vuçiternës

KARTA E OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE KOMUNA _____ Rahovec _____

Plotësuar nga (Emri dhe mbiemri)
Data (DD MM VVVV)

Nora Arapi Krasniqi
11.10.2012

1. Lokacioni

Komuna	Rahovec
Fshati	
Lagjja	Rruga Vellezërit Shaban Dula
Numri/numrat i/v parcellës	X
Koordinatat gjeografike	Lat. 42.23 N, Lon. 20.72 E; Alt. 429.6 m

2. Karakteristikat e përgjithshme

Koha e ndërtimit	shek XIX*
Shfrytëzimi i tanishëm	Shtëpi Banimi
Evidentimi në listën e MKRS (Po / Jo)	
(Të shënohet numri i vendimit zyrtar nëse egziston)	Po
E inventarizuar nga QRTK (Po / Jo)	
(Të shënohet numri i vendimit zyrtar nëse egziston)	Po/ Nr. Unik në Dalabazë 10086-32

3. Tipologjia

Trashëgimi arkitekturale	
Monument	X
Ansambël	
Fushë e konservimit arkitektural	
Trashëgimi arkeologjike	

4. Niveli i dëmtimit

Pa dëmtim	
I ulët	
Mesatar	X
I lartë	
Shkatëruar	

5. Atribuimi i vlerave

	Identiteti	
Kulturore	Artistike	X
	Teknika	X
	Rariteti	
	Komuniteti	
Shqërore	Edukative	
	Politike	
Ekonome	Funksionale	X
	Ekonomike	X

6. Sygjerimet për trajtim

	Mbrojtje	
Metodologjia	Ruajtje	
	Konservim	X
	Restaurim	X
	Rekonstruim	
	Anastilozë	

Shënim: Atributet e vlerave të veçanta të objektit mund të kërkojnë një apo më shumë trajtime

7. Objektet / elementet shtesë të lëvizshme apo të palëvëzshme që gjindën në lokacion

Në përgjithësi në interier të shtëpisë janë ruajtur elementet origjinale nga koha e ndërtimit të saj. Shkallët nga druri; Tavani i dekoruar me rozetë nga druri; Dera e vjetër; Ohxaku në përdhesë; Hapja harkore nga guri në fasadën ballore, janë disa nga elementet karakteristike.

8. Informata shtesë relevante

Shtëpia ka qenë pronë e Familjes Gërqagu. Prej 30 vitesh është në pronësi të Familjes Vuçitëma.** Kulmi fillimisht ka qenë i mbuluar me rrasa guri, kurse tani është zëvendësuar me plakë të valëzuar- Sallonit; Dritaret në fasadën ballore kanë pasur kornizë të punuar nga guri, kurse tani janë zëvendësuar me dritare me kornizë druri; Dyshejma e përdhesës pjesërisht është shkëmb dhe dhei i shtypur. Përdhesa e shtëpisë deri vonë është shfrytëzuar, por për shkak të dëmtimeve të shkaktuara nga lagështia dhe mungesa e mirëmbajtjes, momentalisht është e pabaruar dhe në gjendje të rëndë. Rrjedhja e kanalizimit në murin perimetrik lindor ka shkakuar dëmtime të rënda në ndërtësë.

* Qendra Regionale pwr Trashwgimi Kulturore, Prizren. **Intervistë me anëtarin e Familjes Vuçitëma, më datë 11.10.2012.

9. Pozicionimi në hartë



***Harta e huazuar nga <http://www.bing.com/maps/#Y3A9NDluMzQ4MTk3JlwLjU3NTgxNSZsdmw9MTYmc3RSPwg>=

10. Fotodokumentacioni shtesë



Pamje Jug-Perëndimore e ndërtesës



Pamje Perëndimore - Kulmi i mbuluar me pilakë Sallonit



Fasada Ballore



Elementet origjinalë në interier



Oxhaku i vjetër në përdhesë - dëmtimet nga lagëshlia



Elemente origjinalë në përdhesë - Tavani që Dera



Fotografitë e realizuara nga Nora Arapi Krasniqi - CHwB -Tetor 2012

Ermërtimi
Kulla e Hajrullah Çantës


PLANET LOKALE TË TRASHËGIMISË

KARTA E OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE KOMUNA _____ Rahovec

Plotësuar nga (Emri dhe mbiemri)
Data (DD/MM VVVV)

Nora Arapi Krasniqi
11.10.2012

1. Lokacioni	
Komuna	Rahovec
Fshati	
Lagja	Sheshi i Republikës / Govedamica
Numri/numrat i/e parcellës	X
Koordinatat gjeografike	Lat. 42.22 N; Lon. 20.72 E; Alt. 429.6 m

2. Karakteristikat e përgjithshme	
Koha e ndërtimit	shek. XIX*
Shiftezimi i tanishëm	E pashfrytëzuar
Evidentimi në listën e MKRS (Po / Jo) (Të shënohet numri i vendimil zyrtar nëse egziston)	Po
